



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 16 SHKURT 2023, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON  
NËNKRYETARJA E KUVENDIT  
ERMONELA FELAJ**

*(Seanca filloi në orën 10:00)*

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të datave 2.2.2023 dhe 13.2.2023 *(neni 44, pika 2, i Rregullores)*

2. Njoftime *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar *(në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1 të Kushtetutës, dhe neneve 55, 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Finlandës, për eliminimin e tatimit të dyfishtë, në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin e shmangien e evazionit tatimor” *(në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e cilësuar votash për miratim: absolute)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

5. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (huamarrësi) dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim (huadhënësi), për financimin e projektit “Furnizimi me ujë i qytetit të Durrësit”” *(në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 dhe 2, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e cilësuar votash për miratim: absolute)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

6. Projektligji “Për miratimin e kontratës shtesë për ndryshimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “SICPA Security Solutions” S.A. e “SICPA Security Solutions Albania” sh.p.k., për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave, miratuar me ligjin nr.10381, datë 24.2.2011” *(në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1 të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

7. Projektvendimi për kërkesën “Për shkarkimin e Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, zonjës Lindita Nikolla”. Raporti 1, Raporti 2 *(në mbështetje të nenit 75 të Kushtetutës dhe nenit 114, pika 4, të Rregullores)*

8. Projektvendimi “Mbi propozimin për punonjësit me kohë jo të plotë pune pranë KQZ-së, për procesin e pilotimit të votimit dhe numërimit elektronik në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” *(në mbështetje të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

9. Projektvendimi “Për ndryshime në strukturën organizative të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD)” *(në mbështetje të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

10. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (60’).

**Ermonela Felaj** – Mirëdita, kolegë!

Meqenëse kourumi për të filluar seancën është i plotë, e deklaroj të hapur seancën plenare.

Më lejoni t'ju deklaroj që në fillim se këtë seancë plenare do ta drejtoj unë, si zëvendëskryetare e mazhorancës, sipas parashikimeve të nenit 114, pika 4 e Rregullores së Kuvendit.

Sot, në rendin e ditës të kësaj seance plenare, i cili ju është njoftuar paraprakisht, është parashikuar edhe votimi i kërkesës së një grupi deputetësh të Partisë Demokratike për shkarkimin e Kryetares së Kuvendit, zonjës Lindita Nikolla. Neni 114, pika 4, i Rregullores parashikon në mënyrë konkrete sa më poshtë: “Kërkesa për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit paraqitet sipas pikës 1 të këtij neni dhe shqyrtohet nga Këshilli për Legjislacionin,” - në fakt, Këshilli për Legjislacionin është mbledhur dy herë, - “i cili e paraqet raportin përkatës në seancë plenare. Në rast se kërkohet, Këshilli për Legjislacionin dhe Kuvendi në seancë plenare janë të detyruar të dëgjojnë Kryetarin e Kuvendit. Në këtë rast seanca plenare drejtohet nga zëvendëskryetari, që i përket shumicës parlamentare”. Ky sqarim u bë për drejtimin e seancës sot nga ana ime.

*Pasi lexon rendin e ditës.*

Fillojmë me çështjet sipas rendit të ditës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po. Vetëm, ju lutem, kolegë, më lejoni që edhe unë të mbaroj së lexuari dhe t'ju jap mundësi kolegëve që e kanë kërkuar fjalën për procedurë.

Zoti Spaho.

**Edmond Spaho** – Faleminderit!

Zonja drejtuese e seancës, edhe sot në hyrjen e Kuvendit u vërtetua edhe një herë që kemi të bëjmë me një mazhorancë, e cila sillet si bandite, një mazhorancë horrash dhe dallkawkësh, një mazhorancë mafioze.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pse, u ofenduat ju? Hapni “Washington Examiner”, ju thotë se jeni shteti i parë, narkoshteti i parë në Europë.

**Ermonela Felaj** - Zoti Spaho, ju lutem, mos u konfliktoni me kolegët! Mbani fjalën tuaj, sepse e kërkuat fjalën për procedurë. Ju lutem!

**Edmond Spaho** – Jeni narkoshteti i parë në Europë, ku Kryeministri blen zyrtarët e huaj dhe i përdor për agjendën e tij politike. Pse çuditëni ju? Revoltohuni atje, bëjini protestë! Bëjini protestë “Washington Examiner”-it, “Washington Post”-

it, “New York Times”- it, “Standard”-it, “Bild”-it, si edhe një morie gazetash nga më të mëdhatë në Europë.

**Ermonela Felaj** – Zoti Spaho, ju lutem, unë ju respektova, ju e kërkuat fjalën për procedurë, tani mund të paraqisni kërkesën procedurale.

**Edmond Spaho** – Jeni sjellë në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, duke përjashtuar deputetët, sepse nuk ka parlament në botë që përjashton 19 deputetë. Vetëm ju e keni bërë. Do të hyni në librin Gines me pafytyrësi, me paturpësi, vetëm e vetëm se opozita kërkon të flasë dhe të denoncojë këtë regjim që po e shkatërron vendin.

Zonja drejtuese e seancës, ka një muaj që ka shpërthyer një skandal dhe opozita...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, kolegë, mbani qetësi dhe dëgjoni fjalën e kolegut Spaho! Kolegë, ju lutem, jo komunikime nga vendi!

Zoti Spaho, vijoni me kërkesën!

**Edmond Spaho** – Ka një muaj që ka shpërthyer një skandal ndërkombëtar, ku përfshihet Kryeministri ynë dhe drejtori i kundërzbulimit të FBI-së. Ne, si opozitë, bazuar në misionin tonë për të kontrolluar qeverinë, kemi kërkuar një seancë pyetjesh me Kryeministrin dhe i kemi drejtuar atij 13 pyetje. Sipas Rregullores së Kuvendit, brenda javës duhej të mbahej seanca. Pse nuk po e mbani seancën? Pse ka frikë Kryeministri? Pse nuk vjen t'u përgjigjet pyetjeve? Apo është paralajmëruar të mos flasë, sepse çdo gjë që ai thotë, do t'i përdoret në gjyqet (nuk është një, janë dy), që po zhvillohen në SHBA?!

Po kështu kemi kërkuar mocion me debat pa kohë, por, çuditërisht, për një çështje kaq të rëndësishme ju nuk e vini ujin në zjarr dhe nuk pranoni të debatoni.

Dëshirojmë t'ju themi se për këto dy kërkesa nuk do të ketë asnjë tolerim nga ne. Asnjë çështje tjetër nuk ka për t'u diskutuar në këtë Kuvend, pa u diskutuar njëherë seanca e pyetjeve dhe mocioni me debat, pa kohë.

Po ju paralajmëroj se asnjë taktikë juaja për të përjashtuar deputetët dhe për të zhvilluar seancë pa prezencën tonë, pra për të zhvilluar mocionin pa prezencën e deputetëve të opozitës, nuk ka për t'ju ecur. Doni ta konfliktoni situatën, ta çoni në përplasje, është zgjidhja juaj. Ne po ju kërkojmë të respektoni Rregulloren. Deri tani e

keni shkelur me këmbë e duar, dhe ne do të sillemi në përputhje me sjelljen tuaj.

**Ermonela Felaj** - Dakord.

Faleminderit, zoti Spaho!

Më lejoni të sjell në vëmendjen e të gjithë kolegëve deputetë, se sipas kërkesave që i janë adresuar Kuvendit të Shqipërisë, Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, ato që ju përmendët në fjalën tuaj, pyetje, interpelancë urgjente dhe mocion për zhvillimin e një debati, janë trajtuar në Konferencën e Kryetarëve, e cila është mbledhur rregullisht, konform Rregullores, dhe me vendimin nr. 3, të datës 7 shkurt, të vitit 2023, i cili është publikuar në faqen e Kuvendit, Konferenca e Kryetarëve ka vendosur:

1. Bashkimi i interpelancave, pyetjeve dhe mocionit me debat, pra, që të shqyrtohen njëherazi, bazuar në nenin 89 të Rregullores. Neni 89, paragrafi i dytë i Rregullores i jep të drejtë Kryetarit të Kuvendit, që pas këshillimit me Konferencën e Kryetarëve, të vendosë që pyetjet, interpelancat ose mocionet, që lidhen me çështje të njëjta ose të ngjashme, dhe në rastin konkret, si pyetjet, si mocioni dhe kërkesa për interpelancë urgjente, kanë qenë të lidhura me të njëjtën çështje, grupohen së bashku dhe shqyrtohen njëherësh.

2. Shtyrja e kërkesës së 44 deputetëve, të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit, për verifikimin e ligjshmërisë së takimeve të Kryeministrit Edi Rama me agjentin e FBI-së, Çarls McGonigal, deri në miratimin e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, unë ju dëgjova me vëmendje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, shërbimet t’i vijnë në ndihmë kolegut! Ju lutem, duhet të kemi respekt për kolegun.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, patjetër, një sekondë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, të mos merremi me këto gjëra!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

U mundova të tregoj respekt për kolegun deputet, duke u kërkuar shërbimeve që t’i vijnë në ndihmë. Ndërkohë, më lejoni të përmbyll sqarimin që isha duke bërë! Është rënë dakord në

Konferencën e Kryetarëve që pyetjet, interpelanca dhe mocioni të trajtohen, por për kohën e debatit do të duhet të merren vesh paraprakisht kryetarët e grupeve parlamentare. Në mbledhjen e zhvilluar në Konferencën e Kryetarëve ka qenë i pranishëm vetëm kryetari i Grupit Parlamentar të PD-së, zoti Alibeaj, dhe nuk kemi pasur dy kryetarët e tjerë, që natyrisht janë të detyruar të marrin pjesë në Konferencën e Kryetarëve. Kështu që, kjo është arsyeja për të cilën ju nuk e gjeni sot në rendin e ditës zhvillimin e të gjitha kërkesave tuaja.

Vijojmë me radhën, fjalën e ka zoti Bylykbashi dhe zoti Alibeaj më pas. Ju lutem, radha e atyre që e kanë kërkuar fjalën për procedurë, i del secilit në ekranin që ka përpara. Ju lutem, përdorni ekranin dhe të jeni të sigurt që unë jam duke ndjekur të njëjtën radhë, se nuk kam mundësi të shoh të gjithë kolegët që e kërkojnë fjalën në të njëjtën kohë.

Po, zoti Bylykbashi, e keni kërkuar fjalën për procedurë.

**Oerd Bylykbashi** – Zonja drejtuese e seancës,

Deputetë të parlamentit të Shqipërisë,

Ky parlament është kthyer, jo po kthehet, por është kthyer tashmë, në varmihësin e pluralizmit demokratik parlamentar. Ky grup parlamentar i shumicës po varros përditë duke keqpërdorur, duke abuzuar me Rregulloren e Kuvendit të drejtat e deputetëve për të përfaqësuar qytetarët. Kemi kërkuar këtu fjalën, kemi kërkuar të ngremë çështje, kemi kërkuar të kontrollojmë mazhorancën, qeverinë. Unë nuk pres që kjo qeveri të respektojë të drejtat e shqiptarëve, por ky parlament e ka këtë detyrë. Kemi kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor për një nga skandalet më të mëdha që ka përfshirë Shqipërinë, por edhe SHBA-të, pikërisht i iniciuar nga një kryeministër jo i korruptuar, por korruptues, i cili ka guxuar të mendojë se mund të korruptojë një zyrtar të lartë të FBI-së për ta përdorur në luftën politike brenda Shqipërisë. Pra, ne kërkojmë komisionin parlamentar për këtë gjë. Është absolutisht e papranueshme ajo që dëgjova nga drejtuesja e seancës, që paska vendosur Byroja të pezullojë ligjin për komisionet hetimore. Ligjin për komisionet hetimore, po nuk e pezulloi Gjykata Kushtetuese, në momentin kur e merr në shqyrtim, askush tjetër nuk e pezullon dot. Ai zbatohet derisa të ndryshohet, sido që të ndryshohet. Por ne kemi bërë kërkesë dhe, mbi atë

ligj, kërkojmë që ai komision të ngrihet. Pse? Sepse duhet të dalin këtu të gjitha të zezat e kësaj sjelljeje, jo thjesht korruptive të Edi Ramës, por qëllimi i tij për të shkatërruar opozitën, që ta ketë sallën bosh. Pse? Që ju më pas të votoni si noterë me kokën ulur. Unë e di që ka këtu kolegë socialistë, që janë dakord me mua në fund fare, që e mbajnë kokën ulur, sepse e di që nuk do ta pranonin në kushte të tjera. Po sot ua ka ulur kokën Edi Rama. Pra, sot duhet që ky parlament të hetojë në të drejtën e vet. Ka vendime të Gjykatës Kushtetuese, dhe po jua kujtoj këtu, se ka ende deputetë (në fakt, është turp), se ka një marrëveshje në dhjetorin e vitit 2014 për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, sepse Edi Rama e pengonte. E mbështeti Parlamenti Europian atë marrëveshje, sepse ky parlament dhunon edhe atë që thotë Gjykata Kushtetuese.

Kemi kërkuar mocion me debat për këtë çështje. Shtyhet. Kemi kërkuar seancë me pyetje të deputetëve, duhet të bëhet çdo javë, shtyhet. Kryeministri nuk vjen këtu, sepse ka hall se po foli, do t'i mbahet shënim çfarë thotë. Po e drejta jonë për ta bërë këtë është tani. Ne i kemi kërkuar këto gjëra. Janë përjashtuar më shumë se 15 deputetë, janë përjashtuar në grup, pikërisht për të zbratur pjesën e opozitës nga aftësia e saj vendimmarrëse për të vendosur, për të votuar këtu në parlament. Dhunim më brutal se kaq...

Të lutem, do ta vazhdoj!

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, fjala ju dha për procedurë, ju nuk po flisni për procedurë, dhe kohën e kaluat.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ju lutem, kolegë, kjo sjellje e fryrjes së bilbilit nuk ju bën të nderuar. Kështu që evitojini këto lloj sjelljesh! Ne jemi aq madhorë, sa të flasim me arsye me njëri-tjetrin.

Ju lutem, përfundojeni fjalën! Zoti, Bylykbashi, jua kam dhënë fjalën, ju lutem, përmbylleni!

**Oerd Bylykbashi** - Kemi kërkuar të drejtat tona në këtë parlament për të përfaqësuar ata që janë jashtë kësaj salle. Ju bëni çfarë të doni vetë, por ju nuk mund të përjashtoni. Kemi bërë sot një kërkesë, e cila pezullonte automatikisht vendimin për përjashtimin e deputetëve. Ata duhej të ishin këtu në sallë, por ju në mënyrë të paligjshme i latë jashtë duke abuzuar me Gardën, e cila ka për detyrë jo të respektojë urdhrat e drejtuesve të Kuvendit, por ligjin. Deputetët duhet të ishin këtu

në sallë. Nuk janë njoftuar për mbledhjen e Byrosë dhe janë shkelur përsëri të drejtat e tyre, por këtu nuk është çështja e të drejtave individuale të deputetëve, është e drejta e opozitës për t'i kërkuar llogari qeverisë. Ju jeni gati të mbyllni çdo lloj cikli, fikni edhe dritat po të jetë e mundshme, prishni edhe mikrofonat vetëm të mos ndodhë ajo që kërkojnë sot shqiptarët: të nxjerrin llumin e kësaj çështjeje për të kuptuar se si nëpërmjet atij akti...

**Ermonela Felaj**– Faleminderit, zoti Bylykbashi!

**Oerd Bylykbashi** – Edhe pak.

**Ermonela Felaj** - Jo, ju lutem, ju nuk mund të jeni kaq abuzivë: edhe të kërkon kohë, edhe pastaj të mos përfundoni dot.

**Oerd Bylykbashi** – Shqiptarëve iu mohohet e drejta për të pasur punë, ushqim, arsim.

**Ermonela Felaj**– Ju lutem, a mund të respektojmë edhe kolegët e tjerë që kanë kërkuar fjalën?

**Oerd Bylykbashi** - Ju lutem, pa u respektuar të drejtat e opozitës...

**Ermonela Felaj** - Më duket shumë arrogante që dikush pushton foltoren dhe nuk i lë të tjerët të flasim.

**Oerd Bylykbashi** - Ju keni përjashtuar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** – Zoti Spaho, juve jua dhashë fjalën, u shprehët nga vendi, i shprehët qëndrimet tuaja, zoti Bylykbashi po ashtu.

Ju lutem, zoti Alibeaj e ka kërkuar fjalën për procedurë.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ju edhe mund ta bëni këtë sjellje, nëse mendoni se u shkon thinjave tuaja, vazhdojeni! Unë ju ftoj të mos e bëni këtë sjellje, sepse kjo cenon nderin e parlamentit dhe konsumon edhe respektin, që natyrshëm çdo zgjedhës duhet të ketë ndaj të zgjedhurve të vet, pavarësisht cilit krahi i përkasin.

Kolegë, ju ftoj të uleni dhe t'u lini mundësi fjale të gjithë kolegëve të tjerë, për po ato çështje për të cilat ju jeni duke folur.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Spaho, a do të më lejoni të dëgjoj kërkesën e kolegut tuaj? A do të uleni në vend?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, do të vendos për kërkesën tuaj, por, ju lutem, komunikoni me kolegët që të uleni, sepse,

nëse ndodh kjo gjë në Kuvend, do të thotë se nuk ka normalitet në seancë.

Kështu që, ju lutem, zoti Bylykbashi, po ju dëgjoj me vëmendje dhe jam e prirur t'ju jap fjalën. Ju lutem, kolegëve të ulen!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Lutjuni kolegëve tuaj të ulen.

Ju lutem, kjo nuk është garë se kush e pushton foltoren. Ju lutem, a do të më lini edhe mua ta drejtoj këtë seancë në mënyrë të rregullt?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kolegët të ulen, zonja Metaliaj, zonja Bardeli, ju lutem uluni! Të paktën, nuk është nevoja që edhe zonjat deputete të bëjnë këtë lloj shfaqjeje, besoj se është e tepërt, sepse këtu po i jepet fjala çdo kolegu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kjo që po bëni ju, në fakt, provon të kundërtën. Ju lutem, zini vend! Nuk lejohet të pushtosh foltoren.

Zoti Alibeaj, fjala është për ju.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Jo, jua thashë zoti Bylykbashi.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

**Enkelejd Alibeaj** – Zonja Felaj, ti nuk mund të bësh predikime këtu sikur po fyhesh apo po ruan imazhin e parlamentit, sepse e fillove që në momentin e parë duke gënjyer.

Për të sqaruar publikun, sepse besoj se është e rëndësishme që në këtë parlament duhet të sqarohet publiku (votat ju i keni dhe mund të bëni gjithçka në këtë mes), pra, kam detyrimin për të sqaruar atë që ka ndodhur në Konferencën e Kryetarëve, pasi gënjeve kur the se kanë rënë dakord. Nuk është rënë dakord. Ka pasur 4 kërkesa në Konferencën e Kryetarëve: një interpelancë të kërkuar nga ana ime; një kërkesë për pyetje-përgjigje, të kërkuar nga një pjesë deputetësh; një kërkesë për mocion me debat për çështjen “Rama-McGonigal”; dhe një kërkesë për një komision hetimor.

Çfarë thatë ju? Ju thatë që po i bashkojmë bashkë. Po, dakord, po i bashkojmë bashkë, por kini parasysh që, nëse ato bashkohen bashkë, do të duhet të shqyrtohen sot, sepse, sipas Rregullores, zonja drejtuese e seancës, interpelanca shqyrtohet në seancën e parë vijuese, dhe seanca e parë vijuese është kjo e sotmja. Ndaj, zonjë e nderuar, ke detyrimin jo për ta hedhur në votë, por për të vendosur në rendin e ditës pikërisht interpelancën e kërkuar prej meje,

seancën e pyetje-përgjigjeve të kërkuar prej deputetëve të tjerë, mocionin për të cilin ju thatë në Konferencë se e pranuat, e sigurisht edhe vendimin për komisionin hetimor, sepse të thuash se nuk pranohet komision hetimor me idenë se do të bëjmë një ligj tjetër për komisionet hetimore, ndërkohë që ligji është, ky është thjesht dhe vetëm një provokim që ju i bëni këtij parlamenti, Kushtetutës dhe ligjit, për t'i dhënë të drejtën opozitës për të ushtruar të drejtat e veta.

Ndaj, zonjë, bëjeni këtë gjë, e keni detyrim, nuk keni të drejtë ta hidhni në votë! Do të duhet të fillojmë me çështjen e parë, me interpelancën që kam kërkuar me Kryeministrin e vendit, Edi Ramën. Ndaj, mos e provoko parlamentin. E di që ju intereson kjo situatë, por ne duam të flasim me Kryeministrin, të vijë aty dhe të na japë sqarime për një çështje që prek të gjithë shqiptarët! Kjo është ajo që duhet të bëni ju dhe mos vazhdoni më duke marrë masa të tjera për të përjashtuar edhe pjesën tjetër të parlamentit.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Fjalën e ka zoti Balla.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Ju lutem, fjalën e ka kryetari i Grupit të Partisë Socialiste, zoti Balla!

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Po ka edhe një radhë. Ka folur një kryetar grupi, ka bërë një kërkesë, kështu që unë do t'ia jap fjalën kryetarit të grupit parlamentar.

**Taulant Balla** – Keni folur 10 veta, të flasim edhe ne një herë?

*(Zhurma bilbili në sallë)*

**Ermonela Felaj** – Si funksionon kjo, të flasim vetëm nga njëra anë, se nuk keni durim të prisni? Për më tepër, zoti Alizoti, nuk jeni ju në radhë për ta marrë fjalën për procedurë, sepse janë zoti Mziu, zoti Vasili, zonja Ačka, zoti Sula, ndërsa ju jeni në fund.

Ju lutem uluni, fjalën e ka zoti Balla! Do ta merrni fjalën të gjithë me radhë.

A mund të kini pak durim, ju lutem?

Zotëri, Kuvendi ka rregullat e veta si funksionon dhe si komunikon. Juve mund të mos ju pëlqejë, por unë në këtë detyrë për të siguruar radhën e fjalës për secilin kolegu, jam e detyruar të ndjek sistemin e regjistrimit për kërkesën për fjalë për çdo deputet.

Ju lutem, uluni se kjo është krejt e qartë dhe nuk ia vlen ta bëjmë këtë debat!

Fjalën e ka zoti Balla.

**Taulant Balla** – Po edhe fjala për procedurë ka një rend, një herë këtej e një herë andej.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sa keqardhje...

**Ermonela Felaj** – Zoti Balla, ju lutem, ju është dhënë fjala!

**Taulant Balla** – Kur merret fjala për procedurë, fjala fillon nga neni i Rregullores, të cilit i referohesh. Ka folur zotëria që ka bllokuar foltoeren, foli një zotëri tjetër këtu...

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Në nenin 89 të Rregullores flitet qartë për situatën në të cilën jemi. Në Konferencën e Kryetarëve kemi miratuar bashkimin e të tria kërkesave. Mirëpres nga kryetari i Grupit Parlamentar të PD-së, zoti Alibeaj, nga zoti Mediu dhe nga zonja Doda, propozimet për kohën e zhvillimit të mocionit me debat. Propozimi ynë është 12 orë dhe besoj se 12 orë, ose 5 minuta për çdo deputet janë tërësisht të mjaftueshme për zhvillimin e një mocioni me debat.

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Natyrshtëm, ne e dimë që ky skenar ndodh në çdo seancë, sepse ndërkohë që sot familjarët e personave, të dëshmorëve të vrarë më 21 janar janë në prokurorinë speciale SPAK, për depozitimin e një kallëzimi penal ndaj Sali Berishës dhe të personave të tjerë të përfshirë në vrasjet e 21 janarit, ne do të jemi në këtë situatë në Kuvendin e Shqipërisë. Ndërkohë që familjarët e personave të “21 janarit” janë në prokurorinë speciale antikorruption, ku akuzojnë Sali Berishën për vrasje në bashkëpunim, kjo situatë do të jetë. Ndërkohë që në prokurorinë speciale antikorruption është ngritur akuzë për vrasjet në Gërdec, kjo situatë do të jetë. Merrni dhe lexoni një nen të Rregullores që është shkëlur!

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Është e papranueshme që ju të çoheni! Dhe kë mbroni!? Mbroni një deputet që vinte vërdallë nëpër seancë, i pirë, me një bilbil në gojë dhe nuk i linte deputetët të flisnin. Prandaj, sa i përket...

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Po, jemi dënuar dhe e kemi marrë dënimin e Byrosë së Kuvendit të asaj kohe.

Zonja drejtuese e seancës, ju lutem, të kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës, sepse na

duhet të flasim në emër të njerëzve që na kanë sjellë në këtë sallë!

Përpjekjet për të penguar zhvillimin normal të seancës, nuk mund t'i pranojmë. Ne jemi këtu për të vijuar normalisht seancën.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Balla!

Në lidhje me këtë pikë...

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Ju lutem, a mund ta kuptoni çdo kërkesë që thuhet këtu dhe pastaj ta merrni fjalën secili?!

Në nenin 89 të Rregullores, thuhet shprehimisht: “Data për zhvillimin e mocionit me debat përcaktohet me mirëkuptim në Konferencën e Kryetarëve dhe kjo i njoftohet Kuvendit”. Kjo gjë, sikundër e shprehu edhe zoti Alibeaj, nuk ka ndodhur, nuk ka pasur mirëkuptim në Konferencën e Kryetarëve. “Në rast se në Konferencën e Kryetarëve nuk arrihet mirëkuptim mes kryetarëve të grupit, atëherë Kryetarja e Kuvendit i drejtohet seancës”. Kryetarët e grupeve parlamentare nuk janë mbledhur për të rënë dakord në lidhje me kohën e zhvillimit të mocionit, të interpelancës urgjente dhe të pyetjeve. Për këtë arsye nuk i paraqesim seancës asgjë për votim, sepse jeni ende brenda kohës, prandaj, ju lutem kryetarëve të grupeve parlamentare të mblidhen, përndryshe kohën e zhvillimit të debatit do ta vendosë seanca me votim.

Fjalën e ka kërkuar zoti Mziu.

Zoti Spaho, ju tërheq vëmendjen për sjelljen tuaj në Kuvend.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju mund të vazhdoni, por të jeni të sigurt se edhe ne do të vazhdojmë të zbatojmë Rregulloren, veçanërisht për ato raste kur vendosni të mos i thërrisni arsyet.

Zoti Mziu, fjala është për ju.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, po flas me zotin Mziu!

**Xhelal Mziu** – Zonja drejtuese e seancës,

Është absurde që në seancën e gjashtë ne nuk po i zhvillojmë punimet në parlament për shkak të sjelljes arrogante të mazhorancës, duke hequr fjalën e lirë dhe duke përdorur përjashtimet në mënyrë masive. Sot ne kemi të përjashtuar nga parlamenti jo pak, por 18 kolegë, kjo vetëm për shkak të kapriçiove të mazhorancës. Kjo është absurde!

Madje, sot një grup kolegësh, deputetë të përjashtuar, prapë pa asnjë arsye, paraqitën një

ankesë, në zbatim të Rregullores, për funksionimin e parlamentit, e cila u mor në shqyrtim nga Byroja Parlamentare.

Së pari, duhej që deputetët të ishin të pranishëm në këtë mbledhje, por Rregullorja nuk u zbatua.

Së dyti, nuk u plotësua kuorumi i nevojshëm, kështu që mbledhja nuk duhej të vazhdonte.

Në këto kushte do të kërkoja që deputetët, të cilët kanë bërë ankimim, të jenë pjesë e kësaj seance ose të mbyllet seanca dhe të zhvillohet mbledhja me kuorumin e nevojshëm dhe në praninë e deputetëve që kanë paraqitur ankimimin e tyre ndaj Komisionit të Etikës.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Mziu!

Në vijim të kërkesës...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, po flas për kërkesën tuaj dhe për vendimin e Byrosë, apo, më saktë, të ankimit të bërë nga disa kolegë deputetë. Po ju citoj emrat e tyre: zoti Noka, zoti Paloka, zoti Këlliçi dhe zoti Berisha, ankim ndaj vendimit nr. 38, datë 15.2.2023. Vendimi është i Sekretariatit për Etikën, Procedurat dhe Votimin. Kjo kërkesë ankimore është depozituar disa minuta përpara orës së çeljes së seancës plenare dhe menjëherë është urdhëruar mbledhja e Byrosë së Kuvendit. Janë njoftuar rregullisht anëtarët e Byrosë së Kuvendit, të cilët kanë marrë pjesë. Kuorumi ka qenë i plotë dhe zoti Mziu ka qenë pjesë e asaj mbledhjeje, e cila është regjistruar rregullisht, ka proceduar në kohë reale dhe në përfundim të mbledhjes është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 38, datë 15.02.2023, të Sekretariatit për Procedurat, Etikën dhe Votimin. Vendimin e gjeni të publikuar në faqen e Kuvendit.

Theksoj se vendimi i Byrosë është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm menjëherë.

Zoti Bylykbashi, do t'ju jap fjalën, nëse ulen kolegët tuaj.

Fjalën e ka kërkuar zoti Vasili.

**Petrît Vasili** – Zonja drejtuese e seancës,

E gjithë kjo seancë ka filluar në parregullsi të plotë. Ju e keni hapur seancën në orën 10:40, kur seanca duhej të hapej në orën 10:00. I gjithë ky manipulim është bërë në mënyrë që kolegët të mos hynin në sallë dhe për këtë ju mbani përgjegjësi, kështu që nuk mund ta vazhdoni këtë seancë, të cilën ju e keni manipuluar pa filluar. E para.

E dyta, nuk është pronare Kryetarja e Kuvendit për pyetjet e deputetëve. Në rast se këtu është konfirmuar (se dakordësi nuk ka pasur, edhe për këtë çështje, sikurse e konfirmoi kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike), jeni sërish në një manipulim të hapur, shumë flagrant dhe asnjë prej jush dhe asnjë lloj mazhorance këtu nuk del dot të imponojë mashtrim për fakt të kryer.

Lidhur me këtë çështje ju nuk mund të vazhdoni dot sikur nuk ka ndodhur asgjë, ju mund ta bëni dhe nuk ka asnjë problem, se nuk keni autoritet të veçantë, jeni zëvendësuese apo bedeli i radhës këtu, sepse Kryetarja nuk vjen. Nga kjo pikëpamje, ky standard nuk mund të vendoset kurrën e kurrës.

Sa u takon kërkesave dhe pretendimeve tuaja, se do të mbani standardin e Rregullores, këtu e keni, në qoftë se i dëgjoni, këtu në mikrofon dëgjohen shumë qartë se cilat kanë qenë boritë, sirenat dhe të gjitha gjërat e tjera të aplikuara, ja ku i keni (tregon video), kjo ka qenë mazhoranca dhe në opozitë. Ja ku e keni: me sirena, me bori, me bilbila e me të tjera. Apo ka dy standarde? Kur jemi në mazhorancë dhe na duhet të mbajmë pushtetin, bilbili është faj, kur jemi në opozitë dhe jemi vetë, bilbili është meritë. Po ju kujtoj se në atë kohë nuk përjashtoheshin 18 apo 20 deputetë. Apo, ju keni standardin tuaj?

Është e turpshme dhe një fatkeqësi e madhe që të kesh gjëmuar në sallën e parlamentit, siç e keni këtu, të gjithë ju pa përjashtim, sepse ka plot nga këta këtu që janë sot në sallë, pastaj të bëni standardin e shenjtërisë së Rregullores, të cilën e shkatërroi dhe e shkëlqi vazhdimisht. Unë jam ndërmjet atyre që kanë bërë pyetje dhe të drejtën e pyetjeve nuk ma jepni ju, por ma jep Rregullorja e Kuvendit dhe asnjë njeri nuk mund të marrë vendim mbi pyetjen time, nuk thuhet gjëkund në Rregullore kjo punë, as Kryetarja e Kuvendit nuk e thotë dot këtë gjë, sepse jam unë ai që kam të drejtë ta bëj pyetjen.

Kështu që, për këto tjetërsime, për këtë rrëmbim të Rregullores, për këtë marrje peng të parlamentit, që keni marrë përsipër të bëni, sigurisht që këtë përgjigje do të keni, sepse ne nuk mund të pranojmë që të na merrni peng; të barabartë po, por peng jo. Salla këtu nuk është as e mazhorancës dhe as e drejtuesit të seancës, por është e deputetëve, të cilët ndahen vetëm kur votojnë. Kë votojnë dhe kë nuk votojnë është në



diskrecionin e tyre. Kjo seancë është nul, sepse ka filluar me mashtrim.

Më së fundi pamë që u provua se e gjithë kërkesa për t'i ikur interpelancës së pyetjeve dhe mocionit, është mashtrim. Seanca duhet të ndalet, të vijë Kryeministri dhe t'u japë përgjigje pyetjeve. Këtë detyrim nuk e ka për qejfin e opozitës, por e ka si detyrim ndaj Rregullores. Në të kundërt, kur Rregullorja nuk vepron, atëherë do të veprojmë në këto mënyra për të vendosur prapë rendin.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Vasili!

Keni marrë 37 sekonda mbi kohën normale.

**Petrit Vasili** – Punë e madhe se mora 37 sekonda. E çfarë, po më bëni dhuratë?!

**Ermonela Felaj** – Kjo ishte vetëm për kujtesë.

**Petrit Vasili** - Ju po e shkelni Rregulloren nga mëngjesi deri në darkë dhe po më numëroni sekondat mua!

**Ermonela Felaj** – Nëse ju mendoni se precedentët, me të cilët nuk keni rënë dakord, janë burim e drejte për ju, atëherë vendosni: jeni ju zoti Vasili i disa viteve më parë, apo ju që po shfaqeni sot?!

Të vijmë te thelbi i gjësë, zoti Vasili, ju dëgjova me shumë vëmendje, edhe pse asnjëherë nuk tregoni kujdes për të mos i fyer kolegët, por kjo nuk përbën më asnjë shqetësim për askënd, ju siguroj për këtë; kjo flet për mungesën e argumentit nga ana juaj. Kërkesa juaj për pyetje ka qenë e njëjtë me kërkesën për interpelancë, ka qenë e njëjtë me mocionin për debat dhe për këtë, po, kemi pasur dakordësi që ato të gjitha të zhvilloheshin. Për mënyrën se si do të zhvilloheshin, nuk ka pasur dakordësi nga kolegu Alibeaj, por ama Konferenca e Kryetarëve ka qenë dakord që të hiqnin kufizimin kohor dhe 40 deputetët të mund të flisnin në kohën maksimale që parashikon Rregullorja për çdo deputet, dhe këtë e provon procesverbali i zbardhur i mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve. Kjo është kështu siç unë po jua citoj. Ju lutem, nëse dëshironi, bëjuni thirrje kolegëve tuaj, kryetarëve të grupeve parlamentare, të ulen dhe pastaj drejtuesi i seancës do të vendosë!

Zoti Vasili, nuk flet drejtuesi i seancës pa folur parlamenti, ju lutem, ky është rregulli minimal!

Zonja Aça e ka kërkuar fjalën.

**Flutura Aça** – Faleminderit, zonja Felaj!

Në sytë e mi, po e them publikisht para shqiptarëve, kjo që po bëni ju është një krim kushtetues. Ka që në datën 22 dhjetor që këtu nuk ka folur asnjë deputet. A e kuptoni se çfarë po bëni ju?! Ky është kthyer në një parlament fashist, me këto forma përjashtimi që ju u bëni deputetëve, kështu që mblidhni mendtë e kokës, sepse kështu nuk mund të vazhdohet më!

Kush jeni ju që nuk e sillni këtu Kryeministrin?! Kryeministri duhet të vijë këtu! Në datën 22, ma ka thënë mua personalisht me një përvuajtje të madhe, që nuk është as mafioz, as i korruptuar dhe se as nuk ka bërë këtë apo atë. Gjysmë ore është marrë me mua personalisht. Unë kam vetëm 10 minuta në dorë për t'i bërë disa pyetje, nëse është ose jo i korruptuar. Silleni Kryeministrin, që ky parlament të vihet në baza! Dakord, zonja Felaj?! Kjo është kërkesa e parë.

E dyta, një çështje shumë të rëndësishme që kam unë sot për këtë parlament është që t'i them si mazhorancës, ashtu edhe opozitës, se nesër Kosova bën 15 vjet pavarësi dhe ky parlament nuk gjeti dot në rendin e ditës qoftë edhe gjysmë ore për të përshëndetur Kosovën.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

E di. Ju mund të mos e pëlqeni Albin Kurtin apo Vjosa Osmanin, por bëni detyrimin si shqiptarë. Këtë gjë po jua jap si vërejtje personale, sepse në këtë parlament ne nuk gjejmë dot as gjysmë ore, por unë mendoj se duhet një seancë e tërë parlamentare për t'ia kushtuar Kosovës në këtë moment shumë të rëndësishëm të bisedimeve Kosovë-Serbi. Kjo është një vërejtje shumë serioze për ju.

Uroj që ju do ta gjeni një mundësi, që të paktën ditën e hënë, të bëhet një seancë parlamentare kushtuar Kosovës.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Aça!

Më lejoni t'ju njoftoj se ditën e djeshme ambasada e Kosovës, zoti Skënder Dyrmishi që është ambasadori, ka zhvilluar një aktivitet dhe Kuvendi është përfaqësuar nga zëvendëskryetarja, që përfaqëson mazhorancën.

Ju lutem, të gjitha nderimet përkatëse do të bëhen, patjetër që mund të merret në konsideratë edhe kërkesa juaj, për dashamirësi mund të ishte bërë edhe më parë, sepse rendi i ditës njoftohet të paktën 2 ditë para, kështu që disa gjëra nuk është e nevojshme që ne t'i lëmë në momentin e fundit,

besoj unë. Kjo ishte për dashamirësi. Nuk kam asnjë gjë tjetër, sepse nuk përbën problem.

Zoti Sula.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

**Dashnor Sula** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Unë do t'jua them publikisht dhe nuk kam turp ta them: më vjen turp që jam pjesë e këtij parlamenti.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Taulant, nuk jam si ti.

Po jua them këtë, sepse unë së bashku me disa deputetë, bëhemi rreth 10 deputetë, që kemi 20 vjet në këtë parlament së bashku me kryetarin e grupit tuaj parlamentar, zotin Balla, por një situatë e tillë, si kjo e tanishmja, nuk ka ndodhur. Do të jetë një turp për parlamentin, nëse do të vazhdojë me këtë situatë!

Deputetët, të cilët kanë memorie, të paktën që nga viti 2005, kur u bë rotacioni i pushtetit, ne sapo kishim ardhur në pushtet dhe problematikat ishin shumë të vogla, por opozita kudo shkonte me vuvuzela, bilbila dhe çfarëdolloj gjëje. Pavarësisht rezervave që kam pasur për drejtuesen e Kuvendit të asaj kohe, zonjën Topalli, nuk ka ndodhur kurrë që një deputet të përjashtoj nga parlamenti.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Prit, ta mbaroj fjalën.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Kjo do të thotë...

**Ermonela Felaj** – Kolegë, ju lutem!

Zoti Sula, a mund ta ruani qetësinë?

**Dashnor Sula** – Nuk të vjen mirë ty.

**Ermonela Felaj** – Zoti Sula, ju lutem, përpikuni të mos hyni në konflikt me kolegët, mbajeni fjalën dhe shqetësimin tuaj!

**Dashnor Sula** – Unë nuk hyj në konflikt, por thuaji kryetarit të grupit tënd parlamentar të mos flasë.

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, unë po u kërkoi konsensus të 140-ve!

**Dashnor Sula** – Të lutem, unë po ju them se parlamenti duhet kthyer në shinat normale të funksionimit të tij!

Po ashtu, po ju them, dyshoj shumë, se kjo situatë, që është në këtë moment, është e stisur, që u intereson të dyja palëve. Pse e them këtë gjë?

Zonja drejtuese e seancës, e them këtë gjë, sepse në momentin që ne kërkua interpelancën, sipas nenit 97 të Rregullores të Kuvendit, ishte

shumë e thjeshtë që të vinte Kryeministri të na jepte shpjegime, por ju nuk e sollët Kryeministrin, ose ai nuk donte të vinte duke rritur tensionin e të dyja palëve. Situata ka ardhur në një moment dhe në një formë të tillë që të gjitha palët janë involvuar në një kazan dhe, duke qenë në një kazan, edhe pjesa e shëndoshë e PD-së, e opozitës, edhe pjesa e shëndoshë e PS-së, nuk kanë zë të flasin. Juve ju intereson ta rritni tensionin, të krijohen probleme këtu në parlament dhe të krijohet konflikt kudo. Në këtë pikë kanë ardhur ngjarjet. Memoria e qytetarëve nuk është kaq e shkurtër. Këtë tension po e rritni me një qëllim të caktuar: për ta larguar vëmendjen nga SPAK-u; për ta larguar vëmendjen nga ndërkombëtarët dhe nga SHBA-të.

Zonja Kryetare, ju kërkoi ta futni parlamentin në normalitet: Kryeministri të vijë këtu, sepse ne fjalën kemi; opozita të mos bëjë më veprime të tilla. Por duke e joshur opozitën, duke i hedhur grepin, opozita reagon, sepse nuk ka çfarë të bëjë. Ju jeni përgjegjës që parlamenti të ketë normalitet. Nëse ju do të respektoni Rregulloren, do të respektoni Kushtetutën, nëse do të ketë normalitet dhe nuk do t'i rritni tensionet, edhe opozita nuk ka për të dalë këtu.

E tha zonja Aça shumë qartë: kemi që nga dhjetori që nuk flasim për hallet dhe problemet e qytetarëve. Nuk janë hallet dhe problemet e qytetarëve që palët t'i thonë njëra-tjetrës: “Hajdutë, hajdutë...”, por të dalim të diskutojmë, të debatojmë. Ju shkëlmi Rregulloren dhe Kushtetutën duke mos i zhvilluar punimet e parlamentit në normalitet dhe duke mos folur për pikat e rendit të ditës. Nëse do të arrini përsëri ta mbyllni parlamentin, siç e bëri zonja Nikolla, duke i kaluar pikat e rendit të ditës, nuk funksionon kështu; nuk shkon kështu. Mbajeni mend që sot në këtë datë...

**Ermonela Felaj** – Zoti Sula, ka mbaruar koha që ju kishit në dispozicion për të mbajtur fjalën. Ju lutem, ju lashë edhe 33 sekonda më tepër!

**Dashnor Sula** – Unë nuk shquhem që të kem konflikte në parlament; nuk e kam bërë as kur kam qenë në mazhorancë. Do ta mbyll me dy fjalë...

**Ermonela Felaj** – E kuptoj vështirësinë për ta dëgjuar teknikën, kur njofton përfundimin e fjalës, por kolegët tuaj kanë vendosur që ta zhurmojnë seancën...

**Dashnor Sula** – Edhe për atë që tha zoti Balla, më vinte turp kur ne silleshim ndaj opozitës...

**Ermonela Felaj** – Zoti Sula, ju lutem, janë disa kolegë me radhë që e kanë kërkuar fjalën për procedurë.

**Dashnor Sula** – Mbarova... Po e mbyll fjalën time.

**Ermonela Felaj** – Nuk mund të jemi kaq invazivë.

**Dashnor Sula** – Nuk jam ashtu. Po e them përsëri që më vinte turp për sjelljen tonë si mazhorancë në raste të caktuara ndaj opozitës së asaj kohe. Duhet t'i vijë turp kësaj mazhorance që sillet kështu sot! Thirrini mendjes! Thirrini mendjes dhe ktheni normalitetin në parlament!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, të paktën të mund të jemi konsensualë për aq sa gjithsecili ka të drejtë të flasë, sepse unë nuk po e kapërcej radhën, por po mundohem të tregohem e paanshme në dhënien e fjalës për procedurë, edhe pse deri tani nuk ka pasur kërkesë për procedurë.

Zonja Tabaku e ka kërkuar fjalën.

**Jorida Tabaku** – Zonja drejtuese e seancës, unë dhe shumë kolegë në këtë parlament fjalën kemi pasur. Opozita në vitin 2006, vetëm një vit pasi PD-ja erdhi në qeverisje, e bëri çështjen e Kryetares së Kuvendit të dilte edhe në progresraport. U ngrit i gjithë Parlamenti European, u ndryshua Rregullorja, që opozita të kishte hapësirën e saj që të ngrinte komisione parlamentare, të kishte mocione, të kishte interpelancë, që përfaqësuesi i opozitës të fliste pas Kryeministrit të vendit dhe të kishte hapësirë në parlament. Sot, kjo nuk po ndodh. Mua më vjen mirë që një grup kolegësh nga Partia Demokratike duan të përdorin instrumentin e komisionit hetimor, dhe biem dakord...

*(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon.)*

Një sekondë, me qetësi. Biem dakord që komisioni hetimor është instrument i mirë kontrolli, dhe e mbështes këdo që do ta ushtrojë këtë funksion, ashtu siç mbështes këdo që do të bëjë interpelancë dhe mocion me debat. Qeveria nuk mund të fshihet përjetësisht. Qeveria duhet të vijë dhe të japë përgjigje, duhet të tregojë dhe të bëjë transparente këtu se çfarë ka ndodhur me përfshirjen e Kryeministrit dhe të qeverisë shqiptare në raportin dhe aktakuzën e FBI-së.

Sot, zonja Felaj, ne ndodhemi në një moment shumë të vështirë, qytetarët presin nga ne përgjegjësi e përgjegjshmëri; kemi 3 muaj që nuk flasim dot për buxhetin. Sot kalon një kontratë, të cilën qeveria e sotme e ka quajtur abuzive dhe korruptive: kontrata e pullave fiskale. Unë dua të flas për kontratën e pullave fiskale. Dua të flas sot për ndryshimin e ligjit “Për kontrollin financiar”. Dua të flas për përjashtimin e Kryetares së Kuvendit, sepse e kemi iniciuar ne si opozitë.

Të nderuar kolegë, në qoftë se ka një institucion, të cilit i intereson që ne të mos flasim sot për asgjë në këtë vend, është qeveria. Në qoftë se i intereson dikujt që ne të mos bëjmë transparencë, është qeveria. Njerëzit presin që ne të flasim për ta, sepse për këtë jemi votuar.

Zonja Felaj, ka pasur dy kërkesa për ndryshimin e ligjeve të komisioneve hetimore: para një viti nga zoti Spaho dhe pak muaj më parë nga unë. Ato kërkesa do të jenë atje, në sirtarët e Kuvendit, për muaj e për vite të tjera. Çfarë e pengon Kuvendin të ngriejë një komision hetimor dhe t'i japë opozitës të vetmin instrument që ka në dorë për të kontrolluar? Nuk besoj se kjo sjellje ju bën nder juve, i bën nder opozitës dhe sjell ndonjë përfitim për qytetarët. Sot njerëzit presin që ne të flasim për korrupsionin, për ekonominë, për shpopullimin. Njerëzit presin nga deputetët e parlamentit të Shqipërisë që të ofrojnë zgjidhje, por ju nuk po ua jepni dot këtë zgjidhje, as ne nuk po ua japim dot këtë zgjidhje.

Kështu që. ta sjellim seancën në binarë. Lejoni një nga kërkesat e opozitës për ngritjen e komisionit hetimor, ose për përfshirjen në rendin e ditës të mocionit dhe të interpelancës, pastaj të diskutojmë njëkohësisht edhe për pikat e rendit të ditës! Besoj se jemi këtu për të folur për qytetarët, na lejoni që të flasim për ta!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Tabaku!

Ndërkohë, kolegë që rrini në këmbë, të paktën kur flasin kolegët e grupit tuaj, mund ta hiqni zhurmuesin! Këtë mund ta bëni. Nuk është normale që të vijoni në këtë mënyrë.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Fjala për zotin Balla.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Deri tani kanë folur vetëm kolegët e PD-së. Kryetari i Kuvendit ka detyrimin ta harmonizojë fjalën. Për qëndrimet e shprehura nga disa kolegë,

të cilët kërkojnë vijimin e normalitetit të seancës plenare, sigurisht, ka propozime konkrete dhe, sigurisht, do t'ia jap fjalën kryetarit të Grupit Parlamentar të mazhorancës.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

**Taulant Balla** – U përmend këtu viti 2006. Në fakt, kanë qenë dy seanca, një në shkurt dhe një në vjeshtë, kur Grupi Parlamentar i asaj kohe i Partisë Socialiste, ku kam qenë anëtar së bashku me kolegë të tjerë, ka depozituar kërkesa për shkarkimin e Kryetares së Kuvendit të asaj kohe, Jozefina Topalli. Arsyeja e protestës së deputetëve gjatë asaj kohe ishte se, edhe pse Kushtetuta e sanksiononte në mënyrë të qartë që votimi për shkarkimin e Kryetares së Kuvendit të ishte i fshehtë, në mënyrë të paligjshme kjo kërkesë nuk pranohej nga drejtuesit e Kuvendit të asaj kohe. E vërteta është që edhe në progresraport është përfshirë kërkesa që votimi për shkarkimin apo emërimin e Kryetares së Kuvendit apo për institucione të tjera kushtetuese të jetë i fshehtë. Kaq ka qenë çështja. Nëse ju do të kishit një kërkesë të ngjashme, nuk keni nevojë të protestoni, sepse ajo miratohet automatikisht nga ana jonë. Bindja jonë, që prej ditës së parë kur jemi bërë shumicë në këtë vend, është: kurrë ndonjëherë t'i bëjmë opozitës ato që kemi vuajtur me ju.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

E vërteta është se kjo që po ndodh, nuk ka lidhje fare me ndonjë procedurë parlamentare. Ky është një urdhër. Ju vetëm zbatoni urdhrin. Tha një zotëri, i cili ka marrë përsipër të bëjë rolin e Flamurit sot, se ka një marrëveshje për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Nuk ka nevojë për marrëveshje për të zbatuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ato zbatohen automatikisht. Prandaj, Kuvendi i Shqipërisë me vendimin e seancës plenare të datës 23 janar ka ngritur një komision të posaçëm për ndryshimet në ligjin “Për komisionet hetimore”, ku të transpozohen vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ky komision i posaçëm është ngritur dhe ai vendim duhet zbatuar. U kërkoj grupeve parlamentare, sikurse kemi bërë edhe ne, të depozitojnë emrat e anëtarëve të këtij komisioni të posaçëm.

Për sa i përket zhvillimit të mocionit me debat, kërkesa është miratuar, por ju nuk keni asnjë interes të bëni mocion me debat për këtë

çështje. E vërteta është se kontratat, oligarkut rus, ia keni dhënë ju bashkë me Saliun tuaj.

Në lidhje me propozimin e zonjës Açka, zonja Açka, unë e përgëzoj vizitën më të fundit të Komisionit të Integritimit Europian në Kosovë në kuadër të një shkëmbimi të vizitave mes dy kuvendeve tona. Në datën 27 nëntor të vitit të kaluar, do ta quaja një rast historik, Kuvendi i Shqipërisë dhe Kuvendi i Kosovës kanë zhvilluar për herë të parë seancën e tyre të përbashkët...

*(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon.)*

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, zoti Spaho, mos komunikoni me kolegët e tjerë, sepse jam e detyruar t'ia njoh kohë shtesë deputetit Balla, për shkak se ju po ia pamundësoni fjalën.

**Taulant Balla** – Në rastin e 15-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, natyrshëm që Kuvendi i Shqipërisë duhet t'i mbështesë proceset e rëndësishme, në të cilat është angazhuar Kosova. Sa herë Kosova ka pasur një moment të vështirë, aty gjendet Sali Berisha për ta tërhequr vëmendjen nga Kosova. Kur Kosova bëhej gati për luftë, Sali Berisha ishte në sheshe dhe në protesta. Kur Kosova në vitin 1998 ishte në luftë, Sali Berisha i vinte zjarrin Kryeministrit të vendit. Kur Kosova shkante në Rambuje, Sali Berisha protestonte dhe bllokonte sheshet e Tiranës. Kur sot Kosova ka nevojë për mbështetjen e Shqipërisë, si vendi amë, Sali Berisha bllokoi Kuvendin e Shqipërisë. Nuk ka asnjë dyshim që skenari i Sali Berishës është një skenar antikombëtar. Përpjekjet për ta bllokuar sot Kuvendin e Shqipërisë, janë përpjekje për ta destabilizuar Shqipërinë në këto kushte ku ndodhet sot Ballkani. Megjithatë, destabilizimin e Shqipërisë ta harroni, se nuk bëhet destabilizimi me këtë sojin këtu.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Balla!

**Taulant Balla** – Një sekondë, zonja drejtuese e seancës, nuk ka asnjë dyshim që çështjet e procedurës nuk u ngritën në asnjë rast. Ju lutem, kaloni në pikën e parë të rendit të ditës!

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, më lejoni të vendos rregull! Kolegë, për të disatën herë, pa iu adresuar masave disiplinore, sepse dhënia e masave disiplinore nuk është qëllim në vetvete, ju lutem, të mund të rivendosim rregull në këtë seancë dhe të vijojmë normalisht!

Po e filloj lutjen nga ju, zoti Bylykbashi, por edhe kolegët tuaj, ju lutem uluni! Ju lutem, hiqeni pajisjen zhurmuese që keni futur në Kuvendin e Shqipërisë!

*(Ndërrhyrje nga salla)*

Mund t'ju lë edhe kohë në dispozicion për ta reflektuar këtë lloj qëndrimi. Dakord? Parlamenti do të duhet të vijojë të funksionojë në mënyrë normale. Deputetët të gjithë duhet të flasin dhe të shprehin qëndrimet e tyre, por kjo nuk bëhet në këtë mënyrë, nuk bëhet me fishkëllima dhe me ulërima.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Po ju kërkoj t'i thërrisni arsyes. Në bazë të nenit 66 të Rregullores së Kuvendit, e pezulloj seancën 10 minuta, me qëllim që deputetët e opozitës të mund të reflektojnë për qëndrimet e tyre në këtë seancë.

*(Pas ndërprerjes)*

**Ermonela Felaj** – U lutem shërbimeve të njoftojnë kolegët, që janë në mjediset e Kuvendit, për të hyrë në sallë!

Ju lutem, zoti Krrashi, zoti Spaho, kolegë të mazhorancës, zini vend!

Rifillojmë seancën plenare, edhe pse, me sa duket, kërkesa për të rivendosur qetësinë në seancën plenare, nuk ka funksionuar. Sidoqoftë, jemi të detyruar t'i përmbahemi Rregullores së Kuvendit.

Kolegë, ju kujtoj edhe një herë nenin 49 të Rregullores së Kuvendit, në të cilin thuhet shprehimisht: "Për çështje të procedurës fjala jepet menjëherë. Janë çështje të procedurës kërkesat që kanë të bëjnë me zbatimin e Rregullores, kërkesat që përmbajnë propozime për ndryshime ose plotësime të rendit të ditës të miratuar, kërkesat për ndërprerjen ose shtyrjen e seancës plenare ose të diskutimeve, si dhe kërkesat që kanë të bëjnë me mënyrën e marrjes së vendimeve ose kryerjes së votimeve".

Duke i respektuar të gjithë ata që e kanë kërkuar fjalën për procedurë, i bëj me dije Kuvendit se fjalën për procedurë e kanë kërkuar: zonja Hoti, zoti Likaj, zoti Vasili, zoti Bylykbashi dhe zonja Açka.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, se unë nuk mund t'i mbaj mend emrat! Po i kërkoj teknikës ta konfiguruj listën, siç ishte në momentin e ndërprerjes së seancës. A ka mundësi?

Teknika, a e kam listën gati?

Faleminderit!

Edhe një herë, kam në listë emrat: zonja Elda Hoti, zoti Ramadan Likaj, zoti Petrit Vasili, zoti Oerd Bylykbashi, zonja Flutura Açka, zoti Lefter Gështenja, zoti Enkelejd Alibeaj dhe zonja Elisa Spiropali.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

Edhe unë në seancë isha, nuk i patë vetëm ju! Ndaj bëra atë ndërhyrje.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Po, e kam parë emrin tuaj, zoti Korreshi.

Duhet t'ia jap fjalën për replikë zonjës Açka, dhe më pas zotit Korreshi.

Ju lutem! Kolegët që do të vijojnë ta marrin fjalën pas listës, nuk do t'u jepet fjala, sepse nuk mund t'i shndërrojmë diskutimet në Kuvend vetëm në fjalë për procedurë. Kolegët që e kanë

emrin në listë, ju lutem, të flasin për procedurë! Do të flasin vetëm ata që e kanë kërkuar fjalën për procedurë. Të vendosim një rregull fjale për të gjithë.

Zonja Aça e ka kërkuar fjalën për replikë.

**Flutura Aça** – Faleminderit, zonja Felaj!

E kam me zotin Balla, në fakt, nuk e kam replikë, por dua të bëj një shpjegim të vogël lidhur me ato që ai tha. Unë e kam parë patriotizmin e tij dhe e çmoj shumë.

Çështja është, zoti Balla, që si drejtues i këtij grupi parlamentar, i cili është në mazhorancë, ju nuk po bëni detyrën tuaj për ta sjellë në normalitet këtë parlament. Dua t'ju përmend vetëm një shprehje të Isa Boletinit: "Kosova është mirë, kur Shqipëria është mirë!"

Rregullo Shqipërinë! Këtu fillo! Ti i pari!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Aça!

Zoti Korreshi, ju lutem, kërkesën për procedurë, se jo më kot e citova!

**Saimir Korreshi** – Duke qenë se jam edhe anëtar i Sekretariatit për Procedurat, e nderuar, këtu jo vetëm që nuk kemi ndjekur etikë dhe procedurë, por gjatë gjithë kohës është luajtur pis me opozitën. Gjithë kjo shfaqje sot, dhe po jua them si anëtar i Sekretariatit për Procedurat, vjen vetëm se u keni mohuar të drejtën 750 mijë opozitarëve që kanë votuar kundër kësaj qeverie, të përfaqësuar nga ne këtu, që të dëgjojnë atë që e heq veten për Kryeministër të Shqipërisë...

**Ermonela Felaj** – Zoti Korreshi, ju lutem! E keni fjalën për procedurë. Çfarë propozoni ju për rendin e ditës? Si ta vijojmë seancën? Me këtë rend dite që kemi shpallur, apo ndryshe? Kjo është!

**Saimir Korreshi** – Duhet ndryshuar. Duhet të vijë Kryeministri i Shqipërisë dhe të japë shpjegimet e tij për çështjen "McGonigal". Kjo e ka nxjerrë opozitën edhe në protestë, edhe këtu, para Kuvendit, sepse është mohuar kjo e drejtë. T'u shpjegojë shqiptarëve se çfarë ka ndodhur dhe lekët që ka dhënë! Duhet të vijë të bëjë Kryeministrin dhe jo të bëjë "Koçin e teto Ollgës", duke bërë zhaba dhe çizme meksikane! Kjo është procedura që duhet të ndiqet. Kjo procedurë nuk është ndjekur. Sa herë që opozita kërkon përjashtimin e Edi Ramës, aq herë shkelet procedura nga Sekretariati për Etikën. Nuk zbatohet Rregullorja e Kuvendit...

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, zoti Korreshi, se nuk besoj se jemi mbledhur këtu për të mësuar për punën e Sekretariatit! E bëtë kërkesën tuaj, ju dëgjova dhe ju falënderoj!

**Saimir Korreshi** – Pse, u mërzipte ti?!

**Ermonela Felaj** – Unë nuk kam asnjë arsye as të mërziitem dhe as të gëzohem. Unë kam detyrimin t'ju dëgjoj, gjë që e bëra, për kërkesën procedurale që patët.

**Saimir Korreshi** – Kur do të vijë Kryeministri i Shqipërisë? Kjo është çështja.

**Ermonela Felaj** – Zonja Spiropali.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E dashur, edhe një herë, për të disatën herë, në Kuvend harmonizohen diskutimet. Të gjithë kërkuarit janë deputetë të opozitës, ka vetëm një deputete të mazhorancës që ka kërkuar fjalën për procedurë. Tani, çfarë ka këtu për të reaguuar?!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonjë, të barabartë jeni të gjithë, por radha e fjalës është një andej e një këtej. Meqenëse është vetëm një deputete nga ana e mazhorancës, patjetër që do ta marrë fjalën.

Ju lutem, zonja Spiropali, merreni fjalën!

**Erisa Spiropali** – Të dashur qytetarë,

Po ju drejtohem juve, sepse është e kotë t'u drejtohem kolegëve në këtë fazë dëshpërimi ku kanë hyrë. Ata që nuk kanë kërkuar falje kurrë dhe nuk janë hetuar kurrë për krimet e tyre, sot duan të hetojnë krime që ekzistojnë vetëm në kokën e tyre.

Nuk ka një çështje të tillë, që i takon Kryeministrit, as në SHBA, as këtu dhe askund, por, patjetër, ju jeni të lirë të fantazoni, të trilloni, të shpifni, siç keni bërë...

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, kolegë! Nëse merret fjala për procedurë, ju lutem, formuloni kërkesën procedurale për të vijuar me seancën!

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Zoti Spaho, edhe një herë ju tërheq vëmendjen! E bëni shumë të vështirë edhe fjalën e kolegëve, edhe ndjekjen e fjalës së tyre nga ana ime, edhe për kolegët tuaj, jo vetëm për kolegët e mazhorancës.

**Erisa Spiropali** – E, megjithatë, ne nuk e kemi vënë kurrë në diskutim as në Konferencën e Kryetarëve, as këtu, në seancë, zhvillimin e një mocioni me debat për këtë temë, për t'i vënë njëherë e mirë kapak kësaj historie, që nuk ka lidhje me ne, por ka lidhje me situatën tuaj të brendshme, me faktin që, fatqësisht, kolegë të

nderuar, se kam respekt për disa prej jush, jeni kthyer në ndihmës të “*non grata*”-s, jeni kthyer në *bodyguard*-ë të tij dhe në njerëz që i mbani qiriun një njeriu që, sot e sa të jetë jeta, nuk do të ketë më kthim në piramidën e drejtimit të këtij vendi.

Po t’i hysh çështjes edhe më thellë, me ato që thoni, ju po mbronni Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga një njeri që ata e kanë shpallur “*non grata*”, si rrezik për sigurinë e tyre. Këtu është edhe kulmi i diskutimit.

Nuk është rastësi fakti që sot, familjarët e viktimize të Gërdecit dhe familjarët e “21 janarit”, kanë depozituar në SPAK një kallëzim penal për një provë të re që ka dalë për këtë njeri. Sigurisht që kjo foltore do të bllokohet, pavarësisht Rregullores, pavarësisht logjikës, pavarësisht procedurës, se ka lidhje me atë që ndodh aty, ka lidhje me atë që ndodh në SPAK, ka lidhje me krimet e vjetra...

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, konkludoni!

**Erisa Spiropali** – ...jo me krime të imagjinuara, që ekzistojnë në kokën tuaj.

Kryeministri do të jetë këtu në mocionin me debat, për të debatuar deri në fund, jo për ju, se ju nuk meritoni përgjigje kështu siç jeni katandisur, në “*revolucionin e bilbilave*”, që e udhëheq Mond Spaho, por për qytetarët e këtij vendi, që, patjetër, meritojnë deri në fund të kenë përgjigje dhe të kuptojnë se sa shpifës, trillues e të çartur jeni ju në aksionin tuaj politik.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Spiropali!

Ju lutem, edhe një herë! Është shumë e vështirë, duke qenë këtu, të dëgjosh të gjitha pretendimet tuaja. Ndaj, ju lutem, kolegë, kornizohuni te kërkesa juaj konkrete për vijimin e kësaj seance!

Sa për kolegët që kanë pushtuar foltoren, ju lutem, uluni! Nëse nuk e respektoni Rregulloren, mos kërkonti t’ju jepet fjala! Ose e njihni Rregulloren, ose jo! Nëse e njihni Rregulloren, zonjë, uluni në vendin tuaj! Kur t’ju vijë radha, patjetër që do t’ju jap fjalën.

Zonja Hoti, fjala për ju.

(*Ndërhyrje nga salla*)

Ju lutem, kam listën para dhe jua lexova!

(*Ndërhyrje nga salla*)

Do t’ju jap fjalën edhe juve, zonja Kryemadhi!

(*Ndërhyrje nga salla*)

Nuk po i bëj nder askujt, por po ndjek radhën! Ju po ndërhyini që unë të mos ndjek radhën.

(*Ndërhyrje nga salla*)

Zonja Kryemadhi, doni të adresoni një debat të pavend ndaj drejtuesit të seancës. Unë po ndjek këtë listë, madje e kam fotografuar atë, në mënyrë që t’ua jap fjalën kolegëve që e kanë kërkuar. Kaq e thjeshtë është!

Ju lutem, uluni!

(*Ndërhyrje nga salla*)

Ju lutem, jepjani fjalën zonjës Hoti!

(*Ndërhyrje nga salla*)

Me atë pajisje që jeni duke përdorur, e keni nxjerrë jashtë funksionit edhe mikrofonin, uluni në vendin juaj!

**Elda Hoti** – Zonja drejtuese e seancës,

Sot është e katërta seancë ku parlamenti është uzurpuar nga kjo qeveri. Parlamenti po përdoret për të keqpërdorur fjalën e lirë. Parlamenti është i shqiptarëve...

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, lëri komentet dhe vazhdoni me kërkesën procedurale!

**Elda Hoti** – Ju bllokuat seancën e kaluar, ku duhet të flisnim për zgjedhësit dhe për problematikat e tyre, me justifikimin për të përjashtuar Sali Berishën. Ju keni frikë nga e vërteta, se keni një Kryeministër që ka frikë të përballet me dritën e së vërtetës, se është i zhytur në korrupsionin galopant bashkë me ministrat e tij. Në respekt të qytetarëve shqiptarë, ai sot duhet të ishte këtu për të dhënë llogari për McGonigalin, që e korruptoi për të goditur opozitën dhe pluralizmin. 230 mijë euro për...

**Ermonela Felaj** – Nuk po flisni për procedurë.

Fjalën e ka zoti Likaj.

(*Ndërhyrje nga salla*)

Ju lutem, zonjë, nuk mund t’juja mësoj unë se si është kërkesa për procedurë! Unë jua rikujtova nenin. Ju keni detyrim t’i përmbaheni nenit. Nëse nuk dini të formuloni kërkesën, ky është problemi juaj.

Fjalën e ka zoti Likaj.

**Ramadan Likaj** – Kolegë të nderuar,

Është për të ardhur keq, se është e treta seancë ku ju vazhdoni të bllokoni parlamentin! E bllokoni parlamentin pa asnjë lloj motivi dhe sillni vetëm rendin e ditës, e kaloni atë sipas dëshirave tuaja, dhe qytetarët shqiptarë presin çdo

sekondë, çdo minutë nga ky parlament se çfarë mund të bëjmë ne realisht për ta.

Fatkeqësisht, ju, të nderuar kolegë të mazhorancës, vazhdoni përditë të njëjtin veprim. 18 deputetë të opozitës përjashtohen nga parlamenti pa asnjë motiv, vetëm thjesht për të vazhduar rutinën tuaj të miratimit të atyre ligjeve, që realisht i bëni sipas dëshirave tuaja.

Të nderuar qytetarë shqiptarë,

Sot u bënë dy muaj fiks që ky parlament nuk na jep mundësinë të flasim në foltore për problemet dhe për hallet e qytetarëve. Ju vazhdoni me këtë metodikë, sepse ju intereson. Pse qenka kaq e vështirë kur kërkohet nga opozita shqiptare interpelancë me Kryeministrin e Shqipërisë për skandalin që ka ndodhur, i cili po qarkullon në të gjithë botën?! Në qoftë se Kryeministri i Shqipërisë e ka të drejtën ligjore, kushtetuese për të ardhur në parlament, pse nuk bëhet një gjë e tillë, por bllokohet parlamenti nga mazhoranca? Pse të mos e marrin vesh sot qytetarët shqiptarë të vërtetën e këtij megaskandali? Apo, ju intereson kjo gjë?!

Duke pasur parasysh se edhe pak muaj dhe shkojmë drejt zgjedhjeve lokale, ju intereson ta bëni këtë, por të jeni të bindur që ne, opozita, do të dimë të bashkohemi me njëri-tjetrin, do të dimë të punojmë me njëri-tjetrin, do të dimë të ballafaqohemi me qytetarët shqiptarë dhe do të arrijmë një fitore në zgjedhjet lokale. Për këtë të jeni të bindur!

Unë besoj se cilido nga ju duhet ta kuptojë njëherë e mirë se ne nuk jemi hajdutë, as nuk kemi vjedhur, as nuk do të vjedhim në të ardhmen, por jemi këtu si deputetë, si përfaqësues të qytetarëve. Kemi ardhur me votë të lirë dhe duhet t'u shërbejmë qytetarëve e jo të na bllokoni të drejtën e fjalës në çdo seancë.

Ndaj, edhe një herë, duke mos dashur ta zgjas fjalën time, kërkoj të na jepet e drejta, e nderuar drejtuese e seancës, që qytetarët shqiptarë të marrin vesh të vërtetën. Të vijë menjëherë Kryeministri dhe t'u përgjigjet pyetjeve tona, në mënyrë që edhe qytetarët të marrin përgjigje!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Do të keni një përgjigje për këtë, pasi të gjithë kolegët që e kanë kërkuar fjalën për procedurë të mund të flasim.

Sipas radhës që fiksuam që në momentin e rifillimit të seancës, fjalën e kanë kolegët të cilët

nuk e kanë marrë atë asnjëherë për procedurë, sepse fjala për procedurë jepet vetëm një herë.

Zoti Gështenja e ka fjalën.

**Lefter Gështenja** – Të nderuar kolegë,

Zonja drejtuese e seancës,

Është krejt e pakuptimtë që sot është seanca e katërt dhe ky parlament vazhdon në shkelje të Kushtetutës dhe në shkelje të ligjit. Nuk e kuptoj pse drejtuesja e parë ende nuk ka dhënë dorëheqjen, pasi u ka hequr të drejtën e fjalës 52 deputetëve të regjistruar të opozitës.

Ju flisni për standarde, flisni për Rregulloren, por cilën Rregullore po zbatoni ju, zonja drejtuese, kur, si mazhorancë, keni përjashtuar 18 deputetë të opozitës pse rrinë në këmbë, ndërkohë që nuk keni bërë asnjë lëvizje në drejtim të kolegëve tuaj?!

Edhe pse në sallë kanë qenë 66 deputetë të mazhorancës, procesverbalin e keni me 73 vota. A është marrë ndonjë masë nga ana juaj për këta deputetë që kanë vjedhur votat, që kanë shtypur butonin për kolegët? Pse nuk reagoni për këtë? Çfarë prove doni? Nga kush e doni provën? Hapini kamerat e sallës së seancës dhe do të shihni se është lehtësisht e verifikueshme! Ka deputetë të mazhorancës që kanë votuar me të dyja duart. Pse nuk reagoni, por keni përjashtuar 18 deputetë të opozitës për të drejtën e fjalës? Çfarë po kërkojmë ne? Ne po themi që të vijë ai, se nuk po ia them emrin, e të japë llogari. Është i ndershëm? Le të vijë ta thotë, se mund t'i kemi rënë më qafë kot ne dhe mediet ndërkombëtare! Kaq e vështirë është të vijë e të japë llogari para shqiptarëve?! Kaq e thjeshtë është! Unë jam i sigurt se kështu ky parlament futet në rrugën e duhur. Le të vijë zotëria e të na thotë se nuk ka asnjë lloj problemi. Unë nuk e di ku e gjeni ju të drejtën t'i hiqni të drejtën e fjalës një deputeti!

Seanca e fundit ishte për qytetarët. Zonja Nikolla tha se do ta vazhdojmë diskutimin në seancën e radhës. Pse duhet të vazhdojmë në një seancë tjetër, me të tjera projektligje, kur ndërkohë nuk kemi zhvilluar seancën e cila u mbyll me pa të drejtë nga zonja Nikolla? Do të duhej që ajo seancë të vazhdonte. Duhet të flasim për qytetarët. Pse, vetëm për hallet e qeverisë do të flasim këtu?! Ky parlament nuk është "noteri i qeverisë", por është për t'i kërkuar llogari qeverisë.

Kështu që, ju lutem, ndërpriteni seancën! Të vijë Kryeministri e të japë llogari para shqiptarëve



dhe të vazhdojmë në normalitet, ndryshe ky parlament kështu do të vazhdojë!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Gështhenja, që ishit konkret në kërkesën tuaj!

Fjalën e ka zonja Bardeli.

**Greta Bardeli** – Zonjë, e kërkova fjalën sot për procedurë, pasi që në fillim të kësaj seance u shkelën Rregullorja e Kuvendit dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Ju nuk lejuat 4 deputetë të opozitës të marrin pjesë sot në këtë seancë.

Sikurse ju tha pak më parë kolegu im, anëtar i Byrosë, kuorumi që ju keni mbledhur sot për të shqyrtuar kërkesën e tyre për ankimim, nuk i plotësonte kriteret e kësaj Rregulloreje. Kështu që, është një vendim nul, që nuk prodhon asgjë, dhe ju zonjë, si drejtuese e kësaj seance, duhet të kishit marrë masa që këta 4 deputetë të ishin sot të pranishëm në seancën plenare.

Një tjetër çështje është se kjo opozitë, për të disatën herë, vjen me një kërkesë për mocion me debat dhe me 13 pyetje, të cilat i drejtohen vetëm një personi, atij që ia nxiu faqen këtij vendi, Edi Ramës. Unë nuk e kuptoj pse ju, zonja të nderuara, duhet të merrni përsipër mbrojtjen e atij, të cilin s'ka më askush fytyrë ta mbrojë! Në vend të mbronit atë, ju duhet të kishit garantuar që deputetet zonja të kishin një hyrje normale te hyrja e parlamentit dhe jo të bllokoheshin nga Garda e Republikës, duke u shtyrë. Halli juaj është tjetër, është t'i garantoni atij qetësi në këtë Kuvend, që, kur të vijë, të ketë të drejtën e fjalës pa u shqetësuar, por harron se gënjen dhe se e ka nxirë fytyrën e tij nga gënjeshttrat. Ku mendoni se i dilni për zot sot?!

*(Bie gongu)*

Mos ma ndërprit fjalën!

Ku mendoni se i dilni për zot sot mentorit të Saimir Tahirit, që e keni në burg për korrupsion, në bashkëpunim me krimin, që e mbushi Shqipërinë me kanabis; mentorin e Erion Veliajt, shëgertit të tij të vogël të inceneratorëve apo mentorit...

*(Bie gongu)*

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Bardeli!

E konsumuat fjalën për procedurë. Unë ju dëgjova deri në fund.

**Greta Bardeli** – Mos ma hiq fjalën, të lutem! Jo, zonjë, ti nuk ke të drejtë të ma heqësh fjalën!

**Ermonela Felaj** – Nuk jua hoqa fjalën, se koha e fjalës mbaroi.

**Greta Bardeli** – Mos më ndërprit!

**Ermonela Felaj** – E dashur, mbaroi koha e fjalës dhe nuk kam si të heq diçka që ka mbaruar.

Fjalën e ka zonja Kryemadhi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonjë, ju lutem, nuk bëhen rregullat në këtë mënyrë! Mbaroi koha. Kur ra gongu, ju njoftoi se kishit edhe 30 sekonda. Ju lutem! Nuk ia kam ndërprerë fjalën askujt. Edhe pse ju në pjesën më të madhe nuk folët për procedurë, ju dëgjova deri në fund. Folët 2 minuta. Ju lutem, ju mund ta doni fjalën pa fund, por 2 minuta është koha për këtë lloj kërkesë!

**Monika Kryemadhi** – Zonja drejtuese e seancës,

Në radhë të parë, dua ta filloj procedurën me mënyrën dhe metodologjinë me të cilën ju drejtoni seancën, fillimisht ju, por edhe e gjithë administrata e menaxhimit të seancave.

Opozita ka vetëm të drejtën e fjalës dhe, kur ia hiqni edhe të drejtën e fjalës, mendoni se ç'mund të bëhet tjetër! Pastaj na ngelet t'ia thyejmë njëri-tjetrit kokën me karrige, sepse deri këtu po detyrohemi të shkojmë!

Në radhë të parë, dua t'ju them se përjashtimi i 4 deputetëve, pa i dëgjuar, për mua është mungesa më elementare e respektit ndaj kolegut dhe ndaj njëri-tjetrit. Pavarësisht pozicioneve tuaja politike dhe llogoreve, të cilat jeni të detyruar t'i mbani, funksionimi i parlamentit është gjëja më e rëndësishme, që mund të ruajë edhe imazhin tuaj, se për imazhin e qeverisë dhe të Partisë Socialiste nuk më bën përshtypje.

Sot "New York Post" sapo e ka nxjerrë përsëri lajmin, duke e akuzuar Kryeministrin e Shqipërisë për lidhjet sekrete me ish-drejtorin e kundërbulimit të FBI-së dhe për shumë e shumë gjëra të tjera. Pra, edhe nëse nuk doni ta hetoni ju me komisionin hetimor, të jeni të bindur që do ta hetojnë vetë amerikanët, sepse kjo nuk është çështje...

**Ermonela Felaj** – Zonja Kryemadhi, të lutem!

**Monika Kryemadhi** – Të lutem shumë, mos më ndërprit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** – Zonjë, jam e detyruar! Ju lutem, e merrni fjalën për procedurë dhe tani më

vini edhe mua kushte për mënyrën e të drejtuarit! Ju lutem, këtu nuk mund të flisni për çdo gjë! Unë jam e bindur që ju patjetër mund ta bëni kërkesën për procedurë.

**Monika Kryemadhi** – Të lutem, zonjë e nderuar, po flas për procedurat që ti shkel!

E para, se ke fuqinë e mikrofonit, nuk të bën ty as më të zgjuar dhe as më të rëndësishme se të tjerët. Mund të të bëjë më të përdorur se Edi Rama, por më të zgjuar se të gjithë burrat dhe gratë këtu, nuk të bën.

E dyta, për atë diplomë shkolle që ke, bëje respektin që të takon, si juriste që je dhe, për më tepër, si grua.

E treta, po ta them edhe një herë se çështjen e komisionit hetimor për Edi Ramën ti mund ta ndalosh këtu, sepse vetëm këtu bën vaki të ndryshojmë ligjin ne dhe të mos funksionojë, vetëm në një vend absurd, që drejtohet nga një njeri i pashkollë. Ai zotëria, si të vijë, si të mos vijë, këtë punë e mbyll këtu me ne, por me Amerikën nuk e mbyll dot. Nuk e mbyll Amerika se i dhimbset Shqipëria, por do ta mbyllë për veten e vet, sepse ka futur turinjtë aty ku nuk duhej t'i fuste.

Unë e mirëkuptoj shumë mirë zotin Rama. Ai nuk e përballon dot emocionalisht, nuk e përballon dot nga ana psikologjike, por na e thoni, që është e nevojshme të bëhet një rikuperim mendor për të. Të kalojë në seancat psikologjike, të rikuperohet psikologjikisht, të rikuperohet emocionalisht dhe të vijë! Në fund të fundit, 13 pyetje kemi bërë ne. Komisionin hetimor po të doni ngrijeni, po të doni mos e ngrini! Ne nuk kemi për ta varur dhe as kemi për ta vvarë, por për 13 pyetjet të vijë të përgjigjet! Nëse nuk di të përgjigjet, të japë dorëheqjen dhe të vijë një Kryeministër tjetër që përgjigjet! Kjo është gjëja më elementare.

*(Bie gongu)*

Ju doni të na e hiqni edhe të drejtën e pyetjeve. Ti ndërhysh edhe në 3 minutat që kemi, duke marrë nga sekondat tona. Na bën edhe kalkulum, je bërë edhe matematiciene për minutat dhe sekondat kur flasim!

E fundit, po ta them sinqerisht, shoqërisht, miqësisht, por edhe si deputete: mos u bëj kalkuluere e minutave të opozitës! Mbjaj vendin tënd si deputete!

**Ermonela Felaj** – E dashur deputete, këtë nuk mund ta vendosim si kohë procedurale, sepse

këtë mund ta keni edhe në ambientet jashtë Kuvendit.

**Monika Kryemadhi** – Jo, kam të drejtë për 15 sekondat që më more. Mbjaj vendin tënd si deputete! Respekto Rregulloren!

**Ermonela Felaj** – Jo, ju lutem, mbaroi koha! Mbaroi edhe koha të cilën ju pretendoni se jua mora me ndërhyrjen time si drejtuese. Rregulloren po mundohem ta respektoj maksimalisht dhe, pavarësisht se është e vështirë në këto kushte, të jeni e sigurt se këtë do të bëj.

**Monika Kryemadhi** – Respekto Rregulloren, sepse, në fund të fundit, kjo është si te shprehja “Në ato maja rripa-rripa, një herë ma hipe, një herë ta hipa”, Ermonela!

**Ermonela Felaj** – Fjalën e ka zoti Alizoti.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Tomor Alizoti** – Pas një kohe të gjatë, po arrij të them 2 fjalë dhe nuk e kuptoj nëse është çështje teknike apo është çështje të cilën e shtyni ju. Për mua pak rëndësi ka kjo, por duhet ta dini se nuk ka parlament në botë, ku Kryeministri i atij vendi figuron 12 herë apo 14 herë nën hetim dhe ai nuk guxon të shkojë atje. Ky vend ka pasur liderë apo prijës edhe gjakatarë, edhe të rrezikshëm, edhe kriminelë, por (ndjesë, por këtë fjalë e kupton shumë mirë populli) asnjëherë nuk ka pasur liderë dhjakska. Që të jesh lider, duhet të kesh kurajë dhe, nëse je i pastër, duhet të dalësh të përballësh me njerëzit, sepse këtu ka një krizë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A ka mundësi të flas?

*(Debate pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, edhe ju mos e bëni fjalën në mënyrë të tillë që të shkaktoni debate me kolegët! Ju lutem, keni kërkuar fjalën për procedurë, mos u merrni me kolegët!

*(Debate pa mikrofon)*

Ti po kthehesh dhe po merresh me kolegët. Zoti Alizoti, të lutem!

**Tomor Alizoti** – Zonjë e nderuar, është shumë e thjeshtë: Shqipëria është në krizë, sepse kryetari i qeverisë nuk ka guxim të vijë në parlament. Parlamenti është institucioni i shqiptarëve dhe ai duhet të vijë t'u përgjigjet shqiptarëve! Ka një krizë matanë oqeanit, ku përmendet emri i tij dhe ku njolloset emri i Shqipërisë. Të marrë guximin të vijë këtu dhe, nëse është i pastër, të na dalë ballë neve! Ai që u dilte njerëzve nëpër telefona, duke u thënë të lajnë duart e të lajnë menderet, të vijë këtu! Shqipëria

është në krizë! Është turp kjo që bëni! E keni mbushur parlamentin plot me servilë. Këtu ka njerëz të nderuar dhe u kërkoj ndjesë atyre, por nuk bëhet shteti me servilë. Ai të vijë këtu, të paraqitet, sepse ndryshe nuk shpëton nga kjo krizë! Kjo është krizë institucionale. Emri i Shqipërisë po përmendet nëpër botë. Është turp! Ose ta mbajë këtë pushtet, ose ta lërë! Në të kundërt, merrni 5 minuta pushim dhe zgjidhni një Kryeministër tjetër! Ka 50 vjet që ka përfunduar Partia e Punës, ajo që ishte me ca njerëz langaraqë, banalë.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Alizoti!

E fundit që e merr fjalën për procedurë është zonja Lindita Metaliaj.

*(Debate pa mikrofon)*

Ju lutem! Juve ju është dhënë fjala për procedurë. Deri në momentin e riçeljes së seancës e kishin kërkuar fjalën këta kolegë. Unë e kisha fotografuar këtë gjë, me qëllim që t'ua jepja fjalën vetëm atyre kolegëve. Nuk mund të vazhdojmë pafundësisht për procedurë, sepse tashmë është e qartë se çfarë kërkohet në lidhje me rendin e ditës.

Zonja Metaliaj, fjala është për ju.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

**Lindita Metaliaj** – Zonja drejtuese e seancës,

Në mënyrë të përsëritur, në këtë parlament, i cili, në fakt, duhet të ishte tempulli i demokracisë apo tempulli i fjalës së lirë, u ndërpritet fjala dhe u hiqet e drejta e fjalës deputetëve të Partisë Demokratike. Këtë institucion e keni shndërruar në institucionin e krimit, në institucionin që mbron interesat dhe aferat korruptive të Edi Ramës. Çfarë mendoni se po bëni?!

Unë jam deputete e qarkut të Lezhës dhe përfaqësoj 42 mijë votuesit e këtij qarku; përfaqësojmë të gjithë bashkë 750 mijë votuesit në mbarë Shqipërinë. Si guxonin ju të na e hiqni të drejtën e fjalës?! Ne jemi deputetë, jemi mandatuar dhe jemi betuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë se do të mbrojmë interesat e njerëzve. Çfarë po bëni ju? Po mbronin interesat e kreut të organizatës kriminale të Rilindjes, interesat e një individi, i cili ka njoolltur Shqipërinë dhe shqiptarët me aferën më të rëndë korruptive në një vend ndërkombëtar, po mbronin interesat e një individi që ka shpopulluar Shqipërinë dhe shqiptarët, interesat e një individi,

i cili është i korruptuar, në të gjithë aferën dhe në të gjitha nivelet e qeverisjes.

**Ermonela Felaj** – Zonjë, ju lutem, vazhdoni me kërkesën procedurale!

Këtë fjalë mund ta mbani kur të keni mocion me debat.

**Lindita Metaliaj** – E nderuar zonjë,

Jeni betuar edhe ju, si unë, në Kushtetutë. E drejta e fjalës është e drejta ime, është e drejtë kushtetuese, të cilën nuk ma ndaloni dot ju.

**Ermonela Felaj** – Po, por është edhe detyrimi juaj të zbatoni urdhrat e drejtuesit të seancës, nëse nuk e dini. Ju lutem, do të ndërpritni sa herë nuk flisni sipas procedurës, të jeni e sigurt për këtë!

**Lindita Metaliaj** – Mos më ndërprisni!

Është hera e fundit që më ndërprisni fjalën! Jam brenda procedurës. Po dhunoni të drejtat e deputetëve, të drejtën kushtetuese të ushtrimit të kontrollit parlamentar mbi Kryeministrin dhe mbi kabinetin qeveritar.

**Ermonela Felaj** – Zonja Metaliaj, çfarë propozoni ju konkretisht për seancën? Për këtë duam t'ju dëgjojmë, zonjë, sepse për këtë jua dhamë fjalën. Për këtë duan t'ju dëgjojnë të gjithë.

**Lindita Metaliaj** – Ta them unë. Më lejoni, pra, të flas!

Është e katërta seancë radhazi që kërkojmë mocion me debat me Kryeministrin. Ku e keni Kryeministrin? Pse fshihet? Nga kush ka frikë? Nga deputetët e Partisë Demokratike? Nga deputetët e opozitës? Të vijë këtu dhe të japë sqarime përpara shqiptarëve për aferën më të rëndë korruptive në nivel ndërkombëtar! Çështja “McGonigal” është një njollë turpi dhe një njollë e zezë për Shqipërinë dhe shqiptarët. Çfarë mendoni ju se po bëni?! Mos mbronin të pambrojtshmen! Do të ngeleni në histori si deputetët që mbrojtën një kriminel ordiner, një hajdut ordiner në nivel ndërkombëtar dhe një Kryeministër, i cili njihet që i ka shndërruar shqiptarët në popullin e gomoneve. Kjo është tragjedi kombëtare!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Metaliaj!

Ishit e qartë në kërkesën tuaj.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Jo, një kërkesë procedurale patët, atë të zhvillimit të mocionit.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, komentet e tjera, që s'kanë lidhje me kërkesën, nuk na interesojnë dhe nuk janë pjesë e këtij rendi dite!

Atëherë, kolegë, për rendin e ditës kemi dëgjuar më shumë se një folës pro dhe një folës kundër.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ju lutem, sepse po bëj një propozim për kërkesat tuaja! Nga një pjesë e mirë juaja, për të mos thënë nga të gjithë deputetët e opozitës, u kërkua që pjesë e rendit të ditës të jetë zhvillimi i mocionit me debat. Atëherë, meqenëse kryetarët e grupeve parlamentare nuk janë mbledhur për të caktuar ditën e zhvillimit të tij, në cilësinë e Kryetares së Kuvendit dhe sipas nenit 98 të Rregullores, ju propozoj një datë për mbajtjen e mocionit me debat, që është edhe brenda afateve të zhvillimit të mocioneve. Mocionet zhvillohen brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ju lutem, po flas për kërkesën tuaj! Doni të dëgjoni apo jo?!

Kërkesa për mocion me debat është paraqitur në datën 2 shkurt dhe është protokolluar në datën 3 shkurt. Kjo do të thotë që ne duhet ta zhvillojmë këtë mocion brenda datës 2 mars. Për këtë propozim, Kuvendi ftohet të votojë në mënyrë të hapur.

Kush është dakord?

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ju lutem, kolegë, pasi e dëgjuat, ju ftoj në votim! Kush është dakord që mocioni me debat, të cilin i janë bashkuar interpelanca dhe të gjitha pyetjet, për shkak se kanë qenë të gjitha për të njëjtën çështje, të zhvillohet në datën 2 mars?

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Kush është dakord me këtë propozim?

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ju lutem, kolegë, votoni! Nuk votohet me elektronikë, votohet me karton, sepse është votim i hapur.

Faleminderit!

Kush është kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Zoti Braçe, po kërkoni fjalën?

Dakord.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Atëherë, mocioni me debat së bashku me kërkesën për interpelancën urgjente dhe pyetjet e deputetëve do të mbahen në datën 2 mars, ku të gjithë do të keni të drejtë të flisni, sipas kohës

maksimale që përcakton Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë.

Atëherë, vazhdojmë, kolegë.

Kush është dakord me rendin e ditës, sikundër ju është paraqitur?

Votohet me karton.

Faleminderit!

Kundër? 1 kundër. Abstenim?

Rendi i ditës miratohet me shumicë votash, sikundër me shumicë votash miratohet edhe zhvillimi i mocionit me debat në datën 2 mars, me kohë pa limit.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ju lutem, një minutë! Kolegë, a ka mundësi të tregoheni të civilizuar dhe të mos bërtisni njëherazi nga vendi? I keni disa të padisiplinuar, të cilët duhet t'i durojmë në këtë mënyrë, por, të paktën, kur kërkoni fjalën, a mund ta kërkoni në mënyrë civile? Zoti Balla...

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Zonja Tabaku ka kërkuar shpjegim të votës kundër.

**Jorida Tabaku** – Zonja drejtuese e seancës,

Së pari, kjo ambulanca që keni vendosur këtu është pak e bezdisshme.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

**Ermonela Felaj** – Nuk kemi vënë asgjë, zonja Tabaku. Ju lutem, mos provokoni! Kolegët tuaj e kanë vënë zhurmuesin dhe unë i luta disa herë ta heqin atë pajisje.

**Jorida Tabaku** – Atëherë, zonja drejtuese e seancës, sapo bëtë një propozim për ta çuar në datën 2 mars, por interpelanca duhet të ishte e menjëhershme dhe duhej sjellë në momentin e parë kur mblidhej seanca. Nuk mund të mblidhesh pa dakortësinë e kryetarëve të grupeve të tjera dhe të thuash se, për një kërkesë, për një aktakuzë, e cila ka një muaj e gjysmë që është publikuar, do të mblidhemi në datën 2 mars.

Zonja drejtuese e seancës, po shkëlmi rëndë Rregulloren e Kuvendit! Ju lutem, na lejoni të debatojmë dhe të diskutojmë sot për çështjen që kemi kërkuar dhe të vazhdojmë me rendin e ditës! E thashë edhe pak më parë se kam shumë interes të flas për kontratën e pullave fiskale, për lidhjet korruptive dhe për personat pronarë, përfutues të kësaj kontrate. Ju lutem, na lejoni të debatojmë për çështjen për të cilën kemi bërë kërkesa, të cilat duhet të futen menjëherë në rendin e ditës dhe më pas të vazhdojmë me çështjet e rendit të ditës! Në seancë nuk mund të votohet për diçka që nuk është

në përputhje me Rregulloren. Interpelanca bëhet menjëherë në seancën e radhës dhe kjo thuhet në Rregullore. Meqenëse e keni mbledhur së bashku me mocionin edhe seancën e pyetjeve, grupojini në një seancë, e cila duhet bërë menjëherë! Po ju bëj një kërkesë logjike për t'u mbledhur Konferenca e Kryetarëve, ndërkohë që jemi në seancë, ta vendosin këtë pikë në rendin e ditës dhe më pas të vazhdojmë. Besoj se të gjithë kolegët këtu janë të interesuar të diskutojnë edhe për kërkesën për shkarkimin e Kryetares së Kuvendit, pikërisht për shkeljen që bëri me përjashtimin e deputetëve.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Në respekt të fjalës suaj, po ju sqaroj edhe një herë. Kryetarja e Kuvendit, konform nenit 89 të Rregullores, ka vendosur bashkimin e kërkesës për interpelancë urgjente, e cila zhvillohet vetëm si pikë e parë e rendit të ditës, sepse kërkon edhe mënyrën si zhvillohet, ndjek rregullat e parashikuara për interpelanca, të cilat janë të zakonshme. Pra, janë bashkuar interpelanca, mocioni dhe pyetjet.

Sapo votuam, në mungesë të konsensusit të kryetarëve të grupeve parlamentare, të cilët kanë dijeni për këtë vendimmarrje të Konferencës së Kryetarëve qysh në datën 7 shkurt. Sot është data 16 shkurt. Kemi të paktën 2 orë e gjysmë që e kemi nisur seancën dhe, nëse do të ishte dëshira për të bërë një lloj konsensusi për datën e mbajtjes, këtu ishit dhe mund ta bënit, por, në kushtet kur kërkesa u ripërsërit nga të gjithë deputetët pa përjashtim, Kryetari i Kuvendit ka të drejtë të propozojë një datë, dhe data duhet të ishte sipas parashikimeve të Rregullores. Data e mbajtjes së mocionit dhe e të gjitha kërkesave të tjera do të jetë 2 mars, ku do të kenë të drejtë të flasin të gjithë deputetët, sipas kohës maksimale të parashikuar në Kuvend.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ju lutem, na ndiqni me vëmendje, pavarësisht se disa kolegë këtu e bëjnë të vështirë! Kërkesa është pranuar dhe Kryeministri do të jetë në debatin që do të zhvillohet në datën 2 mars.

Atëherë, ju lutem, vijojmë me çështjet e rendit të ditës!

Çështja e parë e rendit të ditës është projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar”.

Zoti Oerd, për të disatën herë, ju lutem, uluni, që t’jua jap fjalën!

*(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)*

Jo, sepse ju nuk mund të pengoni fjalën e të gjithëve dhe për veten tuaj të kërkonit qetësi dhe normalitet.

Ju lutem!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Oerd, ju lutem, se ne kuptohemi shumë mirë dhe nuk ka nevojë që ta bëjmë kaq të vështirë! Unë po ju them të uleni!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Më falni, por çfarë arsyeje kanë kolegët tuaj? Se ata folën! Zonja Metaliaj e mori fjalën, zonja Elda Hoti e mori fjalën, zoti Spaho po ashtu, edhe ju e morët fjalën. Atëherë, pse nuk uleni?!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Patjetër, do t’jua jap fjalën nëse uleni!

Mendoj se është mirë që të uleni dhe të flisni, sepse vetëm ashtu mund të bëheni të dëgjueshëm!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, uluni! Nuk ka asnjë kompensim kjo punë!

Atëherë, referuar nenit 73, pika 2, të Rregullores, i zgjidhëm çështjet e procedurës dhe ky është rendi i ditës.

Le të fillojmë me rendin e ditës dhe më pas mund të pretendoni për procedurë, sepse është logjike.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Nuk keni çfarë të pretendoni më për procedurë, zotëri. Ne sapo kemi filluar me rendin e ditës.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Mund ta kërkonit më parë, jo tani!

Zoti Shalsi...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Patjetër, vetëm doja t’ju tërhiqja vëmendjen që të mos ndërhyini me teknikë!

Atëherë, për paraqitjen e projektligjit fjala është për ministren e Financave, zonjën Ibrahimaj. Koha është e pacaktuar.

**Delina Ibrahimaj** – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Ndihem thellësisht e keqardhur që, për të disatën herë, pengohet zhvillimi i seancës normale të këtij Kuvendi, pengohet detyra me të cilën Kushtetuta na ka ngarkuar të gjithëve, nuk dëgjohet dhe nuk kuptohet se çfarë themi. Flasin

në këtë seancë jo si persona të ngarkuar nga Kushtetuta, por si njerëz të paedukuar dhe me terminologji të paedukuara. Duhet të rivendoset rendi në këtë Kuvend dhe të dëgjohehi. Ne jemi këtu për të shpjeguar të gjitha projektligjet që paraqesim dhe të gjitha çështjet që ngrihen nga deputetët e nderuar të parlamentit.

Më lejoni të prezantoj projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar”.

Qeveria shqiptare, në kuadër të reformave të ndërmarra në fushën e menaxhimit të financave publike, ka si qëllim kryesor mbështetjen e vazhdueshme të njëjësive publike në forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në përputhje me angazhimet që rrjedhin nga dokumentet strategjike dhe nga procesi i integritetit në Bashkimin Europian.

Ligji “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” është përgatitur në vitin 2010, bazuar në praktikat më të mira të BE-së dhe pas periudhës së implementimit në vitin 2015 ka lindur nevoja e ndryshimeve të mëtejshme, në kuadër të të cilave vjen edhe ky propozim.

Nisma e ndërmarrë ka për qëllim kryesor saktësimin dhe përmirësimin e cilësisë së parimeve, procedurave, sanksioneve, strukturave administrative dhe metodave për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, kjo në kuadër të rritjes së efektivitetit të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike.

Këto ndryshime ligjore fokusohen në: rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale; rritjen e efektivitetit; rritjen e mirëpërcaktimit dhe forcimit të masave sanksionuese, në mënyrë që jo vetëm të jenë plotësisht të zbatueshme, por edhe të rrisin nivelin e përgjegjshmërisë së organeve qeverisëse; rritjen e përmirësimit dhe implementimit të mëtejshëm të ligjit përmes qartësisht të detyrave dhe funksioneve të strukturës përgjegjëse për menaxhimin financiar.

Impakti i këtyre ndryshimeve do të shprehet në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për qytetarët dhe për bizneset, në rritjen e besimit të tyre te shteti, si dhe në nxitjen e zhvillimit ekonomik, si rrjedhojë e përmirësimit të performancës, rritjes së transparencës dhe zbatimit korrekt të legjislatcionit në fuqi për

menaxhimin financiar dhe kontrollin. Për të gjitha këto arsye, ju ftoj ta votoni këtë projektligji.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Ministre!

Edhe një herë, kolegë deputetë, ju tërheq vëmendjen!

Ju lutem, uluni dhe sipas listës së diskutantëve mund të merrni fjalën!

Zoti Shalsi, a keni dëshirë të shpreheni për projektligjin?

*(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)*

Faleminderit!

Sipas listës, fjalën e ka zonja Açka.

*(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)*

Atëherë, duke qenë se zonja Açka s’është prezente, fjalën e ka zoti Ramadan Likaj.

*(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)*

Ndjësë, zoti Likaj!

Fjalën e ka kërkuar për procedurë zonja Kryemadhi.

**Monika Kryemadhi** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Kam një pyetje për zonjën ministre, meqenëse na paraqiti projektligjin: cila është lidhja e bashkëshortit tuaj me kompaninë e përmbarimit dhe me sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Financave? A u pranua dorëheqja juaj kur ndodhi ky fakt? Këto janë pyetjet, para se të na shpjegoni projektligjin.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Po, zonja Ibrahimaj.

**Delina Ibrahimaj** – Kjo është një pyetje totalisht jashtë rendit të ditës. Unë jam shprehur disa herë për çështjen, ku kam thënë se ne nuk marrin përsipër të bëhemi as hetues, as gjyqtarë dhe prokurorë për çështje që janë në hetim. Unë nuk marr përsipër të zgjidh asnjë nga hallet tuaja në këtë seancë. Pasi të shprehet gjykata e prokuroria, atëherë do të shprehemi dhe ne për këtë çështje.

**Ermonela Felaj** – Kolegë, ju lutem, uluni!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zoti Kollçaku, zonja Gjylameti, zoti Alizoti, uluni!

Ka një qëndrim të kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

Zoti Balla, fjala është për ju.

**Taulant Balla** – Zonja drejtuese e seancës,

Në Kuvendin e Shqipërisë një pjesë e deputetëve të opozitës penguan një nga koleget deputete që të marrë fjalën. Ky është një akt i

rëndë dhe u bëj thirrje deputetëve që kanë bllokuar foltoren ta lejojnë zonjën Dhima të marrë fjalën.

Ndërkohë, do t'i kërkoja miqësisht deputetit Spaho, si deputet i vjetër, meqenëse ka marrë rolin që të shpërthejë flakadanin në foltoren e Kuvendit, që të mos e bëjë një akt të tillë, se nuk i bën nder as atij dhe as Saliut. Nuk ju shkon që në një seancë si kjo të ndizni flakadanë në Kuvendin e Shqipërisë. Këta skenarë i kemi parë të ndodhin edhe në parlamentet e tjera dhe janë skenarë që frymëzohen nga vende jomike të Shqipërisë.

Për sa i përket asaj që po ndodh në Kuvend, po ju them se kemi rreth 3 orë që jemi këtu, në Kuvendin e Shqipërisë. Ne kemi zhvilluar gjithsej rreth 2 orë e 10 minuta diskutime, nga të cilat 2 orë keni folur ju, deputetët e opozitës dhe vetëm 10 minuta kemi folur ne, deputetët e mazhorancës. Për çfarë po ankoheni ju?! Ju po ankoheni për të drejtën e fjalës në një kohë që keni folur 95% të kohës dhe ne kemi folur vetëm 5%! Ju po ankoheni se nuk po ju jepet e drejta e fjalës, kur është vendosur me vendim të Kuvendit që zhvillimi i mocionit me debat të bëhet në datën 2 mars! Të paktën ish-LSI-ja duhet të ishte dakord, sepse datën 2 mars e ka ditë feste, natyrshëm është edhe një ditë para gjyqit që zhvillohet në Apel për historinë e vulës. Realisht, nëse ju doni që të zhvillohet mocioni me debat, atëherë uluni që të flasim sot për një sërë çështjesh të rëndësishme për të cilat qytetarët na kanë sjellë këtu.

Për sa i përket flakadanit, Mondit, mos e nxirr nga xhepi!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Balla!

Para se të vazhdojmë me diskutimet për çështjet e rendit të ditës, bazuar në nenin 64 u tërheq vëmendjen të gjithë kolegëve deputetë, të cilët po qëndrojnë në foltore! Unë ju tërheq vëmendjen të gjithëve, një për një, pa asnjë përjashtim!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Patjetër, se do të vijmë edhe te Rregullorja!

Kam kohë që po ju lutem të arsyetoni!

Zonja Dhima, nëse dëshironi ta merrni fjalën, ju lutem, merreni nga vendi, sepse nuk ka asnjë mënyrë që kryesuesi i seancës së Kuvendit të largojë njerëzit që kanë pushtuar foltoren, përveçse t'i disiplinohet për seancat e ardhshme.

Ju lutem, zonja Dhima, nëse dëshironi, mund ta merrni fjalën nga vendi!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Antoneta Dhima** – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Projektligji që ne po shqyrtojmë sot propozon ndryshime të rëndësishme për përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të konstatuara gjatë periudhës 12-vjeçare të zbatimit të tij, nga e cila 8 vjet janë pas rishikimit të tij.

Qëllimi i projektligjit është përmirësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë që përdorin fonde publike, duke rritur shkallën e zbatimit të ligjit dhe duke pasqyruar rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm, KLSH-ja dhe institucionet ndërkombëtare.

Ndryshimet e propozuara konsistojnë në:

- rritjen e angazhimit të stafit dhe ndërgjegjësimin të menaxherëve të njësisve publike për zbatimin e elementeve të përgjegjësisë menaxheriale, siç janë: përcaktimi i objektivave, ndarja e përgjegjësisë, procedurat e delegimit, menaxhimi i riskut dhe monitorimi i sistemit;

- rritjen e kapacitetit profesional të strukturave të njësisve publike për zbatimin e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit;

- ndryshimin e masave disiplinore dhe sanksioneve, me qëllim forcimin e përgjegjshmërisë menaxheriale në zbatim të ligjit;

- zbatimin e rekomandimit të KLSH-së për përfshirjen e një numri më të madh të njësisve në sistemin e kontrollit të brendshëm;

- përmirësimin e procesit të menaxhimit të riskut.

Krahas propozimeve të paraqitura, risia kryesore është saktësimi i disa përkufizimeve, si: kontrolli i brendshëm financiar publik, kontrolli i brendshëm, përgjegjshmëria menaxheriale, kontrollet para faktit, si dhe kontrollet pas faktit.

Projektligji parashikon shtrirjen e detyrimit për të raportuar për gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik edhe në shoqëritë tregtare, që zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Kjo masë ka qëllim zgjerimin e monitorimit të funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar

publik, për të mundësuar rritjen e efektivitetit të tij.

Gjithashtu, përmirësohet përbërja dhe funksionimi i Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në drejtim të mirëfunksionimit, delegimit të koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili përfshin edhe koordinimin e riskut; qartësohen dhe rishikohen kriteret e përzgjedhjes së niveleve të dyta e të treta të nëpunësve zbatues, si dhe forcohen sanksionet për të siguruar një funksionim më të mirë të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Në praktikë është evidentuar se problematikat në funksionimin e sistemit të KBFP-së vijnë nga mosangazhimi i nevojshëm i stafit; ndërjegjësimi i ulët i menaxherëve të njëjësive publike; pamjaftueshmëria e strukturave zbatuese të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe cilësia jo e duhur e kapaciteteve profesionale.

Projektligji forcon masat disiplinore ndaj strukturave zbatuese të sistemit të menaxhimit financiar publik për të rritur performancën e zbatimit të ligjit nga njësitë publike.

Funksionet e Drejtorisë së Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin janë shtuar e përmirësuar ndër vite. Gjithashtu, në vitin 2018 është krijuar sektori i kontabilitetit për sektorin publik dhe privat. Për këto arsye, janë rishikuar edhe nene të tjera të këtij projektligji.

Për të gjitha arsyet që rendita më sipër, si dhe për të gjitha argumentet e tjera, i ftoj kolegët deputetë ta miratojmë këtë projektligj shumë të rëndësishëm dhe shumë të domosdoshëm.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Dhima!

Fjalën e ka zonja Bardeli.

**Greta Bardeli** – Në fakt, zonjë, e kërkova fjalën edhe një herë për procedurë.

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, jeni regjistruar dhe jua dhashë fjalën për të folur!

**Greta Bardeli** – Po, por tani do të flas edhe për procedurë.

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, zonjë, se ka rregulla! Fjala ju është dhënë për...

**Greta Bardeli** – Ju lutem, mos më ndërprisni fjalën!

**Ermonela Felaj** – Zonjë, edhe një herë po ju them se jeni regjistruar me vullnetin tuaj, jo me vullnetin tim si drejtuese, ndaj jam e detyruar të respektoj procedurën!

**Greta Bardeli** – Unë e kam kërkuar fjalën për procedurë.

**Ermonela Felaj** – Fjala ju është dhënë për të folur, ju përdoreni kur të doni.

**Greta Bardeli** – Unë e kam kërkuar fjalën për procedurë.

U kujtoj edhe një herë kolegëve deputetë të pranishëm në këtë sallë, sidomos zonjave të mazhorancës, se te dera e parlamentit nuk garantuat një hyrje të rregullt, duke e bllokuar me Gardën e Republikës, dhe zonjat këtu u futën në kushte jonormale. Ky është një rast i paprecedentë, ndaj t'ju vijë turp, dhe ju që urdhëruat mbylljen e derës së parlamentit duhet të mbani përgjegjësi!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Bardeli!

E mira do të ishte që të shpreheshit për thelbin e ligjit.

Fjalën e ka zonja Tabaku.

Nga Shërbimi më është vënë në dukje që ju keni regjistruar emrin për të marrë fjalën.

**Jorida Tabaku** – Zonja drejtuese e seancës, Së pari, kërkoj që të vihet rregull në këtë seancë, sepse kështu nuk mund të flasim dot.

Unë kam disa pyetje shumë të rëndësishme për ministren e Financave, por mendoj se janë dytësore përtej thelbit që ne duam të diskutojmë për çështjen për të cilën kemi kërkuar interpelancën dhe mocionin.

Unë kam disa pyetje për zonjën ministre.

Zonja Ministre, cili është pronari përfitues i kontratës koncesionare të pullave fiskale? Pse kontrata koncesionare e pullave fiskale, e cila konsiderohej korruptive deri pak vite më parë, tani po vazhdon?

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Këtu po i përmbledh pyetjet, se ju do ta mbyllni seancën!

**Ermonela Felaj** – Nuk ka 140 mënyra drejtimi, ndaj a ka mundësi të ruani qetësinë dhe ta lejoni kolegen të flasë? Është e pamundur të operosh në këtë mënyrë, ku secili nga salla jep sugjerime. Është caktuar një njeri për ta drejtuar seancën, ju pëlqen apo nuk ju pëlqen juve!

**Jorida Tabaku** – Zonja Ministre, pse koncensionin e pullave fiskale, të cilit i është shitur pronësia për dy *Red Bull* dhe një *Bake Rolls*, tashmë është bërë koncension i mirë?

Zonja Ministre, pse para 2013-s e akuzonit si kontratë korruptive, ndërkohë që tashmë për ju



nuk është më korruptive? Pse shtyhet me dy vjet kontrata e koncesionit të pullave fiskale? Pse ndërpritet kontrata e “Aleat”-it për pasaportat dhe krijohet një kompani shtetërore, ndërkohë që zgjatet me dy vjet afati i kësaj kontrate koncensionare?

Zonja Ministre, korrupsioni është blu apo mavi? Pse të njëjtët biznesmenë në një qeveri të mëparshme konsideroheshin të korruptuar, ndërkohë që në qeverisjen tuaj janë purifikuar dhe janë pastruar?!

Unë besoj se përveç këtyre temave, zonja Ministre, ti duhet të japësh përgjigje dhe për sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, zyrtarin e parë autorizues të shtetit shqiptar.

Zonja Ministre, nëse ka një person që tallet me seancat plenare dhe duhet t’i vijë turp, kjo jeni ju. Shpresoj që në këtë moment të tërheqësh edhe ofendimet që bëre për deputetët e opozitës kur nisi kjo seancë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Sipas nenit 73, pika 2, të Rregullores, pyetjet zhvillohen përpara fillimit të diskutimit në parim, ndërkohë që asnjë deputet nuk e kërkoi fjalën për pyetje. Sidoqoftë, ju e morët fjalën dhe po e marrim fjalimin si pyetje retorike për ministren, që, sigurisht, në përfundim të diskutimeve mund të mbajë edhe qëndrimet e saj. Për më tepër, me aq sa unë munda të dëgjoj, diskutimi juaj nuk lidhej me këtë pikë të rendit të ditës.

Fjalën e ka zonja Bushka.

A dëshironi ta merrni fjalën, zonja Bushka?  
(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Spaho, pasi ju kam tërhequr vëmendjen, tani po ju jap vërejtje!

Foltoren e nxorët jashtë funksionit, kështu që nëse kolegët tuaj dëshirojnë ta marrin fjalën, le të ulen në vend dhe unë do t’ua jap fjalën, sepse nga aty nuk mund të flasin. Ju vazhdoni dhe mbajini ato nëpër duar, nuk ka asnjë problem për Kuvendin, se falë Zotit kemi 140 mikrofone këtu! Meqenëse ju e shqyet një mikrofon, merreni me vete dhe ta gëzoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën nuk jua jap kur e kërkoni ju, fjalën e jap sipas procedurës.

Zonja Bushka e ka fjalën, sepse ka regjistruar kërkesën për të marrë fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, pasi kam njoftuar diskutantin e radhës. Uluni!

Po, zonja Bushka.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zonja kryesuese e seancës!

Të nderuar kolegë, ne kemi të gjithë interesin dhe përgjegjshmërinë të flasim sot për të gjitha çështjet e rendit të ditës, sipas regjistrimit që kemi bërë, ashtu siç e kemi bërë në çdo seancë të mëparshme. Pavarësisht kaosit dhe rrëmujës së paramenduar nga kolegët e opozitës, të cilët bllokojnë foltoren dhe e shkelin Rregulloren në mënyrë të njëpasnjëshme, ne kemi detyrimin të shqyrtojmë çdo çështje për qytetarët.

Projektligji “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” është në vazhden e një sërë ndryshimeve ligjore që vijnë nga qeveria për të forcuar administratën shtetërore, për të pasur eficiencë në përdorimin e fondeve, në mënyrë që rezultatet e përdorimit të këtyre fondeve të shkojnë në të mira publike për qytetarët.

Ky ligj ka më shumë se 10 vjet që ka hyrë në fuqi, dhe projektligji që paraqitet sot bën pikërisht përmirësime në këtë ligj, që, së bashku me ligjin që kemi miratuar në seancën e kaluar “Për auditimin ligjor dhe financiar”, janë dy premisa shumë të rëndësishme, që tregojnë se administrata shtetërore përveçse po fuqizohet, do të jetë e kontrolluar me mekanizmat sipas standardeve më të mira, që t’u shërbejë qytetarëve dhe të rrisë eficiencën e saj. Ky është një nga indikatorët që tregojnë vullnetin e kësaj mazhorance për të bërë shtet dhe jo të kundërtën e asaj që shohim këtu.

Thënë këtë, dua të sqaroj qytetarët, por, së pari, dua t’u kërkoj ndjesë fëmijëve tanë për atë që shikojnë në këtë sallë, për këtë pamje kaq të shëmtuar të atyre që nuk janë qytetarë të thjeshtë të këtij vendi, por janë përfaqësues të popullit! Ata që në emër të popullit dalin këtu, sepse po u ndërpritet e drejta e fjalës, por pikërisht në këtë moment po ndërpresin të drejtën time të fjalës, pak më parë ndërprejnë të drejtën e fjalës së zonjës Dhima dhe të kolegëve të tjerë, por, siç e shikoni, ne nuk tutemi.

Ju, kolegë, që jeni në foltore dhe që flisni në emër të qytetarëve, mund t’i diskutoni në komisione të gjitha çështjet për qytetarët. Përse nuk vini në komisione për të diskutuar çështjet e qytetarëve? Sepse, jua them unë, ju e keni të paramenduar gjithë këtë skenar.

Sapo është pranuar kërkesa për mocion me debat për çështjet që keni ngritur si pretendime. Pretendimi juaj ishte se nuk po ju respektohen të drejtat sipas procedurës, por ja që të drejtat u respektohen; për çfarë vazhdoni akoma? A e dini përse vazhdoni akoma? E dini edhe qytetarët, ju vazhdoni, sepse doni të tërhiqni vëmendjen nga 21 janari, që sot vlon në hetimet e drejtësisë, të tërhiqni vëmendjen nga Gërdeci dhe nga të gjitha çështjet që sot ju kanë përçarë në dy pjesë dhe po ju përçajnë çdo ditë e më shumë, sepse drejtoheni nga persona të shpallur *non grata* nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për korrupsion domethënës në Shqipëri. Ju jeni të vetmit që sot keni ardhur për interes të një personi të vetëm. Ju jeni ata që morët përsipër të bënit zhurmën sot, sepse kolegët tuaj shkelën Rregulloren dhe morën masa përjashtimi, pikërisht se nuk i takon një sjellje e tillë deputetëve. Ju thatë: do ta bëjmë ne këtë gjë. Ju që flisni për parlamentarizmin, për të drejtën e fjalës, nuk keni respekt për këto parime.

Respekti juaj i vetëm është ndaj një personi, i cili ju thërret nëpër mitingje çdo ditë e më shumë, për të shpëtuar nga 21 janari, nga Gërdeci dhe nga hallet e familjes së vet, për t'i bërë presion gjykatës që çështja e datës 3 mars të ndahet siç thoni ju, dhe jo siç thotë ligji. Ju jeni këtu pikërisht, sepse as militantët tuaj nuk po ju besojnë, se çdo ditë e më shumë në takimet elektorale po ju firojnë njerëzit, çdo ditë e më shumë qytetarët po e kuptojnë se çfarë përfaqësoni ju.

A doni të dini se çfarë mendoj unë? Vazhdoni kështu, kolegë, sepse tregoni se kush jeni, tregoni se sa respekt keni për njeri-tjetrin, tregoni sa respekt keni për Kushtetutën dhe për ligjin.

Edhe një herë, më vjen keq për gjithë qytetarët dhe për fëmijët tanë që shikojnë këtë pamje të shëmtuar. Ky nuk është modeli që duhet të japim, ndaj mblidheni mendjen. Thërritini mendjes dhe mos kujtoni se ne nuk do ta bëjmë punën tonë, sepse ne do të vijojmë punën, që ta kthejmë këtë Kuvend në shinat e rregullit dhe do të vijojmë të punojmë, ashtu siç po e shihni, se nuk e kemi fare problem të miratojmë ligje, të respektojmë Kushtetutën, të adresojmë interesin qytetar në komisione dhe në seancë plenare. Ju u fryni bilbilave, bërtisni, vini zhurmues, bëni çfarë të doni, sepse nuk keni argumente, ndaj këto mjete do të zgjidhni.

Unë po ju them se skenarët tuaj të paramenduar, si çdo herë, do t'ju lënë në baltë dhe do ta shikoni se ashtu siç po rrudheni në mitingje, ashtu do të merrni përgjigjen edhe nga populli më 14 maj të këtij viti, ku vërtet do të uleni atje ku ndoshta nuk jua pret mendja, sepse ky popull është i mençur dhe di t'u tregojë të gjithëve vendin e vet.

Ju qofshi për veten tuaj! Ju qofshi për çfarë bëni! Ne do të vijojmë me përgjegjshmëri punën tonë për interesin qytetar. Mos harroni, bëni çfarë të doni, por askush nuk do ta ndalojë dot të drejtën, askush nuk ka për ta ndaluar dot atë që pritet nga drejtësia e lirë dhe e pavarur dhe pa ndikime, për çështjen e 21 janarit, për korrupsionet domethënëse, për çështjen e Gërdecit dhe për çështje të tjera, për të cilat ju, kolegë, mbani përgjegjësi, qoftë edhe për financimet ruse. Ju mund të hiqni vëmendjen për 5 minuta apo për 5 seanca, por nuk do ta mbulonin dot me hi të vërtetën.

Kolegë, ju ftoj ta miratoni këtë projektligj, ashtu si të gjitha projektligjet e tjera.

Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Bushka!

Fjalën e ka zoti Balla.

Zoti Balla, a dëshironi të shprehni për projektligjin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Monika Kryemadhi.

**Monika Kryemadhi** – Të nderuar kolegë, Zonja Klotilda Bushka tha se ligji i sotëm është për të rritur shëndetshëm të ardhurat publike, për rritjen e fondeve publike dhe të parave për qytetarët, por në të vërtetë nuk është as për njërën dhe as për tjetrën. Ky ligj është vetëm për të vjedhur qytetarët dhe për të paguar McGonigal-ët dhe të gjithë sojin e McGonigal-ëve, të cilët e kanë çuar qeverinë shqiptare në këtë derexhe.

Në fakt, nëse ka institucion dhe ideologji që nuk u bëhet fare vonë për qytetarët është rilindja. Po të kishit dëshirë të bënit diçka për qytetarët shqiptarë, gjënë e parë që duhet të bënit duhet të ndalonit pagesat për inceneratorin e Tiranës, i cili merr çdo ditë 29 mijë euro nga buxheti i Bashkisë së Tiranës, nuk po llogaris se çfarë paguajnë bashkitë e tjera.

Po të donit të rrisnit shëndetshëm fondet publike, me paratë e qytetarëve shqiptarë nuk do të paguanit në parkingjet e Nju-Jorkut McGonigal-in; kjo do të ishte një prej mënyrave më të mira që të reagonit pozitivisht.

Ka një problem shumë të madh: ne kemi një Kryeministër që, përveç se është i korruptuar, tashmë duhet t'i them se është edhe Kryeministër i rublave që, për hir të së vërtetës, i ka intimiduar kolegët e opozitës duke u thënë "partia e rublave; partia e asaj dhe e kësaj", një Kryeministër që ka frikë të përballet edhe kur ka 79 deputetë që e suportojnë, që janë gati të japin jetën për të, të sakrifikohen, dhe jo vetëm jetën, por t'i falin çdo gjë, edhe moralin, edhe fytyrën, pra çdo gjë të vetën.

Në fakt, kemi një problem shumë të madh për sa i përket procesit financiar dhe sistemit financiar shqiptar, ku me paratë e qytetarëve shqiptarë ju vazhdoni të paguani çdo institucion të paligjshëm dhe i përdorni ato para për të manipuluar, për të korruptuar dhe për të ndryshuar realitetet shqiptare.

Shqiptarët largohen çdo ditë; në fakt, nuk largohen ata që janë mirë, por ata që janë keq. Deri tani janë larguar rreth 500 mijë shqiptarë, vajza dhe djem, që janë forca më energjike e Shqipërisë.

Është normale që nuk ju dhimbset, sepse vazhdoni të gënjeni pensionistët shqiptarë me 2000 lekë rritje në pensionet e tyre; vazhdoni të kërcënoni qytetarët me rindërtimin, duke u thënë se do t'ju prishim shtëpitë nëse nuk do të votoni për ne, ose, po votuat për ne do të vazhdojmë t'ju ndërtojmë shtëpitë e reja, ose votoni se nuk do të kalojë rruga këtu apo atje.

Ju vazhdoni të paguani koncesionet pafundësisht. Koncesionet tuaja kalojnë çdo lloj limiti qoftë në infrastrukturë, qoftë në ndërtime shkollash, qoftë dhe në shumë objekte ndërtimi.

Të nderuar qytetarë,

Sot nuk na ka ngelur gjë tjetër përveç fjalës, por përveç fjalës ka edhe shumë metoda për ta rrëzuar këtë qeveri. Për hir të së vërtetës, kjo është qeveria që ka më shumë gra në historinë e Shqipërisë, por Edi Rama e ka kthyer në qeverinë më të korruptuar dhe më problematike.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Unë e di se edhe ata tre burra që janë, Edi Rama do t'i bëjë si gra, por nuk ka problem, se po flas për gratë e qeverisë. Ai vazhdon e krenohet

me fytyrën e grave shqiptare poshtë e përpjetë, por, në fakt, ka të drejtë kur thotë: "Nëse do të bësh diçka, jepja një gruajë ta bëjë". Ai historikisht ka përdorur firmat e grave shqiptare, edhe për koncesionin e shëndetësisë, që Milva e di shumë mirë, edhe për portin e Durrësit që koleget deputete, të cilat janë ministre, e dinë shumë mirë, edhe për ekstradimet, edhe për evazionin fiskal, edhe për koncesionet ka përdorur gratë, por edhe për interferenca jopolitike emocionale me ndërkombëtarët, përsëri përdor gratë.

Mendoj se duhet të kemi përgjegjësi, të paktën, për t'i dhënë shansin dhe mundësinë këtij Kryeministri që të vijë të shprehet dhe të qetësohet. Shumë mirë që u caktua të vijë më 2 mars të na sqarojë! Uroj që deri më 2 mars të mos i keni përjashtuar treçerekun e deputetëve dhe pastaj të bëjë monolog me veten e tij!

Uroj që deputetët socialistë të reagojnë, këtë e them me bindje, sepse Edi Rama nuk ka kapur vetëm shqiptarët, por ka kapur edhe shpirtin e socialistëve!

E di se pjesa që nuk kanë lidhje me Partinë Socialiste, do të thonë: çfarë të lidh ty? Nuk më lidh asgjë me atë çfarë ka ngelur aty, por më lidh me moralin e socialistëve të ndershëm. Edi Rama e ka përdorur McGonigal-in për të kërcënuar ish-ministrat e tij, deputetët dhe drejtorët e tij, për të kërcënuar bizneset shqiptare dhe, nëpërmjet bizneseve shqiptare, të gjithë ekonominë shqiptare.

Edi Rama e ka përdorur McGonigal-in për të ndryshuar pozicionin e lidershipit të Shqipërisë në rajon dhe për të fuqizuar pozicionin e Serbisë. Ajo që dua të theksoj është se Edi Rama ka përdorur McGonigal-in edhe për të zhvlerësuar rolin e Shqipërisë në rajon, dhe e ka zhvlerësuar.

Të gjithë jemi koshientë dhe e dimë se si e mori më qafë ish-Presidentin e Kosovës dhe shumë luftëtarë të tjerë të UÇK-së, që sot dergjen burgjeve të Hagës. Pra, shkaktari që i vendosi ata atje është Edi Rama, i cili do të mbajë përgjegjësi për këtë në histori.

Ana tjetër që duhet ta dinë të gjithë dhe të jemi koshientë është: vërtet mund të kontrolloni sistemin e drejtësisë, vërtet mund të kontrolloni gjykatat, por revoltën e qytetarëve nuk e kontrolloni dot. Revolta e qytetarëve, edhe po e shiti dikush nga opozita, të jeni të bindur se do të jetë më e dhimbshme nëse blihet.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Kryemadhi!

Për të gjithë kolegët që nuk e kuptuan vendimmarrjen e Kuvendit, në datën 2 mars do të kemi mundësi të barabarta debati, për mocionin që është kërkuar nga ana juaj lidhur me çështjen McGonigal, ku do të jetë Kryeministri. Ky propozim u bë në harmonizim me agjendën e Kryeministrit, sepse javën që vjen nuk do të jetë. Pra, më 2 mars do të jetë këtu për çdo pyetje dhe për çdo aludim tuajin.

Fjalën e ka kërkuar zoti Xhaferraj, për procedurë.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Ju lutem, kolegë, ndiqni sistemin! Në fjalën për procedurë nuk është asnjëri prioritar, përveç listës që kam këtu.

**Ferdinant Xhaferraj** – Zonja drejtuese e seancës, ju ndoqa kur thatë se keni marrë vendimin që seanca do të zhvillohet më 2 mars...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Zoti Ministër, a doni të flisni përpara? Flisni, more zotëri...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ja të mbyllin sherrin me njëri-tjetrin.

**Ermonela Felaj** – Zoti Xhaferraj, ju kërkoj ndjesë për ndërprerjen...

**Ferdinant Xhaferraj** – Zoti Manja, nuk kam gjë me Ministrinë e Drejtësisë, por me Departamentin e Drejtësisë në SHBA, jo me ju...

**Ermonela Felaj** – Ju kërkojmë ndjesë! Vijoje fjalën, sepse ju është dhënë. Ju kërkoj ndjesë për debatin me zotin Manja!

**Ferdinant Xhaferraj** – Jo, ishte një debat mes jush.

Meqenëse thatë se seanca do të mbahet më 2 mars, a jeni të sigurt se deri më 2 mars nuk do të shpërthejë ndonjë skandal tjetër dhe do ta ndryshojë agjendën? Shumë kolegë socialistë thanë: përse kjo sjellje në parlament? Është vitrina e produktit që keni krijuar ju.

Mandati i tretë dhe viti 2023...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Po, po për procedurë është. Viti 2023 është viti i skandaleve. Nëpunësja e AKSHI-t, Erisa Fero arrestohet për trafikim lëndësh narkotike; punonjëses që merrte në shtëpi për punë Alda Klosi, iu gjetën qindra mijëra euro; skandali i kamerave, ku krimi merr funksione shtetërore dhe mbikëqyr policinë; sekretari i Përgjithshëm i

Ministrit të Financave kapet në abuzim flagrant, dhe qershia mbi tortë është çështja e McGonigal.

Unë u drejtohem kolegëve të opozitës: a e keni parë sloganin e zotit Rama: “Ne nuk jemi më të mirët, por më të mirë se ne nuk ka”. Çfarë do të thotë kjo? Me fjalë të tjera, ai thoshte një vit më parë, ne jemi e keqja më e vogël, por tani ai po marshon që të kthehet e keqja më e madhe. Përse ne nuk koordinojmë, përse krijojmë këtë klimë në parlament e kudo, për të penguar marshimin e tij, që ai të kthehet e keqja më e madhe? Do t’ju lutesha, problem nuk është më ai, se qeveria është kthyer në një organizëm të vdekur që ecën...

**Ermonela Felaj** – Zoti Xhaferraj, ju lutem, mund të kontribuoni me një kërkesë procedurale?

**Ferdinant Xhaferraj** – Problem jemi ne që nuk po koordinojmë që të dalin ata ashtu siç janë, si e keqja më e madhe e këtij vendi.

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, formuloni kërkesën procedurale!

**Ferdinant Xhaferraj** – Kërkesa procedurale është kjo: duhet të afroni 2 marsin, se nuk kemi asnjë garanci që kjo qeveri nuk do të prodhojë ndonjë skandal tjetër deri më 2 mars.

**Ermonela Felaj** – Patjetër, kolegët tuaj, që e bënë kërkesën, mund të mblidheshin dhe jo të qëndronin indiferentë derisa e bënë kërkesën, sepse u detyrua Kryetarja e Kuvendit të propozojë një datë për zhvillimin e mocionit me debat.

Fjalën e ka kërkuar zoti Vasili.

**Petrit Vasili** – Po e kërkoja, por edhe pak më parë e kërkoja fjalën për shpjegim vote. Keni marrë disatribute që nuk ju përkasin, po mohoni disa të drejta që janë bazike. Megjithatë, përderisa parlamenti drejtohet në këtë mënyrë, sigurisht, kështu do të jemi.

Dy fjalë në lidhje me procedurën. Është mohuar në mënyrë antikushetuese e drejta e komisionit hetimor.

Po jua kujtoj juve dhe të gjithë hipokritëve që flasin në emër të Kushtetutës: është ky parlament që ka rreth 2 vjet që nuk zbaton vendimin e Gjykatës Kushtetuese për ndryshimin e Kodit Penal, për tubimet, për t’u dhënë mundësi të arrestojnë njerëz si të duan në tubime. Këta zemërcjerrët e Kushtetutës, që kanë merak komisionet hetimore, përse nuk e zbatojnë këtë vendim?

Për ta mbyllur këtë moment të komisionit hetimor, deri në sekondën e fundit që ai ligj është në fuqi, asnjë nuk ka të drejtë ta pezullojë këtë të

drejtë, ndaj çdo vazhdim i mëtejshëm i seancës është thellim në paligjshmëri. Pra, pavarësisht se kanë kartonë jeshilë nëpër duar, ato ngrihen në një mënyrë prej budallenjsh, sepse nuk kanë çfarë të kërkojnë.

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, zoti Vasili!

**Petrît Vasili** – Ju lutem, boll e bëtë mësuesen...

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, korrektoni gjuhën, sepse ju nuk jeni i lirë të fyeri çdo njeri. Këtë e bëni në mënyrë të përsëritur.

**Petrît Vasili** – Do të vazhdoj...

**Ermonela Felaj** – Jo, nuk mund të vazhdoni në këtë mënyrë. Ju nuk jeni askushi për t'u thënë të tjerëve budallenj, ndaj, ju lutem, uluni! Mësoni të respektoni Rregulloren, që t'ju respektojmë kur merrni fjalën, ndaj uluni.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Patjetër, kërkojuni ndjesë kolegëve për shprehjen që sapo përdorët. Ju duket gjuhë parlamentare, ju duket se mund t'ju durojmë gjatë gjithë kohës ju? Kështu ju duket? Kërkoju ndjesë kolegëve, zoti Vasili.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

20 sekonda për të përmbyllur kërkesën tuaj procedurale.

**Petrît Vasili** – Ky standard është standardi i Kryeministrit tuaj, i cili ka thënë: “Gruas time t’i hani atë...”, është standardi i atij që i ka thënë “palaço”, atij që ka thënë në këtë sallë, ku kemi qenë të gjithë bashkë: “Populli është si ai...”, që nuk dua ta them. Ndaj këtë standard mos ma impono mua! U preke ti për fjalën “budallenj”! Ai nuk është dënuar kurrë. Ai e vendosi këtë standard. Kush i ka thënë këto fjalë? I keni me zë dhe me figurë dhe nuk keni guxuar t’i thoni gjysmë fjale. 40 herë ia ka thënë fjalën “palaço” një kolegut të opozitës.

Më lejoni të vazhdoj fjalën time, meqenëse ma dhatë dhe nuk keni të drejtë të më ndërprisni kohën.

Për të vazhduar, çështja e komisionit hetimor është një mohim, i cili ju ngarkon me përgjegjësi shumë të rëndë ligjore dhe kushtetuese.

E dyta, duan të justifikohen dhe thonë se zhurma bëhet për 21 janarin, por atë të 21 janarit këta e kanë graduar, e kanë çuar kryetar bashkie, SPAK-u i tyre nuk e mori në konsideratë 21 janarin. Zgjidhni problemet që keni...

*(Bie gongu.)*

Më fal, por çfarë kohe më dhe, për të folur apo për procedurë?

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Për sa i takon çështjes tjetër, këtu u fol se e gjithë kjo që bëhet është ngase kjo opozitë ka probleme, në mënyrë të veçantë me Kosovën. Të gjithë shqiptarët e dinë, ndaj po jua kujtoj përsëri, një turp ka në Shqipëri, që Kryeministri Edi Rama ka paditur Kryeministrin e Kosovës. Ky është raporti që kanë këta me Kosovën. Këta ua kanë futur edhe thikën pas shpine me Ballkanin e Hapur. Pra, në asnjë moment këta nuk kanë asnjë raport të ndershëm dhe asnjë raport parimor. Raportin që kanë është ai i thikës pas shpine.

Dy fjalë të fundit...

**Ermonela Felaj** – Jo, ju lutem, ju mbaroi koha!

**Petrît Vasili** – Sa minuta kam, moj zonjë?

**Ermonela Felaj** – Morët edhe 30 sekonda shtesë, përveç 20 sekondave që ju dhashë.

**Petrît Vasili** – E kam kohën e diskutimit, kam 10 minuta.

**Ermonela Felaj** – E kërkuat fjalën për procedurë, zoti Vasili. Për këtë e kërkuat fjalën.

Ju lutem, uluni, se po bëni një debat pa lidhje tani!

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Atëherë, koleg, kur të vijë momenti për diskutim...

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Zotëri, kur të vijë momenti për të diskutuar, patjetër që do të ta jap fjalën. Ju e morët fjalën për procedurë, kishit 2 minuta kohë, ju dhashë edhe 30 sekonda shtesë, por shfrytëzuat edhe 18 sekonda të tjera.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zotëri, unë e shikoj ekranin!

Për sa i përket kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor, unë e lexova vendimmarrjen e Konferencës së Kryetarëve, por duhet t’i bëj me dije këtij Kuvendi se ajo kërkesë dyshohet se është cenuar rëndë për sa i përket legjitimitetit, pasi të paktën 3 prej firmëtarëve dyshohet t’u jetë falsifikuar firma. Për këtë arsye, i kemi kërkuar Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën të zhvillojë procesin përkatës dhe të shprehet për legjitimitetin e kërkesës nga pikëpamja formale.

Fjalën e ka zoti Manja për procedurë.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Më falni!

A ka mundësi t'i përdorni platformat elektronike që keni përpara?

Fjalën e ka zoti Manja, më pas do ta marrë fjalën zoti Bylykbashi.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

**Ulsi Manja** – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Nuk e kërkoja fjalën thjesht për solidaritet ministror, as për të bërë avokatinë e zonjave të nderuara në qeveri dhe mazhorancë, sepse jam i bindur se asnjëra prej tyre nuk ka nevojë për avokatinë time, por për t'i thënë zonjës Kryemadhi se për këdo prej nesh është nder dhe kënaqësi të punojë me këto zonja të nderuara në qeveri.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Një qeveri me kaq shumë zonja, që po bëjnë një punë të jashtëzakonshme në favor të Shqipërisë dhe të interesave të vendit, i bën nder Shqipërisë. Ne kemi durim, sepse prej 3-4 orësh në këtë sallë po dëgjojmë të gjithë baltën dhe llumin që ju hidhni në drejtim të kësaj qeverie dhe të mazhorancës sonë socialiste, por fakti që kemi durim për t'ju dëgjuar, nuk do të thotë se ju keni të drejtë për ato që thoni, por ne nuk jua zgjidhim dot hallet. Pak më parë, zonja Aça tha se Kosova është mirë kur Shqipëria është mirë. Po, zonjë, po, edhe ky parlament dhe kjo mazhorancë do të ishin mirë nëse do të kishte një opozitë që shihet e jep llogari, por ne nuk e rregullojmë dot opozitën. Juve nuk jua ka fajin kjo mazhorancë dhe Edi Rama. Ju jeni drejt vetëshkatërrimit, sepse Sali Berisha ju thërret këtu si dele, jo vetëm ju, goxha burra, që vini me bilbila në këtë sallë, por edhe të tjerët jashtë, dhe ju përdor si mish për top për interesat e tij dhe të familjes së tij. Ndaj, merrini gjërat me radhë, zgjidhni hallet tuaja më 3 mars, më pas ejani këtu të merreni me Edi Ramën dhe me ne, por mos harroni: Edi Rama është Kryeministri i votuar nga 1 milion shqiptarë. Në të gjithë trajektoren e tij politike, ai është përballur jo me ju, por me këdo...

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Manja!

Zoti Spaho, në bazë të nenit 63, pika 1, shkronja "c", ju heq të drejtën e fjalës gjatë kësaj seance plenare. Nuk do të keni të drejtë për replikë, për procedurë dhe për asgjë. Madje, do të kujdesem t'jua jap këtë masë sa herë që ju të përsëritni të njëjtin veprim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E kam ndërprerë dy herë seancën. Ju kam kërkuar t'i thërrisni arsyet, por ju vazhdoni në të njëjtën mënyrë të cenoni rëndë rregullin e kësaj seance.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Uluni, zoti Bylykbashi, fjala për ju për procedurë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, uluni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe ty, patjetër.

Uluni!

**Oerd Bylykbashi** – Zonja Felaj, juve nuk jua ka dhënë askush detyrën e redaktorit gjuhësor, aq më pak të bëni komandanten e kampit të përqendrimit. Normalisht, për formimin tuaj, ju nuk mund ta shkelni më shumë procedurën se Kryetarja e Kuvendit dhe, nëse ka njeri që sot e ka shkelur brutalisht, jeni ju.

Kolegu im i nderuar, zoti Mziu, doli këtu e tha se nuk ka pasur kuorum Byroja. Kjo do të thotë se mbledhja ka qenë nul. Ju thatë të kundërtën, por unë i besoj kolegut tim. Në atë mbledhje nuk ka pasur kuorum, për rrjedhojë edhe deputetët e përjashtuar sot kishin të drejtë të hynin në sallë. Ne kërkojmë që ata të kthehen në sallë, që të fillojmë betejën tonë parlamentare, ashtu siç e kemi ne, me të gjithë numrat tanë.

Edi Rama ju ka dhënë porosi, ty dhe Lindita Nikollës, të zvogëlioni numrat e deputetëve. Kjo nuk ka për të ndodhur. Këtu nuk do të ketë seancë normale. Ju mund të vazhdoni me planet tuaja për të miratuar kontrata korruptive, por skandali që ju ka përmbledhur, nuk ju lë të ngrini kokë, sepse sot në "Washington Post", Kryeministri ka dalë i mbytur deri në fyt me këtë histori. Llogarisni sa i gjatë është ai dhe të gjithë jeni nën të; për sa kohë që ju i dilni për zot, jeni të përfshirë në një skandal.

Duhet të kuptojmë se e gjithë kjo histori ndodh në parlament, pasi ai zotëria është në hall të madh, sepse ai nuk mund të pranojë kurrë një komision hetimor, por aq më pak ju nuk mund të vini në diskutim firmat e deputetëve që e kanë hartuar, e kanë nënshkruar dhe kanë kërkuar këtë komision hetimor. Ky është vetëm një justifikim banal, por edhe shkelje e Rregullores. Një herë thoni se do të miratohet një ligj, por askush prej jush nuk e bën këtë, sepse ju nuk keni të drejtë të pezulloni ligje. Ju thoni: "Meqë ne do të ndryshojmë Kodin Zgjedhor, nuk do të ketë

zgjedhje më 14 maj”, por nuk ka shanse. Ju kërkoni që ne... Ne nuk i djegim më mandatet, nuk ka shanse. Ne do të jemi në këtë parlament dhe ju nuk do të bëni më ndryshime ligjesh, siç i bëte atëherë me “kërpëratën”.

Prandaj, ngrijeni komisionin hetimor! Në atë komision ne do ta nxjerrim llumin e zi deri në fund. Në atë komision do të dalin të gjitha lidhjet që kanë dalë sot në mediet amerikane mes Ramës dhe McGonigal-it, me Nezën, Duçkën dhe Deripaskën. Ju mund të miratoni një raport tjetër, për turpin tuaj, por nuk do ta ndaloni fjalën tonë. E drejta e opozitës është të kontrollojë mazhorancën. Sigurisht, këtë të drejtë e ka edhe mazhoranca, por ju e keni ndarë hesapin tuaj: çfarë t’ju thotë, atë do të miratoni. Na e ktheni të drejtën, sepse, pa u kthyer kjo e drejtë, nuk do të ketë seancë normale në këtë parlament dhe kurrë nuk do të guxonin të na e mohoni të drejtën për të shkuar në zgjedhje. Atë kërkoni të bëni, por kjo nuk ka shanse të ndodhë.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Bylykbashi!

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Për pretendimin e ngritur këtu që Byroja ka zhvilluar mbledhje pa pasur kuorum, e kam nxjerrë nga faqja e Kuvendit që anëtarët e Byrosë janë: zoti Agron Gjekmarkaj, zonja Anila Denaj, zoti Blendi Klosi, zoti Dashnor Sula, zonja Ermonela Felaj, zonja Etilda Gjonaj, zonja Klotilda Bushka, zonja Lindita Nikolla, zoti Taulant Balla dhe zoti Xhelal Mziu. Në këtë mbledhje kanë qenë prezentë: unë, zoti Balla, zoti Mziu, zonja Gjonaj, zonja Bushka, dhe, siç mund ta bëni lehtësisht llogarinë, kuorumi për ta zhvilluar këtë mbledhje dhe për të marrë vendime ka qenë i plotë. Zoti Mziu ka marrë pjesë në mbledhje dhe ka folur duke mbajtur qëndrimin e tij.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Fjala për replikë për zonjën Kryemadhi.

**Monika Kryemadhi** – Zoti Ministër i Drejtësisë, e kuptoj shumë mirë qëndrimin tuaj ndaj grave ministre dhe jam shumë dakord kur thoni: “Jam krenar kur punoj me zonjat”. Në fakt, edhe unë jam shumë krenare kur punoj me gra me dinjitet, me gra të pavarura, me gra të forta, me gra luftëtare për dinjitetin e tyre dhe të grave të tjera, por nuk jam dakord kur gratë nënshtrohen për qejfet e Kryeministrit, që firmosin aferat e tij; nuk jam dakord për gratë që firmosin evazion

fiskal për pastrimin e parave të drogës, që vijnë me kontejnerët e bananeve dhe rikthehen në beton, hekur dhe asfalt; nuk jam dakord kur rriten çmimet në mënyrë fiktive dhe firmosin gratë; nuk jam dakord kur përdoren edhe ministrat dhe ministret, sidomos, për interesat e Edi Ramës qoftë për t’i çuar nëpër vizita jashtë shtetit, qoftë edhe për t’i çuar në bisedime të fshehta, të cilat ju i dini shumë mirë; nuk jam dakord kur gratë përdoren në mënyrë primitive, siç janë përdorur. Për portin e Durrësit, meqenëse është “Dubai i Adriatikut”, pse nuk firmosi Kryeministri juaj?! Nuk jam dakord edhe për të gjitha projektet që ai firmos, por ai vetëm për diçka ka firmosur, për inceneratorin e Tiranës, dhe aty ka për ta ngrënë kallëp, ashtu siç ka qejf ai ta hajë, nuk e shmang dot atë gjë. Ndaj, mos u mundoni të mbronin atë dhe as ndonjë grua tjetër. Gratë e forta e mbrojnë vetveten, edhe kur nuk i kanë burrat e zotë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Kryemadhi!

Zonja Gjylameti e ka kërkuar fjalën për procedurë.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

**Blerina Gjylameti** – E nderuar drejtuese e seancës,

Unë e kuptoj që në këtë zallamahi, ku një njeri i fryn bilbilit, nuk mund të gjesh kthjelltësinë e duhur për të kuptuar se flitet për Rregulloren. Kolegët, të cilët gjatë gjithë kohës përmendin Rregulloren, kanë qenë pjesë e hartimit të saj dhe e dinë që neni 48 flet për kohën e diskutimeve (pika e parë e neni 48 flet për të drejtën që ka një deputet për ta marrë fjalën jo më shumë se 10 minuta dhe jo më shumë se një herë për të njëjtën çështje dhe për thelbin e të njëjtës çështje). Ndërkohë, sipas neni 49, që ka të bëjë me çështjet e procedurës, nuk mund të vijojmë ta marrim fjalën pafundësisht për procedurë, duke përmendur të njëjtën çështje, ndaj do t’ju lutesha të kalojmë në diskutim dhe të mos vijojmë me procedurën, për sa kohë që procedura përsërit vetveten.

Zonja Felaj, ju kërktoj t’i vazhdojmë diskutimet.

Nëse do të kenë diskutime të tjera për procedurë, mund t’ua jepni të drejtën për të folur, sepse e meritojnë, por të mos vijojmë ende me këto diskutime.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Vazhdoni, zoti Spaho, sepse i bini realisht shumë mirë!

**Ermonela Felaj** – Zonja Gjylameti, faleminderit për ndërhyrjen tuaj!

Vazhdojmë me listën e diskutantëve.

Ka edhe dy diskutantë për këtë pikë të rendit të ditës, zoti Vasili dhe zonja Xhixho.

Fjala për ju, zoti Vasili, nëse dëshironi të diskutoni për projektligjin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jua kam hequr fjalën, zoti Spaho.

**Petrit Vasili** – Meqenëse ma dhe me 7 copa fjalën, se mund t'i kisha mbaruar më parë edhe ato pak minuta, dua t'ju them sërish se e vetmja gjë që ka nevojë të diskutohet është ajo që po ndodh me financat shqiptare: lajmi i djeshëm i Bashkimit Europian që na vë nën monitorim. Pas 10 vjetësh qeverisjeje, ky është sukcesi i jashtëzakonshëm, këto janë votat që jepen me sy mbyllur dhe këto janë votat që jepen për të bërë qejfet e të gjitha llojeve të aferave! Pra, po kthehemi në një pikë ku nuk kemi qenë prej kohësh. Unë pres ta konsiderojnë edhe këtë si një sukses shumë të madh, si një arritje të jashtëzakonshme! Pra, pas kthimit në listën gri, të zezë, të pastrimit të parave, është edhe kjo tjetra. Kanë shkuar nga fitorja në fitore! Në këtë mënyrë, këto fitore, me ato votime, bëjnë që të përfundojnë si ato statujat në fund të vitit '91, sepse po në këtë sallë ka pasur një parlament të marrësh, që mbledheshin 1 herë në 3 vjet, mbanin fjalime, ngriheshin të gjithë në këmbë dhe duartrokisnin në kor. Këto janë arritjet.

Po jua përsëris se parlamenti është llogaridhënie. Po jua përsëris, të mos vazhdoni përpara! Po jua përsëris se jeni në shkelje të jashtëzakonshme të Kushtetutës së vendit, sepse po mohoni të drejtën për ngritjen e komisionit hetimor. Kjo nuk është e drejta juaj. Po jua përsëris: nuk është e drejta juaj! Ngrini komisionin hetimor! Mos u bëni qesharakë!

Kryetari i grupit parlamentar tha: “Nuk e pamë të arsyeshme, sepse kemi filluar ligjin”, ndërsa ju na thoni: “Nuk janë firmat në rregull”. Ju nuk po merreni vesh as me njëri-tjetrin, por keni një qëllim të vetëm: të mos bëhet komisioni hetimor për kiamet!

Për sa u përket trimërive të pafundme të Kryeministrit, dua t'ju them se ata që janë trima dhe e kanë ndërjegjen të pastër, të vijnë dhe të

japin llogari, siç e kërkon Kushtetuta, jo për t'i bërë qejfin opozitës, sepse ditën që ka marrë mandatin e Kryeministrit, ka marrë edhe detyrimin për të dhënë llogari. Ai i fshihet këtij detyrimi dhe ju të gjithë pa përjashtim i bëheni ortakë, duke shkelur ligjin dhe Kushtetutën.

Po jua përsëris: të ngrihet komisioni hetimor që sot! Mos vazhdoni me shkatërrimin e çdo norme, sepse jeni ju ata që e keni shkatërruar parlamentin, duke dhunuar çdo procedurë të faktuar.

Jua thashë edhe më parë dhe po jua përsëris: ju nuk keni standarde, nuk keni precedentë, por keni vetëm shërbim të verbër, sepse detyrimi për përmirësime të ligjit nga Gjykata Kushtetuese është një proces që kurdo që të ndodhë dhe kurdo që do të ketë një ligj të ri, në të 100-n e sekondës, ligji që kemi sot nuk do të jetë më. Deri në atë ditë, ky detyrim është i patjetërsueshëm.

Dashuria juaj për Kushtetutën është shprehur me vendimet që keni marrë pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për Teatrin, sikurse edhe në këtë sallë të Kuvendit, ku në dhjetor të vitit 2021, sipas detyrimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, duhet të ishte ndryshuar Kodi Penal për tubimet, por qindra qytetarë arrestohen dhe ndalohen vetëm e vetëm sepse vendimi nuk zbatohet, për t'i mbajtur qytetarët peng. Parlamenti është futur në paligjshmëri absolute.

A e njihni këtë gjë? Po. A jeni njoftuar? Po. A keni njoftim me shkrim? Po. A keni nismë ligjore të firmosur nga zonja Kryemadhi, nga unë dhe nga zonja Xhixho? A e keni penguar? Po. Pra, do të thotë se ju nuk keni respekt për Kushtetutën. Për ju nuk ekziston Kushtetuta. Për ju ekziston vetëm urdhri i të marrit dhe të gjithë vraponi pas tij. Nuk mund të ketë asnjë argument kundër, sepse këto janë e zeza në të bardhë.

Kush do ta vazhdojë këtë marrëzi, le ta vazhdojë, por kjo marrëzi prodhon këtë situatë, e cila bëhet me qëllim nga ana juaj, që të keni mundësi të kaloni ligjet, me anë të të cilave e çuat Shqipërinë (sipas lajmit të djeshëm, e keni të freskët), nën monitorim, si shtetet më me probleme që ekzistojnë sot në Europë dhe në botë. Ky është shërbimi financiar që i keni bërë vendit, ky është pastrimi i financave publike dhe kjo është situata, ku e keni futur me qëllim parlamentin, në kaos.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Vasili!



Zonja Spiropali e ka kërkuar fjalën.

Ju lutem, e keni kërkuar fjalën për procedurë apo për të diskutuar për projektligjin?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, më lejoni të zhvilloj mbledhjen siç duhet!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do të marrësh këtë përgjigje, zoti Braçe, dhe më pas do të sigurohem për ju.

Zonja Spiropali, për çfarë e keni kërkuar fjalën?

**Elisa Spiropali** – Unë nuk e kuptoj se në cilën pikë të rendit të ditës jemi, kur ende vazhdon të merret fjala për procedurë për të njëjtën çështje pa pushim.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ndoshta jemi në pikën e rendit të ditës ku hajduti ngrihet dhe të quan “hajdut”; ndoshta jemi në pikën e rendit të ditës ku vrasësi gjakftohtë ngrihet dhe të quan “kriminel”; ndoshta jemi në pikën e rendit të ditës ku imorali ngrihet dhe gjykon moralin kolektiv të grave, të shumicës dhe të qeverisë; ndoshta jemi në pikën e rendit të ditës ku ai, me ata që janë jashtë dhe ata që ka brenda, të cilët nuk kanë lënë gjë pa i bërë këtij vendi, nga dosjet, te blloqet, te çizmet, te mielli, te boja, te zhvatja, te marrëdhënia e dallaverja me të huaj e shqiptarë, ngrihen sot këtu dhe pretendojnë të na bëjnë neve një gjyq. Por populli ua ka bërë gjyqin atyre sa herë i kanë dalë përpara, sepse sa herë i kanë dalë dhe kanë vënë fytyrën e tyre, e kanë marrë përgjigjen, herë me 300 vota, herë me humbje, herë me dështim elektorale, herë se gjoja janë vjedhur, herë se janë kapur duke paguar lekët për kafe e të tjera. Përgjigjja u është dhënë dhe do t’u jepet edhe më 14 maj. Ata që ngrihen këtu apo ata që ulërijnë jashtë në majë të kalit, se Edi Rama duhet të zbresë nga kali, që të vijmë ne, përgjigjen do ta marrin më 14 maj, sepse as nuk e kanë mundur, as nuk do ta mundin, sepse nuk kanë fytyrë, nuk kanë moral, nuk kanë alternativë, nuk kanë ide, nuk kanë njerëz, por kanë vetëm bilbila.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Spiropali!

Zoti Braçe e ka kërkuar fjalën për procedurë.

Zoti Braçe, kërkoj t’ju sqaroj se unë kisha në sistem...

**Erion Braçe** – Faleminderit!

Nuk bëra asnjë fjalim...

**Ermonela Felaj** – Jo, jo, më fal!

Kisha në sistem dy kërkesa për të marrë fjalën, ndaj jo më kot e pyeta zonjën Spiropali se për çfarë e kërkonte fjalën. Në momentin që foli për procedurë, ishte përpara jush.

Nëse dëshironi, merreni fjalën! Këtu nuk ka asnjë arsye për t’u nervozuar askush. Dakord?

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ju lutem, përdorni sistemin, që të shikoni njëri-tjetrin se çfarë jeni duke bërë ndërkohë!

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Zonja Xhixho, keni fjalën për diskutim dhe këtu do të mbyllet kjo pikë e rendit të ditës.

**Erisa Xhixho** – E nderuar drejtuese e seancës,

Kolegë deputetë,

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Do të doja të sqaroja se jemi në këtë situatë sot, sepse këtu mungon llogaridhënia dhe nuk na lejohet të bëjmë punën për të cilën jemi votuar. Neve na jepet si një e drejtë apo si një bonus që, më në fund, më 2 mars Kryeministri do të ketë kohë t’i përgjigjet parlamentit për interpelancë, për seanca me pyetje, ndërkohë që e ka detyrim t’i japë llogari këtij parlamenti, sepse jemi republikë parlamentare, me gjithë dëshirën tuaj për të pasur një Shqipëri nën regjim dhe nën diktaturë. Për sa kohë të jetë ky parlament, në Rregulloren që ju citoni, dhe që unë do ta citoj patjetër, thuhet mjaft qartë që është detyrim i Kryeministrit të vijë dhe të japë llogari për një çështje skandaloze, që po shqetësojnë mbarë vendin, madje edhe më tej.

Nëse flasim për komisionin hetimor, unë kam firmosur për ngritjen e tij, për çështjen e agjentit të FBI-së, sepse mendoj që është një e drejtë kushtetuese, të cilën ma jep Rregullorja e Kuvendit.

Këtu dua të citoj dy momente ku ju shkëlmi Rregulloren dhe Kushtetutën e vendit.

Në nenin 25 të Rregullores thuhet: “Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një të katërtës së anëtarëve, është i detyruar...”, pra nuk keni të drejtë, por detyrim të ngrini komisionin hetimor për të shqyrtuar një çështje të veçantë.

Kushtetuta e vendit ua jep këtë të drejtë deputetëve të Kuvendit. Në nenin 77, pika 2 të Kushtetutës thuhet: “Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një së katërtës të të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë”.

Ndaj, drejtuese e seancës dhe ju, kolegë deputetë, jeni në shkelje të Kushtetutës dhe të

Rregullores. Dhe kërkoni standarde etike! Çfarë standardesh etike kërkoni, kur ju shkelni Rregulloren dhe të drejtën time për të bërë punën time?! Kam ardhur këtu që t'u shërbej qytetarëve dhe të jem zëri i tyre. Ju nxirrni pseudojustifikime për të mos ngritur komision hetimor, me pseudodrafte ligjore, me të cilat po synoni të përmirësoni ligjin për komisionet hetimore. Bëjeni, por ky ligj është në fuqi dhe, për sa kohë është në fuqi, keni detyrimin, jo të drejtën, të ngrini komision hetimor për të zbardhur të vërtetën, që e kërkon i gjithë kombi shqiptar dhe që nuk mund të fshihet. Është e papranueshme që një Kryeministër dhe një mazhorancë të përjashtojnë dhe të përndjekin deputetët. Cila është arsyeja? Arsyeja është se nuk doni të jepni llogari.

I kemi përdorur të gjithë mekanizmat e Rregullores dhe të Kushtetutës për interpelancë, për një seancë pyetje-përgjigje dhe na e keni mohuar. Çfarë prisni? Çfarë sjelljeje dinjitoze prisni, kur unë kam ligjin që m'i jep të drejtat dhe ju nuk i zbatoni, kur ju kërkohet ngritja e komisionit dhe ju nuk e zbatoni? Nuk po na lini të bëjmë punën tonë.

Jemi ende një republikë parlamentare dhe parlamenti është institucioni më i lartë i këtij shteti.

Ju, e nderuar drejtuese e seancës, duhet të ushtroni të gjithë autoritetin tuaj që Kryeministri, i cili është shërbëtor i qytetarëve, se nuk ka asnjë prerogativë më shumë, të japë llogari për skandalet e jo të thotë: "Nuk e njoh parlamentin". Nëse nuk e njeh parlamentin, të japë dorëheqjen, të largohet dhe të përgjigjet para drejtësisë për mbi 900 mijë qytetarë shqiptarë, të cilët e kanë lënë këtë vend, për të rinjtë që duan të largohen me gomone nga Shqipëria. Ky është shqetësimi më i madh i të gjithëve. 67% e shqiptarëve jetojnë me më pak se 5,5 dollarë në ditë, studentët, edhe në këto ditë të vështira nuk përkrahen as sa i përkrah Kosova, dhe pedagogët janë thirrur prapë në protesta, se pagat e tyre nuk u afrohen as atyre të Kosovës, se pagat janë të ulëta, sepse Shqipëria është kthyer në vendin e mundësive për disa, që po i largojnë të gjithë.

Edhe një herë, duke qenë se flasim mes juristëve, kërkoi zbatimin e Rregullores dhe të Kushtetutës, sepse kam firmosur për ngritjen e komisionit hetimor, për zbardhjen e të vërtetave njëherë e mirë!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Xhixho!

Faleminderit që e morët fjalën nga vendi, pasi deputetët e opozitës e degraduan foltoren e Kuvendit!

Këtu mbyllet kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Finlandës, për eliminimin e tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin dhe shmangien e evazionit tatimor".

Para se t'ia jap fjalën zonjës ministre, a ka pyetje nga kolegët? Nuk ka.

Zonja Ministre, fjala është për ju.

(Zhurmë bilbili në sallë)

**Delina Ibrahimaj** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Vijojmë në të njëjtat kushte të vështira, ku dëgjojmë lloj-lloj fjalësh dhe komentesh për punën tonë, por sërish sjellim një ligj i cili shkon në linjë me objektivat e qeverisë sonë për të forcuar pozitat e administratës tatimore, me qëllim që ajo të kryejë funksionin e saj në kuadër të shmangies së evazionit dhe të reduktimit të informalitetit.

Në fakt, ne ua kemi lënë ndërkombëtarëve dhe agjencive të vlerësimit ndërkombëtar për të vlerësuar mirëmenaxhimin e financave publike dhe punën që po bën qeveria shqiptare.

Dua t'ju rikujtoj se institucionet ndërkombëtare, si: FMN-ja, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Bashkimi Europian, agjencitë e vlerësimit, si *Moody's* dhe *Standard and Poor's*, vijojnë ta vlerësojnë performancën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si të mirëmenaxhuar, pas të gjithë krizave ekonomike që kjo qeveri ka përballuar.

Sa i takon projektligjit për marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Finlandës, dua t'ju nënvijëzoj se përmes tij synohet eliminimi i tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin e shmangien e evazionit tatimor.

Kërkesa për ratifikimin e marrëveshjes me Finlandën bazohet në modelin e OECD-së dhe të Kombeve të Bashkuara, por edhe në zbatimin e rekomandimeve të progresraportit të BE-së.

Përmes këtij ligji sigurohet kuadri i plotë funksional mes dy vendeve, që të mos krijohen premiset për rëndim me tatim të dyfishtë dhe të shmangët evazionit tatimor.

Shqipëria deri tani ka ratifikuar 44 marrëveshje dhe Finlanda bëhet kështu shteti i 45-të, ndërkohë që kanë përfunduar negociatat me Sllovakinë dhe, mbështetur në rekomandimet e Bashkimit Europian, do të fillojmë negociatat me Portugalinë, me Danimarkën dhe me Qipron.

Në besojmë se shmangia e tatimit të dyfishtë është një katalizator i rëndësishëm, që stimulon rritjen e investimeve të huaja direkte, dhe Shqipëria ka bërë një progres të ndjeshëm në përmirësimin e kuadrit ligjor, për të bërë të mundur një klimë sa më të favorshme dhe reduktimin e barrierave që mund të kufizojnë tregtinë. Ndaj, ju ftoj ta votoni këtë projektligj.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Ministre!

Nga shërbimet në sallë njoftohet se kolegët socialistë janë tërhequr nga diskutimet për këtë projektligj.

Zonja Kryemadhi, keni kërkuar fjalën. Dëshironi ta merrni fjalën për këtë projektligj?

**Monika Kryemadhi** – Një gjë më bën përshtypje: Kryeministri juaj nuk ka lënë banak televizioni pa dalë e pa folur dhe nuk vjen t'u japë përgjigje 13 pyetjeve, të paktën për moralin tuaj!

E dyta, unë vetëm juve ju kam parë që doni më shumë Edi Ramën, se fëmijët tuaj! Vetëm në këtë parlament e kam parë!

E treta, që ta keni parasysh, të nderuar kolegë socialistë, po jua them edhe një herë: mos vendosni dinjitetin tuaj para qejfeve dhe xhepave të Edi Ramës!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Kryemadhi!

Këtu mbyllet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: projektligji “Për miratimin e kontratës shtesë për ndryshimin e kontratës së koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive SICPA Security Solutions s.a., për projektimin, financimin, dizejnimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave, miratuar me ligjin nr.10381, datë 24.2.2011”.

A ka pyetje për këtë pikë të rendit të ditës?  
Zonja Tabaku e ka kërkuar fjalën.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

**Jorida Tabaku** – Zonja Ministre, kisha disa pyetje në lidhje me...

Mondi, të lutem! A ka mundësi?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Faleminderit!

Zonja Ministre, kush janë pronarët përfitues të koncesionit të pullave fiskale?

Zonja Ministre, në titullin e projektligjit thuhet se edhe barnat do të jenë pjesë e pullave fiskale. Sapo e lexoi drejtuesja e seancës. Pse barnat fiskale nuk janë pjesë e kësaj kontrate koncesionare? Pse qeveria shqiptare ka vendosur t'i përjashtojë?

Zonja Ministre, çfarë ka ndodhur me këtë koncesion në 8 vjetët...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Thashë “pullat fiskale”. Pse barnat nuk janë pjesë e procesit të kësaj kontrate për pullat fiskale?

Zonja Ministre, çfarë ka ndodhur në 8 vjetët e fundit me këtë kontratë koncesionare? Sa është ulur informalitetit? Si është shërbyer, në dëm të publikut?

Zonja Ministre, pse çmimet në Maqedoninë e Veriut, në vendet e rajonit, në Kosovë janë 10 herë më të ulëta se ato në Shqipëri?

Zonja Ministre, çfarë po ndodh me 2 kontratat e tjera koncesionare? Kur ka ardhur në pushtet kjo qeveri, në vitin 2013, tri kontrata i keni pasur flamur: skanimin, pullat fiskale dhe kontrollin teknik të automjeteve. Çfarë ka ndodhur me këto kontrata koncesionare dhe pse sot po shtyhen nga qeveria e nuk ka asnjë hetim për to?

Faleminderit, zoti Spaho dhe ju, zonja Ministre!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Tabaku!

Zonja Ministre, ju jeni dhe propozuesja e këtij projektligji. A dëshironi ta merrni fjalën për përgjigjen e pyetjeve dhe për prezantimin?

**Delina Ibrahimaj** – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Dua ta falënderoj deputeten Tabaku për pyetjet që drejtoi!

Në fakt, Ministria e Financave dhe Ekonomisë e ka prezantuar këtë projektligj në komision, por mbase zonja Tabaku nuk ka marrë

pjesë në atë seancë dhe nuk ka arritur t'i dëgjojë të gjitha përgjigjet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për sa ka parashtruar.

Sa u takon pronarëve përfitues, SICPA, *Security Solutions Albania* është një kompani, e cila, në 100% të kuotave të veta ka si pronarë SICPA s.a. në Zvicër, e cila, në zinxhirin e saj të pronësisë, arrin në pronarin përfitues përfundimtar, një shtetas zviceran, i cili quhet Philippe Amon dhe mban 100% të kuotave të kësaj kompanie, sipas deklarimit të kompanisë.

Sa u takon të gjitha programeve koncesionare, që kanë qenë të diskutueshme për shkak të kontratave të keqldhura në kohën e qeverisjes së mëparshme, dua t'ju rikujtoj se, për sa i përket kontrollit teknik të automjeteve, tashmë kjo kontratë koncesionare menaxhohet dhe mirëmenaxhohet nga shteti shqiptar. Në të njëjtën linjë me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, ne kemi vendosur që kontratën koncesionare të pullave fiskale ta kthejmë në një shërbim, i cili do të kryhet nga institucionet shtetërore. Për hir të kompleksitetit që ka kjo kontratë, na është dashur një kohë më e gjatë sesa koha e parashikuar 6-mujore për mbylljen e kësaj kontrate me qëllim ngritjen e shërbimeve, që kontrata të tilla, shërbime të tilla publike të jepen me kosto sa më të ulët për qytetarët, siç është rasti i kontratës që po menaxhohet nga DPSHTRR-ja.

Sa u takon çmimeve të kësaj kontrate koncesionare, ne kemi pasur një proces të gjatë negociatash me kompaninë SICPA, me qëllim reduktimin e çmimeve dhe, siç mund të jeni në dijeni apo siç janë të parashikuara në nenet e projektligjit, çmimet do të reduktohen në nivelin 10%. Përveç kësaj, në nenet e kontratës ka pasur një konflikt të vazhdueshëm, i cili nuk është trashëguar nga kjo qeveri, por nga qeveria e mëparshme, sa u takon pullave fiskale dhe gjurmimit të produkteve farmaceutike. Ka qenë një konflikt i vazhdueshëm me kompaninë, i cili mund ta çonte qeverinë shqiptare në një arbitrazh, dhe kjo është edhe një arsye tjetër se pse kontrata është rinegociuar, me qëllim që kompania SICPA *Solutions* të mos ketë asnjë pretendim për qeverinë shqiptare dhe të mos i krijojë asnjë kosto buxhetit të shtetit shqiptar.

Po vijoj me prezantimin e projektligjit, sepse besoj se pyetjet i ezaurova.

Projektligji, që e sjellim sot për shqyrtim dhe për miratim në këtë seancë plenare, vjen si nismë ligjore e qeverisë shqiptare. Përmes reformave të rëndësishme që kemi ndërmarrë ndër vite, kemi synuar dhe kemi arritur reduktimin e informalitetit në vend.

Më lejoni t'ju kujtoj se, sipas të dhënave të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, gjatë vitit 2022 është arritur që sasia e produktit "birrë" në total të jetë 91,3 milionë litra dhe në akcizë është paguar në import një vlerë prej 2,3 miliardë lekësh. Në vitin 2013, këta tregues kanë qenë respektivisht 62,4 milionë litra dhe 1,1 miliardë lekë të arkëtuara. Pra, duket qartë se lekët e arkëtuara nga akcizat janë dyfishuar në harkun kohor të të gjithë këtyre viteve. Ky është një tregues i qartë i reduktimit të informalitetit, i cili ka ardhur si pasojë e mirëmenaxhimit të administratës doganore. Vendosja e pullave fiskale për këto produkte ka dhënë një ndikim të fortë në arritjen e rezultateve të dukshme nga viti në vit.

Më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj se kontrata e koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe shoqërive SICPA *Solutions* s.a. dhe SICPA *Albania* sh.p.k., për projektimin, financimin, dizejnimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave, është lidhur në vitin 2011.

Për trajtimin e të gjitha problematikave që ka pasur kjo kontratë është ngritur një grup i posaçëm pune në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi qeveria e mëparshme nuk kishte përcaktuar as kohën e fillimit të kësaj kontrate, e cila u desh të negociohej dhe të përcaktohej qartë nga kjo qeveri.

Më lejoni të theksoj, të nderuar deputetë, se një sërë përmirësimesh të tjera rregullohen me këtë kontratë, si: aktivizimi i pullave fiskale në momentin e pagesës së detyrimeve të akcizës, pra në çastin e hedhjes për konsum në territorin e produkteve të akcizës; përmirësimi i teknologjisë së zbatuar CAPEX; ulja e çmimeve të produkteve të kontratës, si dhe përfitimi i trajnimeve të strukturave shtetërore të angazhuara në kontrollin e mallrave të akcizës nga shoqëria koncesionare.

Amendimi i kësaj kontrate shtesë do të na lejojë vazhdimësinë e shërbimit, ndërkohë që qeveria shqiptare përgatitet për të ngritur

strukturat digjitale dhe organizative, me qëllim që këtë shërbim ta ofrojë vetë dhe me kosto me të ulët për të gjithë përfituesit e këtij shërbimi.

Gjithashtu, nëpërmjet kësaj kontrate hiqet dorë nga çdo detyrim apo pretendim i palëve për mospërbushje të kontratës ndër vite, pra shoqëria koncesionare nuk do të ketë pretendime për kompensim të dëmshpërblimit retroaktiv dhe nuk do të pretendojë ndonjë penalitet për mospërbushje të kontratës nga shteti shqiptar.

Ritheksoj se kontrata është rinegociuar me një klimë të reduktuar të të gjitha produkteve të akcizës, me 10%.

Shoqëria koncesionare do ta vazhdojë këtë kontratë, duke përdorur teknologjinë aktuale të implementuar, bazuar në kontratën e koncesionit, me përmirësime teknologjike në fusha të gjykuara të detyrueshme, për funksionimin e duhur operacional dhe në terren, që lidhen me platformën CAPEX. Shoqëria do të ofrojë një asistencë teknike 7-mujore para përfundimit të kontratës. Gjatë kësaj periudhe shoqëria do të bëjë një investim nga 3 deri në 5 milionë euro, sipas skedulimeve që do të kryejë grupi negociator i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Besoj se isha shteruese në prezantimin e amendimeve të kësaj kontrate, me qëllim përmbjlljen me sukses të saj dhe për të mos i lënë asnjë hapësirë dhe për të mos i ngarkuar buxhetit të shtetit asnjë penalitet, shkaktuar nga një kontratë e keqlidhur nga qeveria e mëparshme.

Ju faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Ministre!

Në bazë të nenit 65, pika 1 të Rregullores, meqenëse deputeti Edmond Spaho, edhe pasi iu dha masa e vërejtjes, vazhdon ta mbajë të zaptuar foltoren e Kuvendit, vendos përjashtimin e tij nga kjo seancë plenare! Kjo masë të shoqërohet me sanksion financiar të barabartë me ndalesën e pagës së deputetit për këtë ditë!

Zoti Spaho, do të vazhdoj t'ju paralajmëroj për të njëjtat masa për çdo pikë të rendit të ditës, sepse sjellja juaj është përsëritëse. Mendohuni mirë për dënimin që do të merrni në fund!

Ndërkohë, i tërheq vëmendjen zonjës Hoti. Ju bëtë zhurmë edhe gjatë kohës kur po fliste një kolege e opozitës.

Zonja Tabaku, keni kërkuar fjalën për replikë? Keni radhën për të folur, por meqë e keni kërkuar tani...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Shalsi.

**Eduard Shalsi** – E nderuar drejtuese e seancës, që ju ka rënë barra të drejtoni një seancë krejt jonormale, për shkak të situatës...

Mondi, të lutem, bilbilin, se nuk flas dot pa bilbilin tënd!

...Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar kolegë deputetë, pjesa racionale e opozitës...

Në fakt, Mondit, kur i re bilbilin për koleget e tua të nderuara, ne duhet të gjithë, të dashur deputetë, ta mirëkuptojmë, sepse, nëse do të dinit të bënit diçka më mirë, do ta bënit. Një pjesë tonën e shoh të acaruar, por unë, personalisht, e marr me shumë sportivitet këtë sjellje, për hir të së vërtetës, sepse do klas që të flasësh me klas; do finesë si grua, të flasësh me finesë; do elegancë të flasësh me elegancë. Ku do t'i gjejnë parafolëset këto virtute dhe këto cilësi?!

Natyrisht që kjo opozitë e hapërdarë kuturu, qesharake, pa bosht dhe pa drejtim do të duhej që sot të sillej ndryshe, nëse do të kishte ide dhe alternativa.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Po diskutojmë një kontratë koncesionare që bilbilfryrësi dhe bilbilfryrësat e kanë miratuar në vitin 2011. Kontrata e pullave fiskale, e konceptuar keq, e dizenuar keq, e kontraktuar keq, bëri që bizneset shqiptare të paguajnë shumëfish më tepër sesa bizneset në vendet e rajonit dhe të botës. E, pra, ishte një moment i mirë (këtu bie dakord me dy koleget e nderuara, dhe unë nuk e kam fshehur respektin dhe konsideratën për disa nga koleget dhe kolegët opozitarë kur vjen puna për të debatuar për çështje, të cilat janë shumë të rëndësishme dhe kanë impakt të jashtëzakonshëm), ishte një moment shumë i rëndësishëm për të kuptuar, jo thjesht për t'i akuzuar ata që bënë kontratën në vitin 2011, dhe për të analizuar pse ndodhi. Paaftësia e tyre bëri që në 12 vjet bizneset shqiptare të paguanin tarifa të padrejta. Po, e nderuar zonjë, përmende me shumë të drejtë barnat farmaceutike, të cilat i përfshitë në kontratën e vitit 2011.

Mondi, të lutem, nuk flas dot pa bilbilin tënd.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

E përmende me shumë të drejtë dhe ishte momenti kur ne duhej të kuptonim pse ishte i

pamundur implementimi i një mase të tillë. Pse?! Në vitin 2015 kemi qeni dëshmitarë kur erdhi një amendim i kontratës. Po pse nuk u bë?! Nëse vërtet ju shqetësojnë hallët e njerëzve, e bizneseve, ejani të flasim konkretisht. Cilat ishin idetë tuaja? Po zhbëjmë një kontratë, fatkeqësisht pas shumë kohësh, fatmirësisht në vitin 2024. Ku ishit?! Për shembull, ky që i bie bilbilin, çfarë bënte kur nënshkruhej kontrata në vitin 2011?! Këto kanë nevojë të dëgjojnë njerëzit. Këto janë problemet dhe shqetësimet reale të njerëzve.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Të nderuar kolegë deputetë,

Mua, personalisht, çfarëdolloj epiteti që vendosni, apo edhe kolegëve të mi, nuk më bën përshtypje, sepse nuk ju marr seriozisht, nuk ju marr fare seriozisht... Madje ka një popull që na gjykon atje jashtë për çfarë themi dhe çfarë bëjmë, për çfarë kemi thënë dhe çfarë do të bëjmë. Njerëzit e dëshpëruar bëjnë gjëra të dëshpëruara, dhe mua më vjen keq të shoh sesi është katandisur një burrë në moshë, i cili duhej të gëzonte paqe në shpirtin e tij, pas pak do të duhej të gëzonte pensionin; do të duhej t'u jepte një shembull fëmijëve, nipërve dhe shoqërisë sesi duke u plakur bëhesh më i mençur, bëhesh më i urtë. Pse? Pse? Pse? Për të mbrojtur *non grata*-ën. Ju ka marrë peng.

Mos ua qani hallin as grave ministre, as deputetëve të këtij krahu, por qajani hallin vetes suaj, sepse jeni bërë për t'u mëshiruar. Mua më kaplon një ndjenjë e madhe keqardhjeje teksa shoh se në ç'derexhe jeni katandisur, por, me sa duket, ky ka qenë destinacioni juaj; ky ka qenë fati juaj. Eh, pra, në jetë, mbajeni mend, Partia Demokratike dhe çdo forcë politike nuk do të marrë atë që do (është njëlloj si në jetën individuale), por do të marrë atë që meriton. Prandaj jeni katandisur këtu ku jeni.

Shumë faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Shalsi!

Fjalën e ka zonja Tabaku.

Të përgatitet zonja Gjylameti.

**Jorida Tabaku** – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar qytetarë,

Unë besoj se ne e kemi humbur sensin për të kuptuar shumë gjëra që ndodhin në parlament. Edhe unë kam hequr dorë për të kuptuar shumë gjëra dhe shumë sjellje në këtë parlament.

Dëgjova zonjën Spiropali që na u drejtua me shprehjet (i mbajta shënim): “Vrasës, kriminel, hajdut, hajni”. Në fakt, këto gjëra janë shumë të mira për qytetarët, janë shumë të mira për votuesit dhe pikërisht me këto gjëra, zonja Spiropali, qytetarët presin që t'u drejtohem; këto janë elementet që sot qytetarët shqiptarë presin të dalin nga ky parlament, që rrezaton mençuri dhe dritë; rrezaton elitën e këtij kombi, e cila, në fakt, fatkeqësisht, nuk di të flasë, sillet me dhunë dhe nuk di të ofrojë zgjidhje dhe shfryn vetëm mllef.

Unë u përpoqa të lexoja disa elemente të kontratës koncesionare, të cilat besoj se do të ishin të rëndësishme edhe për qytetarët. Do shumë guxim të bësh atë që bënë sot zoti Shalsi dhe ministrja e Financave: të dalësh e ta mbrosh këtu atë që ke sharë, ke anatemuar, ke sulmuar...

Shumë kolegë socialistë përpara vitit 2013 përdornin fjalët: “Kontrata koncesionare e pullave fiskale është interesi i qeverisjes, i familjes së qeverisjes...”. Po sot, interesi i kujt është kjo kontratë këtu? Interesi i kujt është kjo kontratë që vjen sot në parlament?

Zonja ministre, në fakt, nuk ka faj, sepse ka dy muaj që është fshehur. Nga momenti që është arrestuar sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nuk vjen në komision; nuk flet për buxhetin, fshihet pas forcës së kartonëve, dhe e kuptoj shumë mirë që është e paaftë dhe arrogante që të kthejë përgjigje. Interesin e kujt mbronin që e shtyni kontratën koncesionare për dy vjet? Unë besoj se qytetarët shqiptarë sot kanë nevojë të dëgjojnë se korrupsioni nuk ka ngjyrë; korrupsioni nuk është blu, e thashë pak më parë, që korrupsioni shkon përtej qeverisjes, se pushteti që blen një kontratë koncesionare, vazhdon nga një qeverisje në tjetrën; pushteti që blen vota, që kap sot parlamentin për të votuar dhe për të shtyrë këtë kontratë koncesionare, nuk njuh ngjyrë.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Unë sot do të kisha dashur shumë që kolegët e mi të opozitës, ata që e votuan pro këtë kontratë koncesionare, të ishin ngritur e të flisnin që të mbronin dinjitetin e tyre, por, fatkeqësisht, nuk po e bëjnë këtë, sepse në këtë parlament ne nuk bëjmë dot asgjë, as nuk flasim dhe nuk vijmë dot as për ata që jemi votuar.

Unë besoj sot se qytetarët shqiptarë kanë të drejtë të dinë kush është i korruptuari që ka sjellë këtë kontratë koncesionare në parlament dhe cilët janë ata që do të ngrenë kartonët për ta votuar këtë

kontratë koncesionare. Sot ka tri kontrata koncesionare, të cilat i keni akuzuar dhe i keni anatemuar. Në qoftë se sot ka një barrë të rëndë për buxhetin e Shqipërisë, janë pikërisht koncesionet: koncesionet abuzive të rrugëve, të shëndetësisë; koncesionet abuzive, të cilat po kalojnë çdo limit, po lëvizin në porte dhe aeroporte, ku çdo ditë jepet një copë Shqipërie.

Por unë e di që deputetëve të këtij parlamenti nuk u intereson të flasin për këto, prandaj bëhet edhe zhurma; unë e di që nuk i lini të flasin sot se çfarë po ndodh me vjedhjet, ku, sigurisht, thuhet që fajin e ka pala tjetër dhe do të vazhdojmë përjetësisht t'ia hedhim fajin, topin tjetrit dhe kurrë nuk kanë për të dalë fajtorët e vërtetë.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Sot besoj se qytetarët shqiptarë meritojnë të dëgjojnë në lidhje me tri koncesionet korruptive; meritojnë të dëgjojnë për 2,2 miliardë eurot, të cilat i kanë ardhur buxhetit të shtetit në këta 10 vjet qeverisje të Partisë Socialiste.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Unë nuk besoj se sot Shqipëria ka sfidë më të madhe se korrupsioni; korrupsioni që blen zyrtarin e FBI-së; korrupsioni që blen punonjësen e koncesioneve dhe të tatimeve; korrupsioni tek inceneratorët; korrupsioni që vjen në parlament dhe i detyron deputetët të votojnë për t'ua shtyrë afatin për dy vjet kontratave, të cilat i kanë akuzuar si korruptive. Sot korrupsioni i banakëve ka kaluar në nivelin e kapjes së shtetit, sot korrupsioni po i merr frymën Shqipërisë, prandaj ky parlament nuk funksionon.

Unë jam e sigurt se edhe ata që u bien bilbilave sot, edhe ata që bëjnë zhurmën sot, do të kishin dashur t'i thoshin këto fjalë, por që të flasësh për korrupsionin, kërkohet shumë guxim. Unë besoj se kërkon guxim t'u vësh emrin atyre që vjedhin sot Shqipërinë. Unë besoj se kërkon guxim sot të flasësh e të thuash që korrupsioni nuk njih ngjyrë; nuk njih pushtet dhe, kur vjen në këtë parlament, jeni të gjithë të përlyer.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Tabaku!

Fjalën e ka ministrja e Financave.

**Delina Ibrahimaj** – Unë solidarizohem me ju, zonja Tabaku, sepse për herë të parë, kur një përfaqësues i opozitës foli, vazhduan bilbilat, të paktën e kuptuat se çfarë vështirësie jemi duke kaluar për një mosfunksionim normal të

parlamentit, të cilin e shkaktoni ju dhe vetëm ju. Ne që ditën e parë kemi kërkuar të normalizohet situata në parlament, por nuk doni të dëgjoni; nuk doni të veproni dhe arsyet i shpjegoam, do t'i rishpjegojmë, pasi keni frikë dhe tmerr nga ato që mund t'ju ndodhin, por ju nuk mund të vini këtu e të përmendni në 5 minuta 50 herë fjalën “korrupsion”, pa pasur në asnjë moment asnjë provë për atë që thoni.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ne këtë e kemi kërkuar, dhe e kemi thënë në mënyrë të përsëritur, që do guxim të madh që një anë e superkorruptuar, e cila është shkaktarja e firmosejs së kësaj kontrate, që të na akuzojë për korrupsion në përmbylljen e kësaj kontrate. Unë dua të ritheksoj se është turp që këtu flitet për korrupsion, për afera, për afera imagjinare dhe për të gjitha ato që thoni ju, për gjëra që i ëndërroni natën dhe vini i villni këtu ditën. Unë nuk e kuptoj pse duhet të dëgjoj në këtë parlament fjalë nga zoti Spaho, që për më tepër është i përjashtuar sot, akuza për abuzime që nuk ndodhin dhe nuk kanë për të ndodhur. Abuzime janë kontratat që firmosnit ju me periudha 10 dhe 15-vjeçare në dëm të biznesit shqiptar, në dëm të qytetarëve shqiptarë dhe këtë qytetarët e kuptojnë mjaft mirë.

Ju mund t'i bini fyellit dhe bilbilat nga mëngjesi deri në darkë, por shqiptarët e kanë kuptuar këtë dhe e tregojnë çdo herë me votat e tyre dhe me mbështetjen që i japin Edi Ramës dhe Partisë Socialiste.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Zonja Gjylameti, fjala për ju.

Të përgatitet zoti Xhelal Mziu.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

**Blerina Gjylameti** – Faleminderit, e nderuar kryesuese e seancës!

Fatkeqësi e madhe, keqardhje edhe më e madhe, që kjo opozitë, siç thotë populli, pa kokë e pa këmbë, pa vulë e pa kësulë, pa din e pa iman, nuk lë shprehje, nuk lë term, nuk lë fyerje, nuk lë përbaltje, nuk lë akuza pa asnjë argument, jo vetëm për mazhorancën, jo vetëm për kolegët tona ministre apo kolegët deputetë, por linçojnë edhe kolegët e tyre, ata që i kanë përkrah në betejat e tyre. 5 i fryjnë bilbilat dhe i bien tavolinës; ata që janë bosh, bëjnë fotografi, që nesër t'u çojnë mesazhin e të fillojnë t'ia akuzojnë për të shitur e për të blerë. Fatkeqësi e madhe që e kanë katandisur veten në këtë rrokopujë skandaloze!

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Realisht më vjen keq për diçka, janë shumë larg, por tmerrësisht larg nga roli që duhet të kenë si parlamentarë; janë shumë poshtë dhe nuk ngrihen dot në lartësinë e detyrës si të zgjedhur të popullit, por janë edhe më keq për sa i përket rolit që kanë si nëna, si vajza, si motra, si baballarë, si vëllezër. Çfarë u thoni, të nderuara zonja, të nderuar zotërinj, fëmijëve tuaj kur shkoni në shtëpi, pasi i keni rënë gjoksit për dhunën, për baltosjen, për krimin, që përmendni nga mëngjesi deri në darkë, për fyerjet, për linçimin, për gjuhën tërësisht të paskrupullt e të paprecedentë ndaj vajzave dhe nënave këtu? A ju thonë ata në fund që janë krenarë për ju, zoti Spaho, për gjuhën që përdorni? A ju thonë që janë krenarë për ju, për rolin që keni si parlamentarë? A ju thonë që janë krenarë për ju, për dhunën që ushtroni në tempullin e demokracisë?

Tërë ditën flisni e bërtisni, çirreni dhe ulërin, ndërkohë rezultatin ata që ju kanë zgjedhur, jua japin njëllon. Gjithmonë e më pak jeni kur dilni në protestë, gjithmonë e më pak do të mbeteni, për sa kohë jeni ndarë, siç e shikoni, 5 atje, 5 këtej, duke akuzuar njëri-tjetrin, duke sharë njëri-tjetrin dhe duke linçuar njëri-tjetrin. E keni katandisur këtë sallë që të merremi me nivelin tuaj! Unë nuk e kuptoj se ku doni të përfundoni?! Këtë e keni parë gjithmonë e më pak. Juve rruge e mbarë ju qoftë, por ne peng nuk na mbani, sepse balta nuk krahasohet me punën; dhuna nuk krahasohet me të drejtën. Bërtitja dhe fryrja në të njëjtën vrimë nuk ndryshon gjë nga rezultati që ju do të keni përsëri më 14 maj, sepse në fund ne jemi votuar; votohemi për punën; votohemi për premtimet; votohemi për çfarë kemi bërë dhe çfarë do të bëjmë më mirë; votohemi edhe sepse ata e shikojnë se cilët jeni ju, ndaj jemi në këtë pikë.

Ndërkohë, të nderuar kolegë,

Ne votohemi në të gjitha mënyrat. Dhe përse, do të thoni ju? Mjafton të shikoheni si jeni.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Të nderuar kolegë,

Kam edhe diçka për parafolëset. Është e dyta herë që tjetërsoni fjalët këtu dhe manipuloni situatat.

Së pari, kur tentoni që zhurmuesin ta vendosni në dorën tonë, ndërkohë që e keni në dorën e kolegëve tuaj, që i keni pasur në të majtë e në të djathtë, në beteja ndër vite.

Së dyti, tjetërsoni fjalët të thëna nga ju që nga dita kur keni shkelur këtu, më pas doni ta vendosni në gojën e zonjës Spiropali baltën që hidhni.

E nderuar zonjë,

Nuk shkon që, për sa kohë shisni moralin, moralin e thyeni ju; nuk shkon që, për sa kohë doni të shisni etikën, etikën e thyeni ju; nuk shkon që, për sa kohë që po flisni për të drejtën, të drejtën e degjeneroni ju këtu.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Për t'u kthyer te pika e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me ndryshimin e kontratës koncesionare, kam një element tjetër për këtë. Më vjen mirë që pas kaq vjetësh erdhët në atë që ne kemi thënë para shumë vitesh: kishim të drejtë që ajo ishte një kontratë korruptive, një kontratë e keqnegociuar dhe kishte interesa tërësisht për xhepat e dikujt. Ndërkohë, nga njëra anë, ne e ndryshuam (jo për herë të parë) për të ulur çmimin dhe barrën që duhet të paguajmë, në anën tjetër për të hequr mundësinë që nesër apo pasnesër kjo kontratë të goditet në arbitrazh, sikundër ju keni lënë shumë kontrata...

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Kam edhe diçka tjetër: a ia vlen, të nderuar kolegë, ju të pestë që jeni atje, që po thyeni e po e dhunoni tempullin e demokracisë, të shkoni në rrokopujën e Saliut? Bëjani këtë pyetje vetes, por bëjani rregullisht, derisa të kuptoni që keni një betejë tërësisht të humbur.

Ju faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Zonja Elda Hoti, merrni vërejtje, sipas nenit 64/1 të Rregullores, për pushtimin e foltores. Ka disa minuta që po ju ndjek vijimisht dhe zhurmën në sallë e shkaktoni ju dhe zoti Spaho, që natyrisht konsiderohet i përjashtuar nga kjo seancë...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Pasi prishët edhe foltoresh, uluni dhe fjalën kërkoheni nga vendi. Ju nuk mundeni, sepse ju është hequr fjala. Zonja Hoti, kini parasysht që rrezikoni masën tjetër disiplinore.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Fjala për zotin Xhelal Mziu.

Zoti Mziu, dëshironi të diskutoni apo jo?

**Xhelal Mziu** – Unë jam në pritje të Kryeministrit, të cilin kemi 5 seanca që po e presim të vijë dhe të japë opsionin e përmendjes së emrit të tij 14 herë si një person që ka tentuar



dhe e ka realizuar në njëfarë mase minimin e demokracisë në përdorimin e parave publike, për blerjen e eksponentëve të lartë të FBI-së. Në momentin që do të vijë Kryeministri, besoj se do të kthehet edhe normaliteti në sallë.

**Ermonela Felaj** –Faleminderit, zoti Mziu!

Zoti Braçe, dëshironi të flisni?

**Erion Braçe** – Si të mos flas?! Kam gjithë ditën që po pres për të folur.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Sinqerisht, që në krye të herës, dua t’i shpreh solidaritetin tim zotit Spaho, kolegut Spaho, i cili ka fiks 4 orë e 16 minuta që u torturua, i fryn bilibilit aq sa cilido fyellrënës nuk do të kishte frymë t’i binte. Është një rekord *Guinness* dhe, sinqerisht, do t’i ngelet emri me germa të arta në mes të parlamentit të Shqipërisë për një akt të tillë, që nuk mbaron dhe jam i bindur se me fuqinë që ka zoti Spaho, do të vazhdojë t’i bjerë edhe 10 herë më shumë sesa i ka rënë sot.

E vetmja keqardhje që kam lidhet me dy aspekte shumë të rëndësishme:

Së pari, si ka mundësi që nuk e zëvendësoi asnjëri nga ju?! Si ka mundësi?! E bën robi një sakrificë për kolegun që ka në krah, e bën edhe për solidaritet, ia merr bilibilin dhe i bie vetë, për t’i thënë: “O Mondì, faleminderit që u sakrifikove, por tani është momenti që t’i bie unë fyellit për ty, mor burrë! I bie unë fyellit për ty!” Është tmerr! Ka robi cipë! Po çfarë jeni?!

Mirë që Sali Berishën e latë atje përjashta, e latë përjashta, nuk e futët brenda; mirë që Tritan Shehun e latë atje përjashta, po çfarë muhabeti është ky?

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Këtë po ju them.

*(Zoti Spaho ndërhyr pa mikrofon.)*

Këtë po ju them, o Mondì.

*(Zoti Spaho ndërhyr pa mikrofon.)*

Po të vlerësoj, po të çmoj, sinqerisht! Unë nuk do ta bëja dot, ti e bën, shumë mirë!

*(Zoti Spaho ndërhyr pa mikrofon.)*

Shumë mirë që po e bën, po përse nuk e bëni të gjithë?!

*(Zoti Spaho ndërhyr pa mikrofon.)*

Pse nuk e bëni të gjithë?!

*(Zoti Spaho ndërhyr pa mikrofon.)*

Së dyti, këtu në sallën e parlamentit ka një problem shumë të madh, zonjë: këtu të duket vetja i marrë nëse flet për çështjet e rendit të ditës; ky është problem shumë i madh. Domethënë, këtu po

nuk fole siç do një tjetër, siç do një tjetër, siç do një tjetër, është komplet jashtë çdo logjike! Nëse këtu sillësh normalisht, është komplet e pakuptueshme, veçanërisht për krahun andej. Thënë këtë, sinqerisht, e kuptoj shumë qartë që në këtë sallë ka njerëz që përdorin edhe togfjalëshja, të cilëve nuk u dinë as kuptimin.

*(Zoti Spaho ndërhyr pa mikrofon.)*

Ne kemi folur për analfabetizëm funksional dhe e kemi drejtuar gishtin jashtë kësaj sale, por, për fat të keq, analfabetizmi funksional është këtu brenda sa kohë ka njerëz që nuk i kuptojnë as fjalët që thonë. Sinqerisht, dëgjova dikë qëparë që na bëri thirrjen “mos e vini dinjitetin tuaj para interesave të Edi Ramës”. Po, dinjitetin tim do të vë të parin.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Të lutem, dëgjoje atë që thua, kuptoje atë që thua, sepse është skandal!

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Tani, për të ardhur te pika e rendit të ditës, e dëgjova me shumë vëmendje zonjën Tabaku, e cila pa diskutim që meriton përgjigje. Zonja pyeti: kush është pronari përfitues i kësaj kontrate? Ta them unë: Philipe Amon, i cili është kontraktuar nga Sali Berisha, dora vetë, me një procedurë pa garë, me një procedurë pa konkurrencë, me një procedurë që u kontestua nga a-ja te zh-ja, që natyrisht i shkoi deri në fund. Për këtë e bëre pyetjen, që të ta them unë? Po, ta them unë: Sali Berisha, nga a-ja te zh-ja, bashkë me ministrin e tij.

Ke shumë të drejtë kur pyet: pse kjo kontratë ka 10 vjet që rri në fuqi kur ka qenë e tillë, e lidhur nga Sali Berisha, e lidhur nga ministrat e tij, e lidhur nga drejtorët e tij dhe e zbatuar nga drejtorët e tij? Është një pikë në atë kontratë, zonja Tabaku, meqë je një nga njerëzit që lexon në këtë sallë të parlamentit, e cila lidhet drejtpërdrejt me sigurinë juridike.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Në këtë sallë të parlamentit është bërë modë që kur ti vret, kërkon llogari pse i sollët atje përpara që t’i vrisja unë!

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Këtu është bërë modë dhe po fiton qytetari që të thuash se këtë kontratë e bëra unë, po ti pse e vazhdove?! Pse e vazhdove atë kontratë, madje edhe kur janë vendosur kushte, që mbrohen nga siguria juridike?! Jam i bindur që po ta kishim ndërprerë, përsëri ju, secili prej jush do të dilte dhe

do të thoshte, në mënyrën më të qartë të mundshme: po këtë kosto që na erdhi nga Arbitrazhi, si ka mundësi që na e ngarkuat ju në kurriz? Ja, ky është problemi dhe është shumë i madh.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Kur flisni për korrupsionin dhe të korruptuarit, qëndroni drejt dhe qëndroni drejt me veprime, mos qëndroni drejt thjesht dhe vetëm me llafe. Nëse duhet të flisni, atëherë po ju pyes unë: kë keni në mendje si pronar kur thoni që është një oligark? A ka mundësi t'ia thoni emrin? Njëherë në jetën tuaj përmendeni me emër. Ju nuk keni as kurajën ta përmendi me emër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, pra, po, edhe ti je e përfshirë në këtë histori.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Natyrisht që ka dy probleme të mëdha:

Së pari, qytetarët shqiptarë në 10 vjet, jo biznesmenët, as ata të cigareve, as ata të birrës, të cilëve ju u dilni për zot gjatë gjithë kohës, i kanë dhënë kësaj kompanie, të kontraktuar nga Sali Berisha, mbi 100 miliardë lekë. Natyrisht, janë shumë para, janë tetë herë më shumë se çdo të kishte marrë kjo kompani në Kosovë, fjala bie. Janë mbi 88 milionë euro, që kjo kompani i ka marrë për shkak të çmimeve mizerabël që ka, të cilat u kanë rënë konsumatorëve në kurriz.

Dua t'ju them se ai 10%-shi që kemi ulur nuk është asgjë në raport me tetë herë më shumë çmime që paguajnë sot qytetarët, pikërisht për shkak të kësaj kontrate. Kjo është e para dhe është shumë e rëndësishme për ta kuptuar.

Së dyti, e vetmja gjë që mbetet në këtë histori është që më në fund kemi ndarë mendjen dhe kemi mundësinë juridike ta ndërpresim këtë kontratë për ta kaluar në një shërbim publik.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Një pyetje kam: ku jeni, sepse po ju lexoj që keni mendime të ndryshme? A doni që ky të jetë një shërbim publik, me kosto minimale përkundjet kompanive dhe në fund fare përkundrejt qytetarëve, apo doni që ky të jetë përsëri një shërbim në dorë të një kompanie? Thujeni qartë këtë gjë, sepse njerëzit duhet të na kuptojnë dhe të na vendosin në mënyrë të qartë para vetes së tyre, ku ta ndajnë qartazi: këta apo këta janë lidhur me filan kompani e me fiste...

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Po, boll, më lër ta mbaroj, se nuk të fola ty!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ta mbaroj unë, pastaj fol ti!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe një herë, o zotëri, sepse nuk po të kuptoj: e ke me mua, se nuk po të marr vesh?!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nëse e ke me mua dhe...

**Ermonela Felaj** – Zoti Sula, zoti Gështenja, ju lutem, mos ndërhyini!

**Erion Braçe** – Qëndrimi im ka qenë në mbrojtje të interesit publik nga a-ja te zh-ja.

**Ermonela Felaj** – Zoti Gështenja, e kuptoni që nuk dëgjoheni kur bëni zhurmë?!

**Erion Braçe** – ...edhe për shqiptarët dhe kam votuar kundër. Kur nuk di gjë, nuk di gjë. Kur nuk di gjë, qepe!

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Qepe kur nuk di gjë! Kaq!

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Është shumë e qartë që kjo linjë sjelljeje duhet të jetë për çdo kontratë shërbimi, edhe për ato kontrata që janë trashëguar nga qeveria e Sali Berishës, që vetëm në këtë rast i kemi dhënë 100 miliardë lekë, pa harruar të tjerat, që janë dhënë apo jepen pa marrë asgjë pas. Është themelore kjo gjë.

Nëse nuk ka një qëndrim unik nga fillimi deri në fund për çdo kontratë, për çdo shërbim, që duhet të mbetet publik, duke përmbushur interesin publik të qytetarëve, atëherë kot që akte individuale, si puna e këtij, sillen për votim në parlament për t'u votuar. Pra, duhet të jenë të gjitha, të gjitha duhet të shkojnë atje ku janë, atje ku ishin dhe atje ku duhet të rrinë, te shteti dhe tek interesi publik që përmbush shteti, asnjë individ tjetër privat.

Të njëjtën gjë po them edhe për atë që ia bën mu, që është kontrata e markimit të karburanteve, për të cilën pronarin përfitues nuk duhet ta mësojmë nga "Panama Papers", por duhet ta mësojmë nga institucionet shqiptare; po ashtu edhe kontrata e skanimit, për të cilën janë shtyrë afatet që të mos çojmë kosto shtesë të qytetarët, duhet të shkojë deri në fund dhe të jetë një shërbim që kryhet drejtpërdrejt nga shteti.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Braçe!

Ju lutem, kolegë mos i ndërhyini nga vendi njëri-tjetrit!

Zoti Braçe kishte regjistruar emrin për diskutimin e kësaj kontrate dhe për këtë kontratë

ka mbajtur të njëjtin qëndrim që prej 11 vjetësh. Kush ka qenë në parlament në vitin 2011, në atë vit krahu këndeje ka qenë në opozitë, e mban mend këtë qëndrim të mbajtur për këtë kontratë nga zoti Braçe.

Zonja Tabaku ka kërkuar fjalën për replikë.  
(*Zhurme bilbili në sallë*)

**Jorida Tabaku** – Zonja drejtuese e seancës, Kontratat koncesionare të gjitha janë bërë abuzive në kurriz të shtetit dhe jo në kurriz të koncesionarit. Kjo qeveri sot ka 385 milionë euro fatura arbitrazhi për shkak të kontratave abuzive, të cilat janë bërë pikërisht prej saj.

Kontrata koncesionare e inceneratorëve sot paguan edhe inflacionin, paguan edhe persona në kërkim, paguan edhe persona për afera korruptive. Këtë qeveri në tetë vjet nuk e ka ndaluar asgjë që të hetojë kontratat korruptive. Ashtu siç është e përcaktuar në kontratë, në rast se gjendet që këto vepra janë korruptive, pagat duhet të ishin ndaluar. Nuk e ka fajin opozita që për tetë vjet kjo qeverisje ka mbuluar, ka manipuluar, ka shtuar kontrata të tjera, sigurisht jo në përfitim të opozitës, por në përfitim të atyre që mbulojnë.

Zoti Braçe, unë në këtë parlament nuk kam frikë të përmend askënd, mund të jem nga të vetmet që kam përmendur këdo, duke filluar me naftën, duke vazhduar me koncesionet, me rrugët dhe me inceneratorët; nuk kam frikë, sepse nuk më kap askush as nga xhepi, as nga dora. Ti një gjë duhet ta thuash: kush është oligarku këtu? Ti ke thënë se është një oligark pas këtij koncesioni, nuk e kam thënë unë.

Sot ka tri njolla turpi, që bien mbi këtë qeverisje, sigurisht përveç të tjerave pa fund, për të cilat na kanë sharë, kanë shfryrë mllef, na kanë anatemuar, na kanë akuzuar, ndërkohë që sot po i vazhdojnë. Kush janë të korruptuarit këtu?

**Ermonela Felaj** - Faleminderit, zonja Tabaku!

Nuk ka replikë mbi replikë.  
(*Zhurme bilbili në sallë*)

Fjalën e ka zonja Ibrahimaj.  
(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Nëse fjala juaj do të jetë për procedurë, po.

**Erion Braçe** – Siç ka folur sot 4 orë e 28 minuta për procedurë, do të flas edhe unë.

Të përmendësh emra është kollaj. Meqë më janë bërë vite në këtë sallë parlamenti, tani nuk më ka mbetur gjë tjetër veçse t'ju referoj tek arkivat e Kuvendit që të gjeni emrin që e kam përmendur

këtu e 11 vjet më parë. Atij emri i qëndroj nga a-ja te zh-ja. Tani, ju që e zbuluat oligarkun pas 11 vjetëve, a mund më thoni se çfarë emri keni në mendje? Çfarë emri keni në mendje?

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Ju dëgjova me shumë vëmendje dhe thatë këtu se pas është një oligark. A ka mundësi ta thoni emrin e oligarkut?

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Braçe!

Fjalën e ka zonja Ibrahimaj.

Të përgatitet zoti Bujar Leskaj.

Ju lutem, mos i vazhdoni debatet me njëri-tjetrin nga vendi!

(*Zhurme bilbili në sallë*)

Kolegët që marrin fjalën kanë mundësi të kthejnë përgjigje për pretendimet e ngritura në lidhje me këtë kontratë koncesionare.

Zonja Ministre, keni fjalën.

**Delina Ibrahimaj** – Unë e mora fjalën për të thënë se nuk i heq asnjë presje të gjithë fjalimit që mbajti zoti Braçe. Ai tentoi ta sqarojë qartë çështjen e sigurisë juridike, por duket që ju nuk doni ta ushtroni ose nuk dini ta kuptoni.

Ju flisni dhe akuzoni vetveten, pasi thoni se nuk duhet të lejohen kontrata korruptive, kontrata që janë në dëm të popullit. Pikërisht, kjo është ajo çka ne po tentojmë të bëjmë. Ne po tentojmë t'ia rikthejmë qeverisë dhe qeverisjes të gjitha ato kontrata që ju keni nënshkruar në mënyrë korruptive në dëm të popullit. Nuk e di ku i gjeni ato qindra miliona euro të arbitrazheve, veçse në ëndrrat tuaja.

(*Zhurme bilbili në sallë*)

Kjo kontratë që ne sjellim sot synon të evitohet qindra miliona euro arbitrazh. Qëllimi ynë është të reduktojmë efektet në buxhetin e shtetit dhe t'u kthejmë shërbimet qytetarëve.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

(*Zhurme bilbili në sallë*)

Zoti Spaho, nuk më latë asnjë mundësi të bëj njëllë tolerance me ju, ndaj detyrohem që, konform nenit 65, pika 1 të Rregullores, t'i drejtohem Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën që, pasi nuk dolët nga seanca, sepse jeni përjashtuar, t'ju japë masën maksimale disiplinore, atë të përjashtimit për 10 ditë nga seanca.

Fjalën e ka zoti Leskaj.

**Bujar Leskaj** – Zonja drejtuese e seancës, politikisht dhe moralisht unë jam me kolegët e mi të foltores...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** – Zoti Leskaj, vijoni!

Tek e fundit, zoti Sula ka të drejtë, sepse një minimum etike ndaj njëri-tjetrit duhet. Megjithatë, secili zgjedh vetë...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Zoti Sula, ai është i përjashtuar nga seanca.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Zoti Spaho është i përjashtuar nga seanca.

Urdhëroni, zoti Leskaj!

**Bujar Leskaj** – Që në krye të herës më duhet të saktësoj që politikisht dhe moralisht unë jam me kolegët e mi që janë aty në foltore, jam në krah të zotit Spaho, të zotit Çelaj, të zonjave të nderuara dhe të gjithë deputetëve të tjerë të PD-së, që me të drejtë e mbajnë bllokuar atë foltore. Teknikisht nuk jam ngritur, por kjo nuk ka rëndësi.

Së dyti, mua më vjen keq, zonja drejtuese e seancës, që ju, Kryetarja e Kuvendit, për të cilën kam pasur respekt, dhe pjesa tjetër e mazhorancës, që është në Byronë Parlamentare keni një muaj që po e degradoni këtë Kuvend. Kjo është rrjedhojë e drejtimit tuaj të gabuar, kjo është rrjedhojë e shkeljes së Rregullores së Kuvendit, që ju keni një muaj që e bëni.

Konkretisht, ju keni shkelur nenin 97 të Rregullores së Kuvendit “Interpelanca për çështje urgjente”, nenin 90, nenin 91; ju keni shkelur nenin 46 “Diskutimet në seancë”, nenin 44 dhe shumë nene të tjera. Mbi të gjitha, sipas mendimit tim, ju në mënyrë flagrante, zonja drejtuese e seancës, shkelni Kodin e Etikës, konkretisht nenin 3 të tij “Parime të përgjithshme të etikës”, të cilat janë jo vetëm për deputetët, por edhe për ju, drejtuesit e Kuvendit: “Deputeti gjatë ushtrimit të mandatit duhet të udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, ndershmërisë, objektivitetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë”.

Më vjen keq, por gjatë këtij muaji ju nuk keni respektuar asnjë nga këto parime! Ky është shkak që ne nuk kemi pasur mundësi të diskutojmë ligjet.

Moralisht, unë nuk mund të flas për ligjin në fjalë, diskutimet dhe shpjegimet e mia i kam dhënë në Komisionin për Ekonominë dhe Financat. Tagencialisht dua të theksoj se ju, me këtë shtyrje që po i bëni kësaj marrëveshjeje në

fjalë, vazhdoni dhe e thelloni korrupsionin e filluar në vitin 2011. Asaj fature, prej 80 milionë eurosh, që biznesi ka paguar në këto vite, ju do t’i shtoni edhe 16 milionë euro të tjera.

Për sa u përket akuzave reciproke që u ngritën këtu, ju mund t’i bëni vetes një pyetje të thjeshtë: cila ishte arsyeja e rinegociimit të kësaj kontrate koncesionare? Cili është ai sesion që nuk i ka përmbushur kushtet? Nuk besoj se në këta 10 vjet ka qenë ndonjë parti tjetër në pushtet përveç partisë dhe sektit tuaj.

Së treti, unë e kam kërkuar fjalën që në fillim për procedurë, por këtu duhet të bërtasësh që të të jepet fjala për procedurë, por dua t’ju them një dy gjëra sinjifikative nga historia e lavdishme dhe kriminale e partisë suaj. Edhe Enver Hoxha, që ishte diktator, që i kishte të gjitha në një dorë të hekurt, kur ndodhi Konferenca e Tiranës, erdhi nga Vlora në Tiranë brenda natës dhe u fut në konferencë, ku u ktheu përgjigje, edhe pse më vonë i arrestoi, i anatemoi këta disidentët e vërtetë të asaj kohe, kështu po i quajmë.

Ju nga ’56-ta dhe deri më 2022-in nuk jeni çliruar ende dhe lideri juaj global nuk ka as guximin të vijë në seancë, jo ta limit datën 2 mars, por, në bazë të Rregullores së Kuvendit, ajo seancë duhej të zhvillohej për një apo dy javë.

Së dyti, kjo që do të them është më shumë për ta relaksuar seancën, jo se kam ndonjë gjë personale me ju, me Kryetaren e Kuvendit apo me të gjithë deputetët: mos e bëni veten që nesër populli të thotë për ju që folët si Naunka Bozo. Ku e ka kjo historinë? Historinë mund ta gjeni te libri për Kadri Hazbiun, i historianit Kastriot Dervishi, por edhe në medie, në procesverbalet e kohës...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Është histori e bukur, Erion, nuk kam gjë, përveç respektit.

Enver Hoxha, shërbëtorit të tij, ministrit që i kishte shërbyer nga ’43-shi deri më ’83-shin, Kadri Hazbiut, i lëshoi të gjithë shpurën e tij gjatë zhvillimeve të plenumit, të analizave në byro e të tjerë. Nuk po futem tek ajo, unë kam respekt për racën dhe fëmijët e Kadri Hazbiut, por gjithsesi ai mbetet ministri kriminel i diktaturës. Kur diktatori Enver Hoxha i lëshoi këta, që i kërkonin llogari, ndërmjet të tjerave, flet edhe Naunka Bozo dhe e akuzon Kadriun, që para tre vjetësh më ke thënë këtë e më ke thënë atë. Në një moment, i shkreti, në atë tension, në atë përplasje, se edhe po përplasej me Enver Hoxhën, edhe po i kalonin

ndër mend krimet që kishin bërë të dy së bashku, që të tre, bashkë edhe me Mehmet Shehun, por njëkohësisht mendonte edhe për fëmijët, ndaj ruante qetësinë, me mprehtësinë e labit, kur këta e akuzonin që, ja, shoqja Naunka foli, Kadriu i shkretë thotë: po Naunka foli si Naunka.

Kështu që, të gjithë ne deputetët, po bëj përgjithësim, sepse nuk e kam personale me ju apo me deputetët e Fierit e të Lushnjës, që i respektoj, por deputetët e të dy krahëve, të mos bëhemi që nesër, pas dhjetë vjetësh a njëzet vjetësh, kur të lexohen këto procesverbale, të thonë: X deputet, X deputete ose X drejtues foli si Naunka Bozo.

Ju faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Leskaj!

Unë nuk e kam jetuar as kohën e paraçlirimit, as të pasçlirimit, por juve, me sa duket, ju ka ngelur mendja tek Enver Hoxha, prandaj dhe nuk ndaheni dot nga foltorja.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Vazhdojmë me rendin e ditës.

Folësja e fundit e rendit të ditës është zonja Kryemadhi.

Zonja Kryemadhi, dëshironi të flisni? Po.

**Monika Kryemadhi** – Diçka doja të shtoja: duke pasur parasysh qeverinë socialiste, që është aty, nuk shoh asnjë socialist në atë qeveri, por shoh socialistë që janë gati të japin jetën për Edi Ramën dhe rrinë e duartrokasin për koncesionet dhe paratë që vjedh Edi Rama me shoqërinë e tij civile të famshme.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Kryemadhi!

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për projektin “Furnizimi me ujë i qytetit të Durrësit””.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Edhe këtu kemi të regjistruar disa kolegë.

Ndërkohë, ka pyetje nga kolegët për ministrin propozues, që sërish qëllon të jetë zonja Delina Ibrahimaj?

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Nuk ka pyetje. Fjalën e ka zonja Ibrahimaj.

*(Ndërhyrje nga salla)*

Atëherë, fjalën do ta ketë zëvendëskryeministrja, zonja Belinda Balluku.

Fjala për ju, zonja Belinda!

**Belinda Balluku** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Pavarësisht se marrëveshja lidhet, padyshim, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, bëhet fjalë për sektorin e ujit, kështu që prezantohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

I dashur Mondin, bjeri!

*(Ndërhyrje nga salla)*

E di, por bjeri. Ma dogji Braçe atë pyetjen, se kam gjithë ditën që dua ta di. Gjithë këta burra këtu, Isufi dy metra rri, të sheh dhe të buzëqesh. Këta të tjerët bëjnë sehir. Kanë ikur të gjithë në kafe. I kam ruajtur. Oerdi bën sikur shkon e karikon telefonin. Ikin të gjithë, shkojnë, vijnë. Ty, vetëm Elda të ka qëndruar sot.

Unë kam një pyetje: si i ndani detyrat tek partia juaj? Si i ndani?

*(Ndërhyrje nga salla)*

Isuf, merre bilbilin, se do nderosh Tropojën! Domethënë, si mund të rrih tani aty, të shohësh Mondin, i është nxirë buza, ka gjithë ditën. Më habit fare. Domethënë, dy metra burrë. Mondin, pse t'i lënë ty gjithmonë të gjitha detyrat e vështira?

*(Ndërhyrje nga salla)*

Megjithatë, pse t'i lënë ty gjithmonë këto detyra të tmerrshme dhe të vështira?

Të gjithë këta ikin. Ja, erdhi Oerdi! Oerdi ka gjithë ditën që shkon dhe bën sikur karikon telefonin, ndërkohë që ty të lë aty me bilbilin. Si i keni ndarë detyrat? Domethënë i keni ndarë në mënyrë shumë të çuditshme. Vetëm ti sakrifkohesh. Kjo ishte e para. Nuk ma thatë që nuk ma thatë se si i ndani detyrat. Megjithatë, Mondin, respekto për qëndresën!

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Tani, sa i përket...

*(Ndërhyrje nga salla)*

Kur të mbaroj, do ta marrësh, sepse ta dhashë mundësinë të flasësh.

**Ermonela Felaj** – Nuk mund të flasë dot, se është i përjashtuar nga salla.

**Belinda Balluku** – Epo mirë! Ah, është i përjashtuar!

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Për sa u përket koncesioneve, do të desha të sqaroja vetëm një koncesion që u përmend, koncesion i cili ka qenë i lidhur me Drejtorinë e Transportit Rrugor dhe ka qenë SGS-ja e famshme, në të vërtetë famëkeqe, që pasi vendosëm ta hiqnim nga koncesionari dhe t'ia kthenim shtetit, sot fitimi vjetor që ka qytetari shqiptar është 4.4 milionë euro. Pra, është dyfish më pak nga sa harxhonte çdo qytetar deri më sot, në saj të atij koncesioni.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Tani, sa i përket pjesës së koncesioneve, unë dua t'i kujtoj zonjës Tabaku që një nga koncesionet, që është përfolur dhe vazhdon të përfillet, sepse është dhënë deri në vitin 2048, është koncesioni i mallrave të përgjithshme në portin e Durrësit, i cili është dhënë në kohën tranzitore kur qeveria Berisha kishte humbur dhe stafeta po kalonte në qeverinë socialiste. Kështu që, koncesionet e qeverisë suaj janë njëra më korruptive se tjetra.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ajo që ne po bëjmë sot është se po i kthejmë ato shërbime, të cilat shteti mund t'i ofrojë tek administrata, për të ulur kostot, për të krijuar transparencë, ndaj unë nuk e di pse shqetësoheni kaq shumë se ç'ka ndodhur në vitin 2013, se ata të vitit 2013 nuk ju lënë as të flisni sot.

Për sa i përket marrëveshjes që do të bëhet midis Agjencisë Franceze të Zhvillimit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është një marrëveshje e rëndësishme në kuadër të reformës së sektorit të shërbimit me ujë të pijshëm. Prej kohësh është investuar në këtë sektor për të rritur parametrat cilësorë, për të arritur të furnizojmë Shqipërinë me 24 orë ujë përgjatë gjithë territorit, dhe sigurisht, çfarë është më e rëndësishme për ne, është të arrihet që shërbimi i Ujësllës-Kanalizimeve të arrijë të gjithë parametrat e Bashkimit Europian, për t'u ofruar ujë realisht të pijshëm qytetarëve tanë.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ndërhyrjet infrastrukturore që do të kryhen në kuadër të këtij procesi, do të garantojnë jo vetëm furnizimin e pandërprerë, ashtu siç ne e kemi bërë në pjesën më të madhe të qyteteve në Shqipëri, por do të garantojnë edhe përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm, që ne çojmë në rubinetet e qytetarëve tanë.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Në të njëjtën kohë, pjesë e objektivave të këtij projekti është dhe përmirësimi i performancës operacionale të shoqërisë së re të Ujësllës-Kanalizimeve, pas reformës së thellë që kemi bërë, duke agreguar 61 ndërmarrjet e ujësllës-kanalizimeve në vetëm 16 prej tyre. Pjesa më e madhe e këtyre kompanive, tashmë më shumë se 14, janë funksionale, duke krijuar kështu një eficiencë operacionale e financiare për të gjithë sektorin.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ndërkohë, sa i përket zonës së Durrësit, zona e Durrësit është zgjedhur që të vazhdojë dhe të ketë investime në sektorin e ujit të pijshëm, dhe të kanalizimeve padyshim, si një zonë e cila jo vetëm është një nga qytetet më të mëdha në Shqipëri, së bashku me rrethinat, por edhe për shkak se gjatë periudhës së sezonit turistik numri i vizitorëve në Durrës tejkalon me më shumë se dy herë numrin e banorëve permanentë.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Kështu që, Durrësi ka qenë dhe do të vazhdojë të mbetet në fokus të të gjitha investimeve të qeverisë shqiptare, sigurisht për sa u përket ujësllës-kanalizimeve, por dhe investimeve të tjera, ashtu siç është edhe rasti i dy projekteve strategjike që do të ndërtohen në qytetin e Durrësit: Porti i Jahteve dhe Ballina Ujore e Durrësit, si dhe porti i ri në Porto Romano, i cili do të jetë një port që do t'i shërbejë jo vetëm Shqipërisë, por edhe Maqedonisë së Veriut, edhe Kosovës, përmes dy porteve të thata: të Strugës dhe të Prishtinës.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Tani, nuk ka as bilbil dhe nuk ka as aparat telefonik nga ai që lëshon këtë sinjalin me ultratinguj, që nuk e di realisht se cili është synimi i këtij sinjali; mirë bilbili i Mondit se është bilbil heroik, por ky me telefonin që bën "bip", ku do të dalë? Por nuk ka asnjë bilbil dhe asnjë sinjal, i cili arrin të mbulojë dhe të fshehtë punët e kësaj qeverie. As balta që hidhni me gojë, as bilbilat dhe asgjë tjetër nuk na ndal, nuk na tremb dhe nuk na pengon.

Mondi qetësohu tani! Merr frymë!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Balluku!

Kanë kërkuar fjalën për procedurë zoti Bylykbashi dhe zoti Xhaferaj.

Zoti Bylykbashi, fjala për ju!

**Oerd Bylykbashi** – Tani unë dua të përdor mundësinë edhe për procedurë, edhe për replikë.

Sigurisht, në fillim dy fjalë për historinë e kësaj që ju po diskutoni sot. Ka qenë një projekt 84 milionë dollarë, që ka përfunduar tash dy vjet, me premtimin për 24 orë ujë, por paratë u vodhën dhe Durrësi nuk ka ujë.

Po kështu, do të jetë një histori ndarjeje. Ne kemi vetëm një detyrë për të bërë: të bëjmë të mundur që në këtë parlament të krijohen kushtet që t'i kërkojmë llogari qeverisë, Edi Ramës dhe të gjithë atyre ministrave atje, për vjedhjet që bëjnë dhe për faktin se e kanë shndërruar në sistem ndërkomëtar nivelin e korrupsionit, duke vazhduar të vjedhin e të pasurojnë asociatit e tyre. Këtë kemi për detyrë ne, nuk ndajmë detyra të tjera. ndërkohë, e dimë shumë mirë se ministrat, me Kryeministrin në krye, ndajnë llokat e pasurisë kombëtare, përfshirë Portin e Durrësit, përfshirë dhjetëra e qindra miliona euro, që nga buxheti i shtetit shkojnë në xhepat e klientëve të Kryeministrit. Sigurisht, kanë arritur deri aty, sa Edi Rama dhe ministrat e çojnë korrupsionin në nivele të tilla, sa mund të shkojnë të korruptojnë edhe Amerikën.

Tani, e fundit fare: kur në vitin 2016 konceptonim idenë e SPAK-ut, si Prokuroria e Posaçme, ministrja që foli është ekzakt prototipi i ministrit për të cilin është ngritur SPAK-u. Bashkë me atë që ne kërkojmë, heqjen e parashkrimit të ndjekjes penale për veprat e korrupsionit për ministrat, Kryeministrin e të tjerë, sigurisht një gjë duhet ta ketë të qartë: kjo histori do t'i shkojë gjatë nga pas, dhe si prototip që është në lidhje me këtë histori, do të jetë ekzakt për atë institucion që kemi ngritur, që ju sot e keni kapur, por që nesër nuk ka shans. Atë që ka menduar se mund të sillt në këtë formë, me këtë lloj cinizmi në parlament, pa pasur fare asnjë lloj konsiderate se si mund të masakrohen paratë e taksapaguesve me afëra korruptive, për një gjë e garantoj: SPAK-un dhe gjithë pjesën tjetër të drejtësisë do ta ketë mbas qafe, në mos sot, shumë shpejt.

**Ermonela Felaj** – Fjalën e ka zoti Xhaferraj, më pas ju.

Kështu është radha, ju lutem, kur është fjala për procedurë.

**Ferdinant Xhaferraj** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Në fakt, esenca e të gjithë debatit dhe e zhurmës së sotme ka të bëjë me faktin e shmangies dhe mosardhjes së Kryeministrit në Kuvend. Këtu nuk shtrohet çështja që Rama ka vendosur dhe i ka dalë llogaria që për skandalin madhor në lidhje me McGonigal të mos paraqitet në Kuvend, por çështja shtrohet te fryma që përhapet nga mosrespektimi nga anëtarët e qeverisë dhe zyrtarët e tjerë të shtetit të procedurave të Kuvendit, duke filluar që nga neni 1 i Kushtetutës, i cili saktëson se të gjitha pushtetet burojnë nga parlamenti.

E nderuara zonja drejtuese e seancës,

Para disa kohësh kam bërë një konferencë shtypi nga zyrat e Kuvendit, ku kam denoncuar faktin se ministrja e Jashtme, e thirrur nga shtatë deputetë të Komisionit të Sigurisë, nuk paraqitej në Kuvend. Kam vazhduar edhe më tej. Kam denoncuar faktin se ministri i Brendshëm, i thirrur nga Komisioni i Sigurisë, nuk paraqitej në Kuvend lidhur me procedurat e shkarkimit të drejtorit të atëhershëm të Policisë së Shtetit, zotit Gledis Nano.

Në fund të muajit janar kam thirrur...

*(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)*

Zonja Xhaçka, është punë letrash, nuk është punë fjalësh.

*(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)*

Është punë letrash.

Më 31 janar të këtij viti kam thirrur në Kuvend drejtorin e Përgjithshëm të Policisë lidhur me skandalin e kamerave...

**Ermonela Felaj** – Zoti Xhaferraj, të lutem, çfarë lidhje ka kjo kërkesë me procedurën?

**Ferdinant Xhaferraj** – Kjo kërkesë ka...

**Ermonela Felaj** – Unë zbatoj rendin e ditës, duke ndjekur listën e diskutantëve, dhe ju ndërhyini. Për çfarë ndërhyini?

**Ferdinant Xhaferraj** – Unë ndërhyj për faktin që...

**Ermonela Felaj** – Si ajo zonja e para tridhjetë vjetëve, që na përshkroi zoti Leskaj?! Nuk e kuptoj.

**Ferdinant Xhaferraj** – Po të më lësh ta çoj fjalën deri në fund...

**Ermonela Felaj** – Po nuk e kuptoj. Singërisht që nuk e kuptoj.

**Ferdinant Xhaferraj** – Po të më lësh të flas deri në fund...

**Ermonela Felaj** –Tani, po të keni kërkesë për vijimin, dakord, vazhdoni! Nëse jo, do t’jua ndërpres fjalën.

**Ferdinant Xhaferraj** – Unë nuk kam instrument tjetër për të denoncuar faktin që drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit kthen përgjigje me fjalët: “Unë do të vij në komision kur ta shoh vetë të arsyeshme.”. E kuptoni se ku ka degraduar shteti?! Zyrtarët e lartë dhe ministrat nuk arrijnë të kuptojnë se Kushtetuta saktëson fare qartë në nenin 1 dhe nenin 7 të saj që të gjitha pushtetet burojnë nga parlamenti. Prandaj, po e ngre këtë me qëllim, sepse jam duke përgatitur një dosje për t’i informuar të gjitha institucionet, që nga Zyra e Delegacionit të Bashkimit Europian, që është këtu, Brukselin, Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që janë të detyruar, sepse Departamenti i Shtetit bën një raport çdo vit, pasi në kushtet e anëtarësimit në Bashkimin Europian dhe hapjen e negociatave, një nga kriteret është kriteri politik. Kësisoj, kontrolli parlamentar është një dimension shumë i rëndësishëm. Këtë që po bëj këtu, po e bëj për evidencë, për të plotësuar dosjen e maskaradës që ju jeni duke prodhuar nëpërmjet faktit se qeveria dhe institucionet e tjera qeveritare i shmangen kontrollit parlamentar. E gjithë kjo e ka burimin këtu, se kur Kryeministri i arratiset Kuvendit, krijon një frymë që përhapet në të gjitha institucionet e tjera.

A u qartësove, zonja drejtuese e seancës?

**Ermonela Felaj** – Po, u qartësova, zoti Xhaferaj!

Mund t’ju them se Rregullorja nuk lë pa instrumente veprimi asnjë deputet, pra ju mund ta shfrytëzoni kohën për diskutim në secilën prej këtyre pikave të rendit të ditës, ose të shfrytëzoni kohën e diskutimeve të lira që të ngrini shqetësimin tuaj.

*(Deputeti Xhaferaj flet nga salla pa mikrofon.)*

A mund të vijojmë me rendin e ditës, ju lutem? Këtë përgjigje mos e prisni nga drejtuesi i seancës! Unë përgjigjem vetëm për rendin e ditës.

Zonja Kryemadhi e ka fjalën.

**Monika Kryemadhi** – Për punën e ujësjesit nuk kam çfarë të them, veçse të uroj që të mos jetë si inceneratorët. Në dijeninë time, ujësjesit e të gjitha bashkive të Shqipërisë kanë falimentuar dhe ai vendim që keni bërë për t’i unifikuar nën qeverinë shqiptare, është vetëm mbulim i miliarda eurove të vjedhura me tenderët

fiktivë të ujësjesit. Nuk më mbetet gjë tjetër vetëm t’i uroj gjithë qytetarët e Durrësit, por edhe të të gjithë Shqipërisë që të kenë ujë nëpër çezmat e tyre, ujë që edhe të pihet, siç thotë Kryeministri juaj i famshëm.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Kryemadhi!

Me diskutimin tuaj, mbyllet këtu kjo pikë e rendit të ditës për të kaluar në disa pika të tjera.

Zoti Balla kërkon fjalën për procedurë.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

**Taulant Balla** – Zonja drejtuese e seancës!

Me këto diskutime, Kuvendi i Shqipërisë e përmbylli seancën për çështjet që ishin planifikuar në rendin e ditës. Para së të kalojmë në seancën e posaçme, siç do ta quaja, ku votohet kërkesa e deputetëve të opozitës për shkarkimin e Kryetares së Kuvendit, do të kërkoja pesë minuta pushim, në mënyrë që të riparohet foltorja, sepse qoftë zonja Çupi, qoftë zonja Gjonaj, por, natyrshëm, edhe Kryetarja e Kuvendit kanë të drejtën e tyre që ta marrin fjalën në foltore. Është një seancë e posaçme, ku nuk ka kërkesa të tjera procedurale. Meqë Mondit është lodhur, të ketë edhe ai pesë minuta pushim për të pirë ujë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Balla!

Po e korrektoj edhe një herë fjalën: janë edhe dy folës nga opozita, zoti Dashnor Sula dhe zoti Dashamir Shehi.

Ndërkohë, e vlerësoj konform Rregullores kërkesën e zotit Balla, sipas nenit 52 të Rregullores, për ta ndërprerë seancën pesë minuta, që pastaj të vijojmë me diskutimet tuaja.

Faleminderit!

*(Pas pesë minutave pushim)*

**Dashnor Sula** – Keni bërë koncesione, meqë i përmendët ju! T’i çonit te drejtësia, t’i çonit te SPAK-u. Pse s’i çuat? Pse s’i çuat te drejtësia? Sigurisht, sepse kishit interesa dhe ishin të lidhura gjërat.

Tani le të shkojmë më tej. Po, moj zonjë, po ju them përsëri, është haptazi vjedhje e pastër, e kam thënë edhe një herë tjetër. Në lumin Shkumbin, në Vilë- Bashtovë janë investuar gjoja 1, 2 milionë euro për të mbajtur mbeturinat e lumit Shkumbin. Zero investim ka aty, dhe i rruat 1, 2 milionë euro. E njëjta gjë edhe në Budullë, 2, 2 milionë euro. Kush i mori 3, 3 milionë euro? I



morën ata që kishin inceneratorët, sepse e shikonin veten të fuqishëm dhe nuk pyesnin për shtet ligjor.

Vazhdojmë, meqë e keni merak punën e oligarkëve. Po ju them, zonja drejtues e seancës dhe ju kolegë të mazhorancës, a e morët vesh vendimin e fundit që mori Bashkimi European, i cili e riktheu përsëri Shqipërinë në listën e vendeve për monitorim për sa u përket politikave fiskale? Po, pra, është kthim mbrapa ky. Jemi ne dhe tetëmbëdhjetë vende të tjera. Po e dini ju, zotërinj të mazhorancës, se jemi i vetmi vend, bashkë me Turqinë, që gjendemi në listën gri të MONEYVAL-it për sa i përket pastrimit të parave? Kush i bën këto? I bëjmë ne, opozita, që s'kemi asnjë lloj mundësie? Sigurisht, i bëjnë oligarkët tuaj, klientët tuaj, ata që bëjnë trafikun e kokainës që vjen në Shqipëri, sepse nëse deri dje ka qenë vetëm trafiku i hashashit, sot është edhe i kokainës e i heroinës. Kjo është e vërteta.

Sa për merakun në lidhje me punën e oligarkëve, po zotëri, deri dje oligarkët i kishte mazhoranca jonë, ndërsa sot i keni ju. Kush e ka Kastratin sot përsëri? A e kishim ne deri dje?! E keni ju?! Dhe ju e dini fort mirë se çfarë ndodh përditë me firmat. Kush e ka Zamir Manen, o zotërinj, sepse keni akuzuar Ridvan Boden?! Ku është sot Ridvan Bode?! Është në Bankën e Shqipërisë, përsëri me ju. Ku është Zamir Mane?! Është oligarku juaj që përfiton koncesione, madje ka edhe përfaqësues në qeverinë tuaj. Ku është Salillari, ai që ndërtoi kulla pa leje?! Është pranë jush, vazhdon të përfitojë e të pasurohet përditë.

Ku është Bashkim Ulaj që ka marrë përsëri koncesione?! Atje në Bërxullë po bëhet nami, për 5 mijë lekë po u merr tokën fshatarëve! Për interesat që ju keni, meqë i kishit merak, folëm me emra, nuk kemi frikë t'i themi me emra ne! Jemi opozitë e shëndoshë, jo ajo që ka qenë dje bashkë me oligarkët. Ne që nuk kemi lidhje me ata oligarkë, do t'i themi!

Rruga që kemi nisur, është rrugë e vështirë, pa diskutim, por do të jetë një rrugë së cilës do t'ia dalim, sepse, të jeni të sigurt, halli nuk është yni, i pjesës së shëndoshë të Partisë Demokratike dhe i pjesës së shëndoshë të Partisë Socialiste, halli është i atyre të djeshmëve dhe i kupolës suaj sot, një hall i përbashkët, madje e përbashkët është edhe e gjithë strategjia me të cilën po e bëni këtë.

I latë pikërisht interpelancën dhe debatën me Kryeministrin në datën 2 mars, se në datën 3 mars

është vendimi i gjykatës. Gjithçka është e koordinuar.

Mund të bëni budallenj ndonjë andej nga rruga, por nuk i bëni dot budallenj të gjithë njerëzit, sepse ka edhe zëra ndryshe; ka edhe njerëz që nuk shantazhohen dot. Të jeni të sigurt që edhe këtu, mes deputetëve të parlamentit shqiptar, ka njerëz të nderuar. Ndjaj uroj dhe shpresoj që kolegët e mazhorancës, të cilët kanë integritet moral, të cilët janë njerëz të ndershëm, të ngrihen, sepse gjithçka ka një fund.

Unë i kam kaluar të 50-at, si shumë burra e zonja andej, dhe nuk kemi shumë kohë për të rikuperuar. Do të duhet të na vijë turp një ditë, kur ta shikojmë veten në pension e me bastun se çfarë kemi bërë për këtë vend!

Duhet të na vijë turp nga ata 750 mijë - 800 mijë shqiptarë, që ikën në këta 10 vjet!

Duhet të na vijë turp për këtë korrupsion të përditshëm!

Duhet të na vijë turp për atë Alda Klosin!

Duhet të na vijë turp për ata që vjedhin dhe pasurohen përditë!

Po ju them që, kur i intereson ta përmendë SPAK-un, sigurisht e përmend. Kur nuk i intereson ta përmendë SPAK-un, nuk e bën. Sigurisht, more, sigurisht, e vetmja rrugë që duhet të diskutojë ky vend është drejtësia; është SPAK-u që duhet ta shpëtojë këtë vend dhe ndërkombëtarët, asnjëri tjetër!

Politika nuk e ndryshon më këtë vend.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Sula!

Zoti Shehi, fjala është për ju.

**Dashmir Shehi** – Nuk do t'jua marr të 10 minutat, por do të them dy gjëra.

Njëherë ujësjellësi i Durrësit, meqë kemi detyrimin ta fillojmë diskutimin për këtë çështje, sigurisht, është një gjë shumë e rëndësishme, dhe unë nuk do të kisha asgjë kundër që t'i marrin këto para, por ato të shpenzohen atje ku duhet të shpenzohen, se, siç u tha edhe nga disa kolegë këtu, janë marrë një herë 20 milionë, janë marrë 80 milionë të tjerë, shtoj edhe 60 milionë...

Është e vërtetë që Durrësi ka 400 mijë banorë sot dhe besoj se tani me pallatet e arabëve do t'i shtohen edhe nja 20 mijë, kështu që duhet ujë, por, sigurisht, nja tri herë është thënë që Durrësi do t'i heqë depot nëpër tarraca, por nuk i ka hequr.

Shpresoj që kësaj radhe ky premtim të jetë me gjithë mend, që Durrësi, ashtu siç thotë edhe Kryeministri ynë i nderuar, do të jetë perla e Mesdheut, nuk ka perlë me depo uji, me bidonë uji në tarracë për turizmin. Ky është një shëmtim sot. Ndaj uroj që këto para të përdoren dhe të përdoren mirë për këtë punë, por kam të gjitha dyshimet e mia. Pse? Qëkur ka ardhur zoti Rama këtu, është shpallur një reformë për ujin, 10 vjet përpara (kush ka kujtesë dhe shkallë profesionalizmi, e mban mend) Ku është reforma për ujin? Ku është përmirësimi për ujin? Në asnjë vend. Uji është shkatërruar më tepër. Të gjitha sistemet e ujësjellësve janë me borxhe, më tepër sesa ishin më parë. Nuk prodhojnë asgjë, veçse propagandë. Ka shtuar me 2-3 mijë veta numrin e punonjësve, të cilët dalin nga mëngjesi në darkë për të mbledhur votat për Partinë Socialiste dhe ujësjellësi i Tiranës, ju e patë, ishte shembulli i kësaj pune: me gazetarë, me këngëtarë që paguhen me paratë e taksapaguesve.

Tani ka dalë se do t'i bashkojnë ujësjellësit. Uroj që ta kenë menduar mirë, pasi kam frikë që pas 3 vjetëve do të vijmë t'i ndajnë prapë, se gjoja ky është halli i menaxhimit. Nuk është dimensiononi halli i menaxhimit, është menaxhimi politik. Kjo shkatërron jo vetëm ujësjellësit, por ka shkatërruar gjysmën e ndërmarreve shtetërore, me KESH-in e me të gjitha. Ku ka futur duart shteti, i kemi sot të shkatërruara pikërisht nga menaxhimi politik.

Meqenëse tani çështja u bë politike, të kthehem 2 minuta te ky zotëria, që u bë më i famshmi, McGonigal.

Kjo përcjellje e parlamentit nuk është serioze, por, përtej sherreve, bilbilave, quaji sa të duash "kusuret e opozitës", ju, Kryesia e Kuvendit, ju, mazhoranca, keni për detyrë të mos e provokoni asnjëherë palë, të mos përzini asnjëri nga kjo sallë, sepse në këtë sallë në 30 vjet kemi parë skena, zhurmë, turbullira, por nuk kemi parë përjashtime masive si kësaj radhe. E për çfarë?! Për një temë që ia vlen të diskutohet, së pari, që ditën e parë kur ka ndodhur.

Respektim i parlamentit do të thotë që, ai që është Kryeministër i Shqipërisë, duhej të jepte llogari, duhej të jepte informacion këtu fillimisht.

E dyta, duhej të jepte llogari para shqiptarëve: "Jam përtej kësaj pune."

E treta, duhej të jepte llogari para medieve, por edhe para të huajve, sepse ka involvuar edhe

të huaj në këtë lloj historie korrupsioni, e cila është sa personale, aq edhe shtetërore.

E katërta, pasi pritëm dy javë, do të presim edhe dy javë të tjera. Ky zotëria mendon se do t'i vijmë informacione, do t'i vijmë lajme, duke e shtyrë këtë çështje në Amerikë. Do t'i vijmë lajme, por do t'i vijmë më të këqija sesa janë këto sot, sepse, duke pritur e duke u zgjatur, do të hapen gjithnjë e më tepër edhe letra të tjera atje, siç po e shikoni.

Prandaj unë do t'i ftoja edhe kolegët e opozitës, që janë shumicë, që, përtej detyrës që kanë, të kundërshtojnë, por unë po them të paktën të dyshojnë, sado që e kam thënë edhe një herë tjetër këtë gjë. Ore, nuk dyshoni ju që këtu ka një punë të pistë, se unë nuk mendoj që jeni të gjithë tuhafë?! Unë mendoj që ju të gjithë e kuptoni këtë punë, se, kur dilni atje te kafeneja, të gjithë e merrni vesh çfarë ka ndodhur, por të paktën, në qoftë se nuk keni kurajën të kundërshtoni, të keni kurajën të dyshoni dhe të kërkoni që dikush të vijë e të japë llogari për këtë çështje që mund të jetë më e pista në 30 vjetët e fundit!

Në Shqipëri kanë ndodhur lloj-lloj gjërash dhe jemi vararë me njëri-tjetrin, por kjo lloj historie, kështu, me spiunë, me hajdutë, nuk kishte ndodhur ndonjëherë, dhe është ushqyer nga vetë i pari i vendit.

Prandaj, kur flasim për këtë çështje, më duket i vogël edhe ujësjellësi i Durrësit, pavarësisht se po i merr edhe 60 milionë të tjerë, ama uroj që të paktën të bëjmë diçka!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Shehi!

Në fakt, edhe duke dëgjuar fjalën e zotit Sula, më duhet të përsërit: mund ta kishit bërë mocionin për debat, mund ta kishim zhvilluar atë edhe gjatë ditës së sotme, por kryetarët e grupeve parlamentare, të cilët Rregullorja i parasheh si njerëzit që duhet të merren vesh për kohën e debatit dhe ditën e mbajtjes së tij, nuk u mblodhën për ta bërë këtë gjë, edhe pse kjo ishte shpallur që prej datës 7.

Sigurisht, Kryeministri ishte i gatshëm për të ardhur që sot.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Javën tjetër ju doni të bëni mocion me debat, por Kryeministri do të jetë në vizitë zyrtare jashtë vendit. Madje, nëse nuk do të vinte, ju prapë do të thoshit: "Nuk po bëni mocion me debat, sepse Kryeministri nuk ka ardhur".

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Kështu, duke dashur të respektojmë edhe afatin maksimal që lejon Rregullorja, 30 ditë nga bërja e kërkesës, u propozua data 2 dhe u votua rregullisht data 2 mars, kur Kryeministri do të jetë këtu, jo thjesht se e kërkon ju, por për t'u dhënë përgjigje të gjithë zgjedhësve.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Zoti Manja, dëshironi ta merrni fjalën për diskutim?

**Ulsi Manja** – Në fakt, nuk e kërkoja fjalën për debat, sepse unë kam shumë respekt për kolegun Shehi, por dua të them dy fjalë për debatin që po bëhet për ujin dhe ujësjellësit.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Mirë, more vëlla, tani, se nuk po kuptoj një gjë: edhe ujin e paskemi vjedhur ne?! Këtu duhet thënë: po me ujin ç'patët?

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Tani, për shkak të detyrave politike që kam, unë kam qenë i deleguar në qarkun e Dibrës. Nëse ka një gjë, të cilën 32 vjet në Shqipëri ua kemi premtuar vazhdimisht shqiptarëve, ka qenë ujë 24 orë. Dhe sot flasim faktet, jo fjalët që thoni ju në këtë sallë.

Të gjitha bashkitë e qarkut të Dibrës kanë ujë 24 orë në 24.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Përsëri, për shkak të detyrave të mia politike, tani jam në qarkun e Lezhës.

Pse nuk flisni ju, deputetë të qarkut të Lezhës, sa orë ujë ka sot Kurbini?

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Sa orë ujë ka Lezha? Sa orë ujë ka Mirdita? Pse, ore, edhe me ujin do të bëni politikë?

Nëse ka një politikë, për të cilën kjo mazhorancë është krenare në këta 10 vjet qeverisjeje, është ajo për ujin. Fshatrat dhe bashkitë e Shqipërisë kanë shumë herë më tepër ujë sesa kishin, siç ka edhe bashki që kanë ujë 24 orë në 24.

Nëse doni të bëni politikë, merruni me gjëra të tjera, por jo me ujin dhe ujësjellësit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ajo që kemi bërë ne si qeveri në këto vite me ujësjellësit është revolucion, dhe të jeni të bindur për këtë gjë!

Tani nuk keni çfarë të thoni këtu, sepse ju kanë shteruar të gjitha kauzat dhe keni shkuar te bilbili.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Unë dua ta falënderoj kolegun Spaho për durimin dhe fabrikën e pashtershme të oksigjenit që ka pasur dhe uroj që më 2 mars ta marrë bilbilin dikush tjetër, i cili i ka mushkëritë më të forta!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, kolegë!

Mbyllet këtu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë te pika tjetër: kërkesa për shkarkimin e Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, zonjës Lindita Nikolla.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Në mbështetje të nenit 75 të Kushtetutës dhe nenit 114, pika 4, të Rregullores, dua t'ju sqaroj si më poshtë vijon: kërkesa është paraqitur nga një grup prej 28 deputetësh, që i përkasin Partisë Demokratike, dhe ka si objekt shkarkimin e Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, zonjës Lindita Nikolla.

Konform Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, nenit 114 të saj, kërkesa është diskutuar në Këshillin e Legjislacionit, i cili përbëhet nga përfaqësues të mazhorancës dhe përfaqësues të pakicës parlamentare.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Në përfundim të mbledhjeve që ka mbajtur Këshilli i Legjislacionit, janë hartuar dy raporte: një raport nga përfaqësuesit e pakicës në këtë këshill dhe një raport tjetër nga përfaqësuesit e shumicës në këtë këshill. Të dyja raportet i janë përcjellë rregullisht Kuvendit.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ju ftoj, kolegë, t'i ndiqni raportet me vëmendje përpara procesit të votimit.

Ndërkohë, zoti Alibeaj, kush do ta marrë fjalën nga ju për prezantimin e kërkesës dhe të raportit?

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

**Enkelejd Alibeaj** – Zonja drejtuese e seancës, siç jua kam bërë me dije edhe në mbledhjen e Këshillit të Legjislacionit, të gjithë këtë procedurë e keni bërë vetëm me shkelje, dhe po jua përmend ato.

Së pari, në mbledhjen e Këshillit, në momentin kur u përcaktua edhe relatori nga ana jonë, ditën tjetër ju vendosët ta përjashtoni atë. Kjo është shkelja e parë.

Së dyti, keni përjashtuar gjysmën e deputetëve të opozitës, siç duket për shkak të numrave.

Së treti, sapo bëtë një shkelje tjetër, sepse Rregullorja e thotë fare qartë se duhet të ketë një

raport. Pra, vetëm një raport është ai i cili votohet në seancën plenare.

Me përjashtimin që i bëtë relatorit nga ana jonë dhe pamundësinë për të arritur në një raport të vetëm, po vazhdoni me shkelje procedurale. Për këtë arsye, merrni masa t'i rikuperoni të gjitha shkeljet e procedurës, në mënyrë që edhe votimi të bëhet ashtu siç duhet dhe siç i përket këtij parlamenti.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Kështu që e keni mundësinë për ta rikuperuar në këtë moment.

**Ermonela Felaj** – Zoti Alibeaj, edhe një herë, jemi në zbatimin fjalë për fjalë të nenit 114 të Rregullores.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

U ra dakord për të pasur një raport, por neni 114 i Rregullores lejon edhe prezantimin e më shumë se një raporti, pra të dy raporteve.

Zoti Gazment Bardhi, të cilin ju e caktuat si relator, nuk ishte as në mbledhjen e parë të Këshillit të Legjislacionit dhe, për sa më rezulton, pa ndonjë arsye. Ju kërkuat që ai të ishte relator, e keni depozituar rregullisht raportin; raporti i është përcjellë Kuvendit të Shqipërisë.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Ju lutem, për kërkesën që keni bërë, dëshironi ta merrni fjalën për ta prezantuar, apo jo? Kjo është pyetja ime e parë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Enkelejd Alibeaj** – ...kërkesë që sapo ta bëra, si drejtuese e Kuvendit, sepse keni detyrimin kushtetues që sipas Rregullores të vendosni të gjithë parlamentin dhe secilin prej deputetëve të ushtrojë të drejtat e veta.

Unë jua bëra me dije që keni shkelur të drejtën e relatorit, sepse atë e përjashtuan.

Keni shkelur të drejtën e relatorit që, në bashkëpunim me relatorin tjetër, të arrinin në një raport të vetëm, i cili, sipas Rregullores, kërkohet të ketë vetëm një raport dhe jo shumë të tillë.

Së treti, keni përjashtuar gjysmën e Kuvendit. Ku është e drejta e deputetëve për të votuar për një çështje që i përket gjithsecilit?

Vendosni edhe një herë të drejtat e çdo deputeti për të marrë pjesë në këtë proces. E keni ju në dorë. Vendoseni këtë dhe pastaj të mund të zhvillohet në mënyrë të qetë dhe normale seanca.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Fjalën e ka kërkuar zoti Balla.

*(Deputeti Balla flet nga vendi pa mikrofon.)*

Ah, në rregull, mendova se kërkuat fjalën, sepse m'u shfaq edhe në ekran.

Unë po ju pyes, edhe një herë, zoti Alibeaj, po flas për kërkesën, pastaj për raportin: do ta prezantoni kërkesën, që e keni bërë vetë, drejtuar Kuvendit, apo jo?

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

**Enkelejd Alibeaj** – Edhe një herë, ajo se çfarë votohet në seancë është raporti, në njëjës...

**Ermonela Felaj** – Ju dëgjova, nuk ka nevojë ta përsërisni.

**Enkelejd Alibeaj** – ... dhe për ta përgatitur raportin, do të duhet që relatori të ketë të drejtën e tij...

**Ermonela Felaj** – Ju nuk dëshironi ta paraqisni kërkesën...

**Enkelejd Alibeaj** – Por ju e keni përjashtuar...

**Ermonela Felaj** – Po ju pyes edhe një herë, zoti Alibeaj...

Ju lutem, teknika, ndërpritjani fjalën zotit Alibeaj, se... Ka një pyetje, një përgjigje: nuk dëshironi ta paraqisni kërkesën.

Kush do ta paraqesë raportin në emrin tuaj?

Fjala është për ju.

**Enkelejd Alibeaj** – Edhe një herë, sipas Rregullores dhe sipas Kushtetutës, në rastin kur kërkohet një masë disiplinore ndaj njeriut që ulet në karrigen ku je ti, është fare e qartë që duhet të ketë një raport. Që të ketë një raport, duhet caktuar një relator. Ne e caktuam relatorin tonë, por ditën tjetër e përjashtuat dhe bashkë me të keni përjashtuar edhe gjysmën e opozitës. Ata kanë të drejtën e tyre që të marrin pjesë në seancë dhe të votojnë për Kryetarin e Kuvendit, për garantin e të drejtave të tyre në këtë seancë.

Kështu që, për sa kohë i keni shkelur të gjitha këto garanci bazike të Rregullores, po ju kërktoj proceduralisht të merrni masat që t'i jepet e drejta çdo deputeti të këtij parlamenti për të marrë pjesë në këtë proces.

Kaq e thjeshtë është.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Sjell në vëmendjen tuaj dhe të gjithë kolegëve deputetë paragrafin e tetë të nenit 14 të Rregullores "Këshilli për Legjislacionin".

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

"Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli i paraqet Kryetarin të Kuvendit dhe/ose komisionit

përgjegjës një raport, ku pasqyrohen të gjitha opinionet për çështjet. Kryetari i Kuvendit mund të autorizojë leximin e raportit në seancë plenare nga relatori ose nga relatorët, kur ka më shumë se një mendim” dhe qartazi kishte dy opinione për kërkesën e shkarkimit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, patjetër.

Unë do t'ia jap fjalën zonjës Gjonaj, e cila është relatores në Këshillin e Legjislacionit për përfaqësuesit e shumicës, që të flasë në mënyrë të përmbledhur për raportin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Etilda Gjonaj** – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

28 deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike i janë drejtuar Këshillit për Legjislacionin me kërkesën “Për shkarkimin e Kryetares së Kuvendit, zonjës Lindita Nikolla”.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Këshilli për Legjislacionin, në cilësinë e organit përgjegjës parlamentar, mori në shqyrtim këtë kërkesë.

Ndërkohë, në cilësinë e relatores dhe në emër të deputetëve të shumicës parlamentare, ju bëj me dije se është depozituar raporti në të cilin janë trajtuar në mënyrë shteruese të gjitha argumentet në analizë të aspekteve kushtetuese dhe ligjore. Raporti prej 21 faqesh u është shpërndarë të gjithë deputetëve, dhe unë do të ndalem vetëm në pjesën e konkluzioneve lidhur me shkëljet e pretenduara nga 28 deputetët e opozitës.

Bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 114, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, ku thuhet se: “Kërkesa duhet të jetë e motivuar dhe konkrete për shkaqet e parashikuara në Kushtetutë”, pavarësisht aspektit formal, kjo kërkesë rezulton se nuk është e bazuar në aspektin substancial.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Në një vështrim krahasues me të gjitha praktikën më të mira parlamentare të vendeve europiane, dhe jo vetëm, roli dhe përgjegjësia parësore e kryetarëve të parlamenteve dhe presidentëve të legjislativave, pavarësisht kulturës së veçantë politike dhe historike të çdo vendi është të mbikëqyrin dhe të rregullojnë debatin parlamentar gjatë seancave plenare.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Po njësoj si në Parlamentin Europian, ku vetë presidenti, kryetari i parlamentit, është përgjegjës për të garantuar respektimin e rregullores, duke i tërhequr vëmendjen çdo deputeti (zoti Spaho, dëgjoje, se është me rëndësi) që prish rendin apo përdor gjuhë fyese, t'i heqë të drejtën e fjalës deri në përjashtimin nga seanca çdo deputeti, i cili vijon me prishjen e rendit apo me fyerje, njëkohësisht të mbyllë edhe debatet.

Ashtu si edhe në praktikën e Gjykatës Europiane, që janë vendime të detyrueshme për t'u zbatuar, roli i Kryetarit të Kuvendit në organizimin dhe funksionimin e Kuvendit, me qëllim që të mbetet funksional dhe efektiv, është i pazëvendësueshëm.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Për këtë arsye, referuar edhe praktikave të vendeve të tjera, praktika e ndjekur nga Kryetarja e Kuvendit, zonja Nikolla, është konform standardeve të vendeve të tjera demokratike.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Nga të gjitha provat e administruara, rezultoi se seanca e datës 26 janar 2023 nuk mund të zhvillohej në kushte normale, për shkak të rrethimit të foltores nga disa deputetë të opozitës dhe krijimit nga ana e tyre të një situatë kaotike në sallë: deputetë të opozitës, duke folur me zë të lartë nga vendi, pa iu dhënë e drejta e fjalës dhe duke penguar edhe ministrat për të prezantuar projektligjet, në shkelje të parashikimeve ligjore të Rregullores së Kuvendit dhe parashikimeve ligjore të Kodit të Etikës, cenuan kështu rëndë zhvillimin normal të seancës.

Kryetarja e Kuvendit, në përmbushje të përgjegjësisë së saj në kuadër të veprimtarisë parlamentare, në përputhje me nenin 7 të Rregullores së Kuvendit, dhe procesin e votimit sipas rendit të ditës, vijoi normalisht me zhvillimin e votimit pas prezantimit të projektligjeve nga ministrat përgjegjës. Zbatimi i përgjegjësisë kushtetuese dhe ligjore nga ana e Kryetares së Kuvendit duhet të shikohet për sa i përket zbatimit në germë, por edhe në frymë të Kushtetutës dhe ligjit, duke e konsideruar të gjithë bazën ligjore një korpus, i cili nuk mund të merret i veçuar.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Neni 116 i Rregullores së Kuvendit i njeh Kryetares së Kuvendit kompetencën që, nëse gjatë zhvillimit të seancës plenare ngrihen pretendime lidhur me zbatimin dhe interpretimin

e Rregullores, të vendosë për pretendimin e ngritur (vendim i cili nuk është objekt diskutimi), duke i dhënë të drejtën Kryetares së Kuvendit në vendimmarrjen e saj për votimin e ligjeve. Pikërisht mbi bazën e këtij parashikimi, Kryetarja e Kuvendit ka vijuar votimin.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, vendimit të vitit 2016, mund të parashikohet që në raste ekstreme nuk kërkohet asnjë paralajmërim për deputetët që fyejnë dhe tregojnë mungesë etike. Në këtë kontekst, arsyetimi do të ishte se fjalimi apo sjellja qartazi abuzive e një deputeti anulon mbrojtjen e të drejtës së tij për lirinë e shprehjes apo, më keq akoma, mund të konsiderohet shpërdorim i detyrës. Siç mund të konstatohet me lehtësi, e drejta e shprehjes së deputetëve konkurron me parimin e funksionimit normal dhe efektiv të Kuvendit dhe sipas Kushtetutës.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Kryetarja e Kuvendit ka zbatuar me përpikëri të gjitha përgjegjësitë e saj kushtetuese dhe ligjore në drejtimin e seancës plenare. Kryerja e Kuvendit ka treguar frymën e bashkëpunimit dhe tolerancës në drejtimin e veprimtarisë parlamentare në tërësi, duke respektuar, më së pari, kolegët deputetë të opozitës dhe duke qëndruar mbi palët gjatë drejtimit të seancës. Kryetarja e Kuvendit gjatë drejtimit të seanceve plenare i është përmbajtur etikës dhe komunikimit të mirë edhe atëherë kur provokimet apo mungesa e etikës kanë qenë të padenja për misionin që ka deputeti në përfaqësimin e qytetarëve të vendit.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Kryetarja e Kuvendit ka respektuar të gjitha parashikimet kushtetuese dhe Rregulloren e Kuvendit në drejtimin e seancës të datës 26 janar 2023, duke e moderuar debatin pa cenim dhe shkelje të etikës, pavarësisht situatës së tensionuar të krijuar nga një grup deputetësh opozitarë.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Siç rezultojnë nga sa më sipër dhe i detajuar në raport, situata kaotike dhe e tensionuar, e krijuar me qëllim bllokimin e seancës, e ka çuar objektivistisht Kryetaren e Kuvendit në vijimin e procesit të votimit për të garantuar zbatimin e rendit të ditës. Në rolin thelbësor që ka Kuvendi në ushtrimin e funksionit të tij kushtetues primar, atë të ligjëbërjes, mosvotimi i projektligjeve dhe i vendimeve do të sillnin bllokim të

vendimmarrjes, duke shkaktuar kështu një impakt negativ të drejtpërdrejtë në veprimtarinë e fushave të ndryshme.

Duke garantuar funksionimin e Kuvendit, Kryetarja ka bërë të mundur sigurimin dhe respektimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Deputetët e opozitës me sjelljen e tyre kanë shkaktuar probleme në zhvillimin normal të seancës plenare dhe, pavarësisht masave të marra nga Kryetarja e Kuvendit, situata nuk është normalizuar për shkak të veprimeve të pandërprera nga disa deputetë. Sjelljet e disa deputetëve të opozitës, të cilat krijuan situata kaosi dhe mosvijimin e zhvillimit normal të seancës, shkelin integritetin dhe figurën e të mandatuarve dhe cenojnë imazhin e Kuvendit.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, ku parashikohet qartësisht se shmangia me dashje e detyrimit për të ushtruar të drejtat që burojnë nga statusi i të qenit deputet, për të debatuar dhe për të votuar ligjin në seancat e Kuvendit, është e barsvlershme me praktikën me bojkotit të punimeve të Kuvendit, si institucioni më i lartë, të gjitha faktet dhe provat që dëshmojnë për sjelljen e deputetëve të opozitës në seanca plenare, përfshirë edhe atë të datës 26 janar 2023, evidentojnë qartazi se konfliktet kanë shkaktuar pengim të funksionimit normal të seancës së Kuvendit.

Jam e keqardhur që kjo sjellje, e cila cenon në radhë të parë figurën e deputetit, por edhe institucionin e Kuvendit, është bërë e përsëritur!

Gjuha e ashpër, gjuha e urrejtjes, gjuha seksiste dhe dhuna verbale e kanë bërë të pamundur zhvillimin normal të një seance plenare. Është fyese për këdo që është në këtë sallë dhe për të gjithë shqiptarët që kërkojnë të marrin modelin më të mirë të përfaqësimit.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ne jemi këtu për të mbrojtur platformat tona politike, për të mbrojtur qytetarët dhe për të folur për interesat e tyre, por jo t'i zëvendësojmë këto me intimidim, fyerje, shpifje dhe cenim të njëritjetrit.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Në përfundim, bazuar në të gjithë analizën shteruese dhe ligjore mbi faktet, provat dhe shkeljet e pretenduara, në raportin tonë arrihet në konkluzionin se kërkesa nuk plotëson kushtin substancial që shkelja të jetë për shkaqe

kushtetuese. Kryetarja e Kuvendit, zonja Lindita Nikolla, nuk ka kryer asnjë shkelje të parashikuar në nenin 76 të Kushtetutës dhe as të Rregullores së Kuvendit, duke kryer çdo funksion në respektim të parashikimeve kushtetuese dhe atyre ligjore. Për këtë arsye, kërkojmë nga Kuvendi rrëzimin e kërkesës së 28 deputetëve për shkarkimin e Kryetares së Kuvendit dhe i sugjerojmë seancës ta hedhë në votim.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Gjonaj!

Neni 114 i Rregullores së Kuvendit parashikon një procedurë të qartë dhe strikte në rastin e kërkesës për shkarkimin e Kryetares së Kuvendit. Kryetarja e Kuvendit ka kërkuar të dëgjohet në seancë plenare dhe Kuvendi është i detyruar ta dëgjojë atë.

Fjala është për Kryetaren e Kuvendit.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Ju lutem, nuk ka procedurë, sepse kjo është një nga ato raste kur procedura është e përcaktuar shprehimisht dhe mos bëni sikur nuk e dini këtë gjë!

Zonja Nikolla, fjala është për ju.

Ju kujtoj edhe një herë, kolegë, që jemi të detyruar, për shkak të Rregullores, ta dëgjojmë zonjën Nikolla.

Juve ju dha fjala për ta bërë kërkesën, por nuk donit ta shfrytëzonit këtë mundësi; ju dha fjala për të lexuar raportin, por nuk deshët ta lexonit, kurse tani është radha të dëgjojmë zonjën Nikolla. Rregullorja thotë që, nëse Kryetarja kërkon të dëgjohet, ne jemi të detyruar ta dëgjojmë.

Kështu që, ju ftoj të dëgjojmë Kryetaren.

**Lindita Nikolla** – Të nderuar kolegë dhe kolege deputete,

Kam mirëpritur dhe i mbështes të gjitha instrumentet parlamentare që i shërbejnë zgjerimit të hapësirave të opozitës për ushtrimin e përgjegjësisë në Kuvendin e Shqipërisë. Gjithashtu, prita me qetësi edhe kërkesën e 28 deputetëve të opozitës për shkarkimin tim.

Do të dëshiroja ta filloja këtë fjalë timen duke cituar një prej kolegeve të nderuara në Konferencën e Kryetarëve, e cila ka vendosur firmën në këtë kërkesë: “E kam firmosur më tepër si një tërheqje vëmendjeje sesa si një dëshirë për të mos e parë në krye të parlamentit, sepse,

sikundër e thashë, po e përsëris me bindje dhe me koshiencë që është ndër njerëzit më të butë dhe më të mirë që mund ta drejtonin këtë parlament”.

Edhe unë, e dashur dhe e respektuar kolege, e lexoj këtë kërkesë si një tërheqje vëmendjeje për reflektim brenda vetes të të gjithëve, në mënyrë që unë dhe të gjithë ju, madje disa prej jush më shumë, të kontribuojmë që Kuvendi të mos jetë një arenë grindjesh, por një vend ku bëhet debati i fortë dhe me etikë të lartë.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Pasi u njoha me këtë kërkesë, edhe unë fillova të reflektoj, ktheva kokën pas për të parë ku kisha gabuar dhe më rezultoi se acarimet dhe konfliktet në Kuvend kanë ardhur jo për shkakun tim, jo rrallëherë edhe për shkak të mosmarrëveshjeve dhe grindjeve tuaja të brendshme. Prandaj, nuk e paragjykoj këtë kërkesë si një dobësi tuajën përballë trysnive dhe halleve të brendshme të partisë, por si një të drejtë tuajën në rrethanat ku ndodheni, prej emocioneve tuaja dhe për ambicinet tuaja. Ndonëse jo të gjithë e pranoni publikisht apo në konfidencë, në thellësi të vetes e ndieni se kjo kërkesë nuk është ajo që i duhet Kuvendit të Shqipërisë.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Edhe pse e prita me qetësi, nuk mund të mohoj se ndihem e prekur, madje e zhgënjyer nga kjo kërkesë juaja. Kësaj kërkesë i mungon themeli. Kërkesa ka një qëllim, por nuk ka një shkak. Ajo është ngritur nën presionin e kompleksit ndaj foltores, si dhe intimidimit prej të kompleksuarve prej foltores. Në emocionet, qëllimet e pasinqerta dhe ngutjen për t'ia rrëmbyer njeri-tjetrit kauzën e luftës kundër mazhorancës, shpikët një kauzë artificiale. Në këtë kërkesë është emri, por jo dëshira juaj, është firma, por jo ndërgjegjja juaj, është shtyrja e jashtme, por jo zëri juaj i brendshëm, janë emocionet, por jo bindja juaj. Ju e mbështesni kërkesën tuaj në interpretime, por jo në fakte. Ju mund të keni interpretimet tuaja, por jo faktet tuaja, sepse interpretimet mund të jenë individuale, të ndryshme e të ndryshueshme, kurse faktet janë një.

Edhe pse e nisëm bashkëpunimin, ju duke grisur fletët e votimit dhe unë duke bërë thirrje për urtësi e paqe, unë nuk do të tërhiqem nga misioni për t'i shtensionuar seancat plenare dhe për t'i vendosur ato në shinat e komunikimit etik e qytetar. Mënyra e sjelljes sime buron nga bindjet

dhe kultura ime, nga asnjë arsye pragmatike. Unë kështu vijova dhe kështu do të vijoj, pavarësisht kësaj kërkese, e cila jam e bindur që nuk do të dëmtojë bashkëpunimin tonë për të krijuar një mjedis parlamentar komunikues, etik dhe qytetar.

*(Zhurmë bilibili në sallë.)*

Unë preferoj një drejtim të Kuvendit me risqe, por besnike ndaj Kushtetutës dhe qytetarëve, sesa komoditetin personal dhe një paqe hipokrite në dëm të vendit dhe popullit tim.

Unë zbatoj Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, duke u veshur atyre një tis njerëzor e qytetar, si një ingredient i bashkëpunimit të sinqertë, për të cilin kam punuar e do të punoj bashkë me ju, kolege dhe kolegë të opozitës.

Me secilin prej jush, jashtë seancës plenare kemi pasur një urë komunikimi njerëzor dhe miqësor. Pse në seancë, në sy të qytetarëve, nuk jemi të njëjtët? Nuk po ju kërkoj të zbutim debatin, por të shmangim dhunën. Unë nuk kam folur e nuk do të flas kurrë me dy gjuhë; nuk kam shfaqur e nuk do të shfaq asnjëherë dy fytyra; nuk kam ndjekur e nuk do të ndjek kurrë dy politika, por me secilin dhe me të gjithë ju kam pasur e do të kem një gjuhë, një politikë, një fytyrë. Unë jam përballur e do të përballem sy më sy, sepse kam bindjen që komunikimi i drejtpërdrejtë është mënyra më e mirë për të bërë detyrat në Kuvendin e Shqipërisë dhe për t'u shërbyer qytetarëve.

Unë kam qenë pranë jush si kolege, si grua dhe si mike, në çdo rast gëzimi dhe vështirësie sa herë keni pasur nevojë për solidaritetin tim njerëzor. Përkatesia politike nuk më ka penguar dhe as do të shërbejë si barrierë për të respektuar secilin prej jush. Edhe pse disa nga ju në çaste rrëmbimi dhe humbjeje të drejtpeshimit parlamentar e njerëzor, e keni tepruar me gjuhën në adresën time, unë nuk do t'ju përgjigjem kurrë me të njëjtën monedhë (nuk dua të rendis fakte, sepse secili prej jush e ka të qartë, e di dhe në thellësi të vetëdijes e ndien dhe e pranon këtë që po them) dhe e tillë do të vijoj të jem, pavarësisht këtij episodi jo të lehtë, i cili, të paktën për sa më përket mua, nuk do të lejojë t'i helmatisë marrëdhëniet tona.

*(Zhurmë bilibili në sallë.)*

Zyra e Kryetares së Kuvendit ka qenë dhe do të mbetet e hapur për secilin prej jush. Unë bëj detyrën time kur me vetëpërmbajtje qëndroj mbi palët, ju dëgjoj e ju respektoj të gjithëve. Ju vërtet

mendoni se bëni detyrën tuaj me fjalët, gjestet, teprimet dhe shkeljet kaq të shpeshta?!

Me vetëdije, duke respektuar angazhimin që ditën që u zgjodha, jam e prirë të kem ndjeshmëri më të lartë për opozitën. Acarimet dhe teprimet në këtë sallë nuk pengojnë të dallohet kjo ndjeshmëri. Antagonizmi i fortë i opozitës, shpesh edhe duke kaluar limitet e etikës parlamentare, dhe kontradiktat e brendshme tuajat janë përplasur jo rrallëherë me detyrën time dhe ma kanë vështirësuar punën si Kryetare e Kuvendit, por nuk ma kanë errësuar gjykimin dhe nuk më dekurajojnë në përpjekjet e mia për t'ju mbështetur atëherë kur keni të drejtë dhe duke ju kundërshtuar atëherë kur gaboni, madje duke e tepruar në gabim. Në vullnetin tim për bashkëpunim unë kam qenë dhe do të jem e lirë, nuk jam intimiduar dhe nuk do të intimidohem kurrë, por as nuk do t'ju kërkoj llogari pse mjaft prej jush intimidohen. Thirrja ime për sinqeritet dhe bashkëpunim mbetet konstante dhe e pakushtëzuar.

Unë kam të drejtë të pyes: besoni vërtet se Kryetarja e Kuvendit nuk dëshiron vijimin normal të punës së Kuvendit? Jam e bindur se në thellësi të vetëdijes suaj secili përgjigjet: jo. Unë e kam ngritur me zë të lartë shqetësimin tim parlamentar, politik, njerëzor e qytetar, që në Kuvendin e Shqipërisë të mbizotërojë arsyeja dhe jo forca, etika dhe jo vulgariteti, debati dhe jo kërcënimet, faktet dhe jo interpretimet, argumentet dhe jo papërgjegjshmëria.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Shqetësimin tim konstant për gjuhën jo etike dhe mjetet ekstraligjore të përdorura në seancat plenare të Kuvendit, jua bëra prezent edhe në letrën që i dërgova secilit prej jush në mbyllje të sesionit parlamentar, duke kërkuar për këtë edhe bashkëpunimin tuaj, por në vend të reagimit për normalizimin e situatës në seancat plenare, ju vazhduat me tensionimin e situatës në Kuvend. Për më tepër, përpjekjeve të mia për të garantuar funksionimin e Kuvendit dhe kryerjen e detyrave si ligjvënës, iu përgjigjet me kërkesën për shkarkim. Edhe pse një sentencë filozofike thotë "pas kësaj, nuk do të thotë për shkak të kësaj", është pak e çuditshme që kërkesa juaj, të dashura kolege e kolegë të opozitës, vjen pa u tharë ende boja e letrës që ju dërgova.

Çfarë shkruaja në atë letër?! Po citoj dy fjalitë e fundit: "Liria e fjalës është dhe do të



mbetet thelbi i demokracisë. Që kjo liri të mos cenohet kurrë, fjala duhet të udhëtojë gjithmonë krahas faktit, akuza krahas përgjegjësisë”. Më poshtë, me modesti ju sillja në vëmendje maksimën e Papa Françeskut: “Moskontrolli i fjalëve të këqija sjell edhe moskontrollin e ndjenjave dhe shkakton një ndotje shumë më të madhe se ndotja e mjedisit”.

*(Zhurmë bilibili në sallë)*

Unë nuk jam kundër debatit, por besoj se secili prej jush brenda vetes e ndien përgjegjësinë për një debat të fortë dhe etik, pavarësisht se disa rrethana jashtë vetes suaj ju pengojnë për këtë. Prandaj ju bëj thirrje të sqartë: mos lejoni asnjë rrethanë dhe asnjë motiv që t’ju shtyjnë drejt perceptimit publik të asaj që ju nuk jeni në të vërtetë!

Ne nuk jemi armiq. Armiku në Kuvend nuk është as opozita, as mazhoranca, as ju, as unë, as qeveria. Në fakt, në këtë sallë është dikush që fjalën “armik” për kundërshtar politik e përdor më shumë se fjalën Shqipëri, që fjalët “përdhosje dhe minim i demokracisë dhe parlamentarizmit”, të cilat ju m’i adresoni mua, i ka merituar prej përfaqësuesve të demokracive më të shëndetshme të globit. Prandaj, ju them se kërkesa juaj nuk është thjesht një ironi, as një manovër parlamentare, por është ikje nga kauzat e vërteta që i shërbejnë Shqipërisë dhe shpikje e kauzave artificiale që u shërbejnë atyre me të cilët ju jeni në rivalitet. Në vend që të kontribuoni në vlerat perëndimore dhe euroatlantike të Partisë Demokratike dhe që shqiptarëve t’u fshihen nga kujtesa pamjet e shëmtuara të janarit të vitit të kaluar, për të cilat edhe unë ndiej dhimbje, ju, me dashje ose pa dashje, me kërkesën tuaj legjitimoni përpjekjet që këto pamje të transferohen në Kuvendin e Shqipërisë. Në vend që të shpëtoni shtëpinë e demokratëve, ju po rrezikoni shtëpinë e të gjithë shqiptarëve. Është detyra ime ta mbroj atë!

Nuk është hera e parë gjatë kësaj legjislature që agjendat e grupeve brenda Partisë Demokratike bëjnë presion mbi veprimtarinë e Kuvendit, duke synuar devijimin e tij prej funksioneve që përcakton Kushtetuta. Ajo foltore që kërkoni të rrethoni, nuk është as imja, as juaja, por është e Kuvendit të Shqipërisë dhe e të gjithë shqiptarëve. Presioni dhe lufta brenda jush për t’u treguar të fortë dhe kush e kush e ka më shumë armike mazhorancën, po lind një vatër tiranike

dhe anarkiste në Kuvendin e Shqipërisë. Nuk bëheni më të fortë duke kopjuar praktikën e dhunës! Përdorni forcën e arsyes, në vend të arsyes së forcës! Nuk e keni idenë sa ligësht ndihem dhe sa më dhemb shpirti kur Kuvendi i Shqipërisë shfaqet e perceptohet jo si një tempull, por si një bezdi për publikun dhe qytetarët. Kuvendin duhet ta bëjmë një pasuri publike, jo një problem për publikun. Kjo fillon nga unë dhe nga secili prej nesh, sepse guri kilometrik i demokracisë parlamentare është një trupë deputetësh të përgjegjshëm.

Për një mendje të ftohtë dhe pa emocionet që po përjetoni, është e vështirë të kuptohet shkelja nga Kryetarja e Kuvendit e Rregullores, e procedurave parlamentare dhe e të drejtave të opozitës. Unë i kam shumë të qarta kompetencat e mia si Kryetare e Kuvendit. Si e para mes të barabartëve, as jap dhe as heq të drejta. Të drejtat tuaja, ashtu si edhe të drejtat dhe detyrat e mia, kanë të njëjtat burime: Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit.

Menaxhimi i seancës plenare është një përgjegjësi e madhe, të cilën Kryetarja e Kuvendit e ushtron në kushtet e kompetencave të limituara dhe në bashkëveprim me deputetët. Edhe pse as vetë ju nuk besoni në atë për të cilën akuzoni Kryetaren e Kuvendit, në emër të përgjegjësisë dhe moralit tim politik, parlamentar e qytetar, po ju provoj se gjatë seancës plenare të datës 26 janar i kam ushtruar me përgjegjësi dhe mbështetur në Rregullore detyrat dhe kompetencat e Kryetares së Kuvendit.

Unë, nëpërmjet shërbimeve të Kuvendit, e pranova kërkesën për interpelancë, e parashtrova në Konferencën e Kryetarëve, e përfshimë në kalendarin e punimeve, e solla në seancë plenare, e përfshiva në rendin e ditës, u regjistruan deputetët që dëshironin të diskutonin dhe vijova normalisht me hapjen dhe zhvillimin e seancës. Në asnjë nga veprimet e mësipërme nuk u bëra unë shkak për mosushtrimin e të drejtës së deputetëve për të folur. Deri këtu shkojnë përgjegjësitë e mia si Kryetare e Kuvendit. Unë kam përgjegjësi individuale deri në fillimin e seancës, kurse pas fillimit të seancës nis edhe përgjegjësia juaj. Për zhvillimin e saj, detyrat janë të përbashkëta. Pra, nuk ishte as vullneti dhe as qëllimi im, por ishte plani juaj për t’i penguar dhe për t’i dështuar punimet e seancës. Me përpjekjet për t’iu imponuar me forcë mazhorancës dhe

Kryetares së Kuvendit, e vutë seancën në vështirësi dhe mua si drejtuese të saj në pozicionin që duhet të zgjidhja: ose seanca të mos zhvillohej fare, ose të zhvillohej ajo për të miratuar aktin normativ për nevoja dhe në mbështetje të qytetarëve.

Kurrë mos t'ju shkojë ndërmend se unë do të pajtohem me një situatë ku ju si deputetë të opozitës të përpiqeni të shkatërroni procesin parlamentar dhe unë të bëj sehir. Nëse ju i keni vënë vetes këtë qëllim, sepse kështu mjegullohen para qytetarëve hallet tuaja të brendshme partiake, unë i qëndroj besnike betimit tim për të mbrojtur Kushtetutën dhe integritetin e Kuvendit të Shqipërisë. Është detyra ime të ndaloj me të gjitha format që më njeh Kushtetuta, Rregullorja e Kuvendit dhe praktikat parlamentare, që konfliktet partiake të mos e helmatisin agjendën e Kuvendit. Opozita mund dhe duhet ta kontrollojë, por nuk mund t'i diktojë shumicës vullnetet e saj. Duam, s'duam, na pëlqen, s'na pëlqen, demokracia funksionon si e drejtë e shumicës për të marrë vendime dhe e drejtë e opozitës për ta kontrolluar këtë shumicë me instrumente parlamentare e demokratike dhe jo me dhunë dhe pushtimin e foltores.

Dëshironi të bëheni shumicë?! Bëni durim, përgatituni, prisni dhe respektoni verdiktin e popullit. Qytetarët dhe zgjedhësit janë depozita më e sigurt e qeverisjes në një shoqëri demokratike. Nëse shkelja e ligjeve, Rregullores dhe procedurave parlamentare nuk ndëshkohet dhe pakica imponohet jo me forcën e arsyes, por me arsyen e forcës, ky është fundi i demokracisë. Pas kësaj vjen anarkia.

Partitë politike, nëse dëshirojnë të shërbejnë si motorë të zhvillimit të Shqipërisë, nuk duhet të lejojnë që ambicjet individuale të uzurpojnë partitë, jetën politike dhe institucionet e këtij vendi. Detyra ime kushtetuese, parlamentare dhe kombëtare është që në Kuvendin e Shqipërisë të mos e lejoj këtë uzurpim. Në Kuvend, opozita dhe deputetët nuk kanë vetëm të drejta, por kanë edhe detyra dhe detyra numër 1 është të mbrojmë Kushtetutën, të zbatojmë Rregulloren dhe të ruajmë integritetin e Kuvendit të Shqipërisë.

Shumica e dështimeve të klasës politike shqiptare janë shkaktuar prej kokëfortësisë për të justifikuar gabimet dhe për të legjitimuar fajet. Kulturës së pandëshkueshmërisë duhet t'i japim fund, në radhë të parë këtu, në Kuvendin e

Shqipërisë. Pandëshkueshmëria nuk është vetëm një fakt penal, por edhe papërgjegjshmëri institucionale.

Gjatë të gjitha sesioneve të kësaj legjislature, keni pasur akses të plotë për të përdorur të gjitha mjetet kushtetuese për ushtrimin e përgjegjësisë tuaja në Kuvend, në seancat plenare dhe veprimtaritë e tjera parlamentare. Gjatë seancave keni pasur po aq akses sa mazhoranca, në disa raste edhe më tepër, për të ushtruar të drejtat dhe detyrimet tuaja. Në sesionin e kaluar keni përdorur dyfishin e kohës, krahasuar me shumicën për të diskutuar, për të pyetur, për të anatemuar e për të akuzuar qoftë pa fakte dhe argumente. Unë nuk e mohoj se midis deputetëve të opozitave këtu në Kuvend ka mjaft kolege dhe kolegë që vendosin arsyen para dhunës dhe Shqipërinë para strukturës së ambicieve të tyre, por të jesh i mirë nuk mjafton. E keqja triumfon nëse njerëzit e mirë nuk bëjnë asgjë për ta penguar atë.

Së fundi, unë nuk jam këtu t'i lutem njeriu. Votoni ashtu siç jua dikton morali dhe ndërgjegjja juaj, sepse në diskutim nuk është mandati im, në diskutim është çështja nëse Kuvendi i Shqipërisë do të zgjidhë problemet e qytetarëve apo do të jetë një problem i shtuar për ta.

Unë kam dhënë prova se jam për të parën. Ju duhet të provoni për cilën alternativë jeni.

Faleminderit!

*(Duartrokkitje)*

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Këtu mbyllen diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës.

Përpara se të kalojmë në dy pikat e tjera të rendit të ditës, dua t'i sjell në vëmendje Sekretariatit për Etikën, Procedurat dhe Votimin zbatimin e paragrafit të tretë të nenit 65/1 për zotën Edmond Spaho. Në këtë paragraf thuhet shprehimisht: "Në rast se deputeti ndaj të cilit është marrë masa e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, pra përjashtimi nga mbledhjet e komisioneve dhe seanca plenare deri në 10 ditë dhe ai sërish refuzon të dalë nga salla, afati i masës disiplinore dyfishohet".

I lutem Sekretariatit ta mbajë parasysh këtë!

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ndërkohë, i tërheq vërejtje zonjës Elda Hoti dhe, meqenëse vazhdon të qëndrojë në foltore, në

bazë të nenit 64/2 i heq të drejtën e fjalës. Në bazë të nenit 65, për vijimësi të së njëjtës sjellje, kërkoj përjashtimin e saj nga seanca plenare dhe nga çdo mbledhje e komisioneve parlamentare.

I jap vërejtje zonjës Sorina Koti, sipas nenit 63 të Rregullores. Meqenëse zonja Koti vijon të qëndrojë në foltore, duke e mbajtur të zaptuar foltoren, i jap vërejtje. Meqenëse vazhdon sërish i heq të drejtën e fjalës dhe meqenëse vazhdon sërish, kërkoj përjashtimin e saj nga çdo mbledhje e komisioneve parlamentare dhe nga seanca.

Nëse ju nuk e vutë re, gjatë gjithë kohës që Kryetarja e Kuvendit ishte duke mbajtur fjalën e saj, të dyja zonjat vazhduan ta mbanin të zaptuar foltoren e Kuvendit, përveç se që nga mëngjesi janë duke e bllokuar foltoren.

*(Zhurmë bilbili në sallë.)*

Në rendin e ditës janë edhe dy projektvendime: projektvendimi “Mbi propozimin për punonjësit me kohë jo të plotë pune pranë KQZ-së për procesin e pilotimit të numërimit dhe të votimit elektronik në zgjedhjet për organet e qeverisje vendore të datës 14 maj 2023” dhe projektvendimi “Për ndryshime në strukturën organizative të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”. Këto projektvendime janë pa diskutim, kolegë.

Këtu mbyllet debati për çështjet e sotme.

Ju lutem, të bëhemi gati për votim!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Rendi i ditës u mbyll.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kur të fillojë votimi, patjetër.

Bëhemi gati për votim!

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ju dëgjoj. Po kërkonti fjalën për procedurë.

Qetësohuni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Alibeaj ka kërkuar fjalën për procedurë.

**Enkelejd Alibeaj** – Faleminderit, zonjë!

Që ke qenë prokurorë, e di, por që të veprosi si prokurorët e komunizmit, që pushkaton gjithë deputetët, ky është kulmi që ke arritur ti!

E kuptova edhe mallëngjimin e zonjës Nikolla, që është ulur aty. Por a e di cili është shkaku i vërtetë? Është ai atje.

Po, ti je.

Meqë ke ardhur të bëjmë interpelancë, se u bë një muaj që je fshehur sa andej-këtej. Të kam bërë një kërkesë për interpelancë. U bë një muaj që të kërkojmë dhe nuk të gjejmë.

Zonja Nikolla, zonja Felaj, njëra prej jush, meqë ka ardhur Kryeministri, të vijojë me interpelancën urgjente që kam kërkuar me zotën Kryeministër.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

**Ermonela Felaj** – Zoti Alibeaj, keni kërkesë procedurale për votimin?

**Enkelejd Alibeaj** – Kjo është kërkesë procedurale. Është ky shkaku...

**Ermonela Felaj** – Për kërkesën procedurale keni të drejtë ta merrni fjalën, jo për gjë tjetër.

**Enkelejd Alibeaj** – Po, pra, kërkesa procedurale është: meqë Kryeministri, më në fund, e gjeti rrugën e parlamentit dhe erdhi, nuk e di pse, nga se u shty, të vijojmë me interpelancën dhe të japë shpjegime. Pyetje kam për të bërë unë, asgjë më shumë. Të japë shpjegime ndaj Kuvendit, të japë shpjegime ndaj shqiptarëve. Ai është shkaku pse ndodhi gjithë kjo tollovi. Meqë Kryeministri ka ardhur në seancë, le të vazhdojmë me interpelancën, me pyetjet për çështjen kryesore Rama – McGonigal. Kaq e thjeshtë është.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

**Enkelejd Alibeaj** – A mundet ta bëjmë këtë?

**Ermonela Felaj** – Nuk dëgjova kërkesë për procedurë. E vetmja kërkesë për procedurë që mund të bëhet në këtë rast, duhet të kishte lidhje me votimin, sepse jemi pikërisht në pikën e votimit.

Ka kërkesë tjetër procedurale për votimin, jo të përsëritur?

Zonja Tabaku.

**Jorida Tabaku** – Zonja drejtuese e seancës, unë e kuptoj zonjën Nikolla, që me të drejtë është e emocionuar, sepse kërkesa për shkarkimin e një Kryetari Kuvendi nuk është gjë e vogël, por edhe këtë procedurë, ju po e ndiqni në shkelje të Rregullores. Në qoftë se vazhdoni në shkelje të Rregullores, dëgjoni vetëm njëherë palën dhe nuk dëgjoni palën tjetër, atëherë opozita nuk do të marrë pjesë në votim. Në qoftë se ndodhemi sot në këtë pikë, është sepse u shkel Rregullorja dhe nuk u dha hapësirë për të diskutuar dhe për të bërë debat.

Zonja Nikolla, në të gjithë të drejtën e saj, ka mbrojtur mazhorancën. Nuk është faji i saj që mbron mazhorancën. Faji është pse përdoret Kuvendi dhe shkelet Rregullorja me të dyja këmbët për të mbrojtur mazhorancën. Edhe këtë

kërkesë procedurale, ju po e bëni në shkelje. Votimi duhet të ndodhë pasi të lexohen të dyja raportet. Njëri nga raportet këtu nuk është lexuar. Ju dështuat që të kishit një raport të përbashkët për vendimin e Komisionit të Etikës. Lejoni që të dëgjohen të dyja palët. Unë besoj se është në interesin e të gjithëve që parlamentit t'i kthehet funksionaliteti. Ju nuk mund të përjashtoni një deputet në çdo moment, sa herë që ju kërkon fjalën.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

**Ermonela Felaj** – Zonjë, ju lutem!

**Jorida Tabaku** – Zonja Felaj, ta përfundoj.

**Ermonela Felaj** – Jeni në gjendje të formuloni një kërkesë procedurale që lidhet me këtë moment, me votimin?

**Jorida Tabaku** – Po.

**Ermonela Felaj** – Cila është kërkesa juaj procedurale?

**Jorida Tabaku** – Dëgjoni raportet e të dyja palëve.

**Ermonela Felaj** – Këtë po pres të dëgjoj.

**Jorida Tabaku** – Dëgjoni raportet e të dyja palëve.

**Ermonela Felaj** – Ajo pikë e rendit të ditës u diskua dhe u mbyll, zonjë.

**Jorida Tabaku** – Dëgjoni raportet e të dyja palëve. Jeni përsëri në shkelje.

**Ermonela Felaj** – Kemi kaluar në procesin e votimit dhe unë u kërkova kolegëve që të bëhen gati për votim.

**Jorida Tabaku** – Procesi i votimit është...

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

**Ermonela Felaj** – Ju ndërpres fjalën, pasi nuk keni një kërkesë të tillë.

Kalojmë në procesin e votimit.

Hapet votimi për prezencën.

Ju lutem, kolegë, votoni të gjithë për prezencën!

Mbyllet votimi për prezencën.

79 deputetë janë prezentë; të pranishëm që nuk kanë votuar janë 47 deputetë.

Fillojmë votimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar””. Ju kujtoj, kolegë, që ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Procedura e votimit është dy votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë. Kush është dakord me projektligjin “Për disa ndryshime

në ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar””?

Ju lutem, kolegë, vijoni votimin! Kush është kundër? Abstenim?

Atëherë, në përfundim të procesit të votimit rezultati është 77 vota pro, 1 kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektligji.

Kalojmë në votimin nën për nen me kartonë sipas variantit të propozuesit. Kush është dakord me nenin 1 të projektligjit? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 2.

Kush është dakord me nenin 3? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 3.

Kush është dakord me nenin 4? Pro? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 4.

*(Nga neni 5 deri në nenin 19 ndiqet e njëjta procedurë votimi.)*

Kalojmë në votimin në tërësi të projektit. Kolegë, votohet me elektronikë.

Mbasi të gjithë kolegët kanë votuar, rezultati i votimit është 76 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet ky projektligj.

Kalojmë në votimin e pikës së dytë të rendit të ditës: projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Finlandës për eliminimin e tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin e shmangien e evazionit tatimor”.

*(Zhurmë bilbili në sallë)*

Ju lutem, kolegë, të mbajmë qetësi!

*(Debate dhe diskutime pa mikrofon në sallë)*

Ju lutem, kolegë, kalojmë në procesin e votimit!

Kush është dakord në parim me këtë ratifikim marrëveshjeje?

Ju lutem, kolegë, mos u shkëpusni nga votimi.

Kundër? Abstenim? Atëherë, rezultati i votimit është 79 vota pro, 2 kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Finlandës për eliminimin e tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin e shmangien e evazionit tatimor”.

*(Zhurmë bilbili në sallë.)*

Kalojmë në votimin nen për nen me kartonë. Kush është dakord me nenin 1? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 1.

Kush është dakord me nenin 2? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 2.

Kalojmë në votimin në tërësi të këtij projektligji. Votohet me elektronikë. kolegë.

Ju lutem, ndiqni votimin!

Rezultati i votimit është 79 vota pro, 1 kundër, asnjë abstenim.

Miratohet edhe projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Finlandës për eliminimin e tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin e shmangien e evazionit tatimor”.

Kalojmë në votimin e pikës së tretë të rendit të ditës: projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (huamarrësi) dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim (huadhënësi) për financimin e projektit "Furnizimi me ujë i qytetit të Durrësit”.

*(Debate dhe diskutime pa mikrofon në sallë)*

Kolegë, ju ftoj në votim. Votohet në parim; votimi është elektronik.

Ju lutem, teknika, hapni votimin!

75 vota pro, 1 kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohet në parim edhe ky projektligj.

Kalojmë në votimin nen për nen me kartonë.

Kolegë, kush është dakord me nenin 1? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 1 i këtij projektligji.

Kush është dakord me nenin 2? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet edhe neni 2 i këtij projektligji. E kryem edhe miratimin nen për nen.

Kalojmë në votimin në tërësi të këtij projektligji. Votohet me elektronikë, me shumicë të thjeshtë.

75 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohet edhe ky projektligj.

Kalojmë në votimin e pikës tjetër të rendit të ditës: projektligji “Për miratimin e kontratës shtesë për ndryshimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si autoritet kontraktues dhe shoqërive "Sicpa Security Solutions" s.a. e "Sicpa Security Solutions Albania" sh.p.k. për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave, miratuar me ligjin nr. 10 381, datë 24.02.2011”.

Votojmë në parim, kolegë. Votohet elektronikisht. Kush është dakord me këtë projektligj?

Ju lutem, hapeni votimin!

74 vota pro, 2 kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohet në parim ky projektligj.

Kalojmë në votimin nen për nen; votohet me kartonë.

Kolegë, kush është dakord me nenin 1 të këtij projektligji? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 1.

Kush është dakord me nenin 2? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet me shumicë votash neni 2.

Kalojmë në votimin në tërësi të këtij projektligji. Ju lutem, ky votim është me elektronikë.

Atëherë, 75 vota pro, 1 kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohet edhe ky projektligj.

Kalojmë në votimin e projektvendimit “Për shkarkimin e Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, zonjës Lindita Nikolla”.

Votimi është i fshehtë me elektronikë.

Ju lutem, teknika, sepse mua nuk më shfaqet në ekran.

Ju lutem, teknika, hapeni votimin!

Ju lutem, mua nuk më shfaqet në ekran! Votimi është i fshehtë, unë nuk mund të bëj votim të hapur, kështu që, ju lutem, teknika!

Atëherë, kush është pro kërkesës për shkarkimin e Kryetares së Kuvendit, zonjës Lindita Nikolla? Kundër? Abstenim?

Mbyllet ky votim.

78 deputetë kanë votuar kundër kërkesës për shkarkimin e Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, zonjës Lindita Nikolla.

*(Duartrokitje)*

3 kolegë kanë votuar pro (ky numër është më i ulët edhe sesa numri i atyre ata që e kanë nënshkruar kërkesën) dhe asnjë abstenim.

Mbyllet votimi për këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë në votimin e projektvendimit “Mbi propozimin për punonjësit me kohë jo të plotë pune pranë KQZ-së për procesin e pilotimit të numërimit dhe të votimit elektronik në zgjedhjet për organet e qeverisje vendore të datës 14 maj 2023”.

Kush është dakord me këtë projektvendim? Bëhet vetëm një votim i hapur në sallë. Pro? Kundër? Abstenim?

**Sekretare e Sekretariatit për  
Procedurat, Votimin dhe Etikën  
Klotilda Bushka**

**Drejtores e Shërbimit të Redaktorëve  
Suela Bala**

Miratohet.

Kalojmë në votimin e projektvendimit “Për ndryshime në strukturën organizative të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Edhe për këtë projektvendim votimi është i hapur me kartonë, kolegë. Kush është dakord me këtë projektvendim? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet me shumicë votash edhe ky projektvendim.

Këtu mbyllet të gjitha çështjet e rendit të ditës.

Faleminderit!

Ditën e mirë!

Takohemi në seancën e ardhshme plenare.

*(Seanca plenare u mbyll në orën 16:10)*

**Nënkryetarja e Kuvendit**

**Ermonela Felaj**